

Vendosim Standarde

Raporti Vjetor i Grupit
2024



Përmbajtja

FJALA PËRSHËNDETËSE

- ANDREAS BRANDSTETTER, CEO UNIQA INSURANCE GROUP
- AVNI PONARI, CEO SIGAL UNIQA SHQIPËRI, KOSOVË, MAQEDONI E VERIUT

RRITJE E QËNDRUESHME, HARTA E GRUPIT

MISIONI YNË

VLERAT DHE PARIMET TONA UDHËZUESE

BORDI MBIKËQYRËS

KUSH ËSHTË SIGAL UNIQA

STRUKTURA E GRUPIT

KUSH ËSHTË UNIQA INSURANCE GROUP

NGJARJET KRYESORE

VLERËSIME KOMBËTARE DH
NDËRKOMBËTARE

PËRGJEGJËSI SOCIALE

EKIPI I SIGAL UNIQA

RISI DHE NOVACION

MEDIA

TË DHËNA PËR TREGUN E SIGURIMEVE NË RAJON

TË DHËNA FINANCIARE

RAPORTI I AUDITITUESVE TË PAVARUR

RAPORTI I AUDITIT TË BRENDSHËM

RAPORTI I VLERËSIMIT TË RREZIKUT

OBJEKTIVAT 2024

STRUKTURA ORGANIZATIKE

KONTAKTE

25 vjet më të mirët

SIGAL i nisi hapat e rrugëtimit historit në shkurt të vitit 1999 si një kompani me pak kapital dhe u shëndrrua me punë, përqëndrim, qartësi, korrektësi dhe këmbëngulje në liderin absolut të tregut të sigurimeve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

Me produkte inovative, pagesa të shpejta të dëmeve dhe shërbim profesional, kompania u kthye në simbol të besueshmërisë dhe profesionalizmit në rajon.

Viti 2024 përkoi me një çerekshkulli dhe pas 25 vitesh është pjesë e 50 kompanive më me ndikim në Evropën Juglindore dhe mban mbi 30% të tregut në Shqipëri, me mbi 2400 punonjës, 1200 zyra dhe mbi 1.2 milionë klientë, SIGAL INSURANCE GROUP është i vetmi aktor në treg që ofron të gjitha klasat e sigurimit në vend.

Fuqia e kësaj kompanie shkon përtej shifrave sepse besimi që ka fituar duke paguar mbi 500 milionë euro dëme në 25 vite, si një histori suksesi që vazhdon, është i pamatshëm në njësi. SIGAL, në 25 vjet dha më të mirën, sepse di ta ndërtojë më së miri punën me më të mirët!

Volumi i primeve (Euro)

Group	126,228,000
AL	71,394,000
KS	25,288,000
MKV	29,546,000

Nr. i zyrave

Group	1,233
AL	824
KS	242
MKV	625

Nr. i kontratave

Group	1,614,953
AL	526,191
KS	254,237
MKV	834,525

Agjentë dhe punonjës

Group	1,691
AL	593
KS	137
MKV	503



ANDREAS BRANDSTETTER
CEO, Uniqa Insurance Group

Sfida jonë në vitin 2024 ishte të qëndronim të fokusuar dhe të balancojmë kapacitetet tona me zgjuarsí. Ambicia jonë, nga njëra anë, përfshin arritjen e një rezultati të shkëlqyer për ju si aksionerë në përfundim të programit tonë strategjik “UNIQA 3.0 – Seeding the Future”, i cili nisi në vitin 2021; së bashku me Bordin Mbikëqyrës, kemi investuar gjithashtu shumë përpjekje dhe vëmendje në fazën tjetër të historisë së kompanisë sonë, domethënë “UNIQA 3.0 – Growing Impact (2025 – 2028)”.

1. UNIQA 3.0 – Seeding the Future (2021 – 2024)

Këto katër vite na mësuam se asgjë nuk është e sigurt dhe çdo gjë është e mundur. Pas sfidave të Covid-19, u përballëm në Lindje me pushtimin e Ukrainës nga Rusia në shkurt të 2022 – dhe me të, rishfaqjen e një hijet të errët që nuk e kishte prekur historinë tonë mbi 200-vjeçare për më shumë se 80 vjet: Lufta në vende ku ne

operojmë, tetë dekada pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Në Perëndim kemi një qeveri të re amerikane në Uashington, sjellja e së cilës ka destabilizuar ekuilibrin gjeopolitik, duke bërë realitet atë që dikur ishte e paimagjinueshme dhe duke kërkuar veprim të vendosur nga Evropa.

Më shumë se 17 milionë klientë tanë presin nga ne shërbim të klasit të parë, besueshmëri, stabilitet dhe siguri – veçanërisht në kohë pasigurie. “Jetojmë më mirë së bashku” është një parim që vërtetë e besojmë. Kjo është arsyeja pse po investojmë fort në trajnimin e rreth 15,000 punonjësve tanë; kemi mirëpritur mesatarisht 2,000 kolegë të rinj çdo vit, dhe jemi të përkushtuar t’i përgatisim të gjithë për detyrat që i presin.

Viti 2024 ishte kulmi i programit tonë strategjik dhe përfundoi si një vit shumë i mirë financiar, pavarësisht dëmshpërblimeve më të larta të paguara ndonjëherë për stuhitë: me një rritje të primeve të shkruara prej 9% – 14% në ELQ dhe 5% në Austri – fitimet para tatimeve u rritën me gati 4% në 442 milionë euro nga 426 euro milionë vitin e kaluar.

Tre segmentet tona rajonale kontribuan në këtë sipas planit: Austria me 313 milionë euro, ndërkombëtarisht me 214 milionë euro dhe kompania jonë e ri-sigurimeve, UNIQA Re, me seli të regjistruar në Zyrih, me 80 milionë euro. Totali i tyre u zvogëlua me 166 milionë euro për shkak të kostove nga funksionet e grupit dhe konsolidimi. Rentabiliteti teknik dhe të ardhurat nga investimet rezultuan pozitive.

Të ardhurat neto nga investimet u rritën në 750 milionë euro (nga 589 milionë euro në 2023), falë rritjes së të ardhurave aktuale, përfshirë investimin në STRABAG

SE. Në vitin 2024, bëmë investime të reja në vlerë rreth 2.2 miliardë euro në letra me vlerë me të ardhura fikse dhe arritëm një normë kthimi për investimet e reja prej 4.4 për qind. Kthimi mesatar nga asetet tona ishte 2.9 për qind, një përmirësim prej 0.1 pikë përqindjeje krahasuar me vitin e kaluar. Për më tepër, rreth 2 miliardë euro nga asetet tona tashmë klasifikohen si “të gjelbra dhe të qëndrueshme” – një element kyç i objektivave tona ESG dhe i planit tonë të tranzicionit klimatik, të cilin do të vazhdojmë ta zbatojmë me përkushtim maksimal.

Fitimi i konsoliduar u rrit me 15% në 348 milionë euro, përfshirë një efekt prej 2 milionë euro nga shitja e 75% të aksioneve në ndërmarrjen e përbashkët ruse “Raiffeisen Life”. Dividenda e propozuar është 0.60 euro për aksion, një rritje me 0.03 euro dhe një normë shpërndarjeje prej 53%.

2. UNIQA 3.0 – Growing Impact (2025 – 2028)

Programi ynë i ri strategjik “UNIQA 3.0 – Growing Impact (2025 – 2028)”, i paraqitur në tregun e kapitaleve në Londër (dhjetor 2024) dhe në Vjenë (janar 2025), duket në pamje të parë një vazhdim evolucionar i programit të mëparshëm, por në të vërtetë përfaqëson një transformim të thellë.

Së pari, sepse gjatë vitit 2024 kemi zhvilluar diskutime të thella kapitull-pas-kapitulli me Bordin Mbikëqyrës mbi strategjinë e ardhshme – për burimet e rritjes, të ardhmen e sigurimeve personale, shtrirjen gjeografike të grupit dhe shëndetin përtej sigurimeve – dhe e kemi rafinuar në një strategji të fortë.

Së dyti, sepse kemi qartësi të plotë për zonat ku duam të përmirësohemi

– si në zbatim, ashtu edhe në kthimet ekonomike. Do të jemi të qëndrueshëm në ato që do të fokusohemi dhe në ato ku nuk do të investojmë më. Pas shitjes së suksesshme të ndërmarrjes së përbashkët në Rusi, kemi vendosur të tërhiqemi edhe nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Kosova – pavarësisht rritjes dhe fitimeve të kënaqshme. Po shesim pjesën tonë shumicë tek bashkëaksioneri ynë lokal shqiptar, pas 18 vitesh prezencë. Kjo përmbyll ristrukturimin tonë gjeografik në CEE – nuk planifikojmë shitje të tjera.

Segmenti ynë i shëndetit me potencial të lartë “Mavie” po kontribuon gjithashtu në diversifikim. Katër vite pas lançimit, jemi lider në kujdesin shëndetësor profesional në Austri dhe në kujdesin privat 24/7 në shtëpi. Investuam rreth 265 milionë euro në spitalet tona në Vjenë, Graz, Salzburg dhe Wörgl, dhe fokusohemi gjithashtu në telemjekësi – një teknologji kyçe për kujdesin evropian të së ardhmes.

Për të ofruar më shumë vlerë për klientët tanë, synojmë rritje mesatare të primeve të shkruara prej të paktën 5% çdo vit në katër vitet e ardhshme. Fitimi neto do të rritet me të paktën 6% në vit, me ROE ≥ 12%. Do të propozojmë dividendë në rritje çdo vit, me normë shpërndarjeje 50–60%.

Të nderuar zonja dhe zotërinj, të dashur aksionerë, ju falënderojmë për besimin tuaj në UNIQA dhe interesin për grupin tonë! Pavarësisht pasigurive gjeopolitike dhe me gjithë vigjilencën e nevojshme, e nisim vitin e parë të programit “UNIQA 3.0 – Growing Impact” me shumë energji, pasion dhe optimizëm. Shpresojmë të raportojmë zhvillime që do të përmbushin të gjitha pritshmëritë tuaja brenda një viti!

ANDREAS BRANDSTETTER
CEO, Uniqa Insurance Group



AVNI PONARI
CEO i SIGAL Group, Shqipëri, Kosovë dhe
Maqedoninë e Veriut

Kompania më e madhe dhe më e besuar e sigurimeve, SIGAL, kremton 25-vjetorin e themelimit të saj, ngjarje për të cilën u organizua një takim me stafet e kompanisë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut ku u diskutua mbi arritjet gjatë këtij çerekshekulli dhe objektivat për të ardhmen.

Takimi u hap nga themeluesi dhe CEO i "SIGAL", z. Avni Ponari, i cili rënditi sukseset dhe arritjet e kompanisë gjatë këtyre 25 viteve.

Sipas tij, aagjë nuk ka qenë e lehtë në fillim, ndërsa falë punës së kryer, shërbimit profesional ndaj klientit, produkteve më novatore në treg dhe pagimi në kohë i dëmeve ka bërë që sot Grupi "SIGAL" të jetë lidere e sigurimeve në Shqipëri, Kosovë e Maqedoninë e Veriut dhe mes 50 më të

mëdhave në Evropën Juglindore.

"Sot është një ditë e veçantë. Një ditë që na bën të ndjejmë pak emocione dhe ta shohim të ardhmen ndryshe. Sepse ne ishim ata që filluam me pak kapital dhe sot kemi arritur në këto shifra që janë shumë të rëndësishme. Kjo është puna juaj, puna e gjithë stafit, është puna e jona gjatë gjithë këtyre viteve.

Nga ana tjetër ne jemi shtuar, jemi përmirësuar dhe kemi arritur në këto rezultate, të cilat mendoj janë mjaft të mira", tha ndër të tjera në fjalën e tij themeluesi dhe CEO i Grupi "SIGAL", z. Avni Ponari.

"Ne jemi më mirë se të tjerët. Jemi të parët! Edhe Kosova, edhe Maqedonia e Veriut dhe ne të gjithë si grup. Dhe llogaritimi mes 48 kompanive më të mëdhaja të Europës Juglindore. Çka na bën krenarë për punën që kemi bërë.

Gjithmonë kemi pasur si synim të kemi inovacione. Kemi qenë kërkues ndaj vetes. Kemi kërkuar që gjithçka ta bëjmë si duhet. Por idetë tona gjithmonë kanë qenë në konflikt me ata që zhvillojnë IT-në. Pavarësisht se ata janë shumë më lart por në zbatimin e ideve tona, programeve tona, ata nuk kanë arritur ti përgjigjen nivelit të kompanisë sonë. Dhe kjo kërkon më shumë punë për të ardhmen sepse sot industria e sigurimeve, ajo bankare dhe e financave në përgjithësi janë 100% të automatizuara. Duke i shërbyer më mirë klientit se në fund të fundit ky është qëllimi.

Në gjithë punën tonë jemi nisur nga disa parime dhe norma mbi të cilat kemi bërë për ndërtimin e strukturës së SIGAL-it, mbi bazën e departamenteve, në mënyrë që të jemi ndryshe nga ato që kanë kompanitë e

“Gjithmonë kemi pasur si synim të kemi inovacione. Kemi qenë kërkues ndaj vetes.”

tjera. Dhe kjo ka qenë e veçanta jonë. Pse ne ecim më mirë se të tjerët?

Kemi një brand të besuar, kemi një emër të besuar. Edhe ata me të cilët bashkëpunojmë janë ndër emrat më të rëndësishëm në Europë. Produktet më të mira. Kemi qenë lider. Ne kemi nxjerrë një produkt, tregjet kanë ardhur pas nesh. Kemi qenë gjithmonë përpara, në të gjitha produktet", vijoi më tej Ponari.

Pas z. Ponari, fjalën e morën drejtuesit e departamenteve në SIGAL dhe drejtuesit e kompanisë në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, të cilët bënë një bilanc të punës gjatë viteve të kaluara dhe planet për vitet në vijim.

Më pas, z. Ponari ndau "Statujat e Mirënjohjes" për punonjësit dhe agentët me më shumë vite kontribut në "SIGAL".

Takimi u mbyll me një drekë festive, nën tingujt e gëzueshëm të Orkestrës së Harqeve "SIGAL".

"SIGAL", një prej grupeve më të mëdha të sigurimeve në rajon.

E themeluar më 22 Shkurt 1999 dhe pjesë e "UNIQA Insurance Group" prej vitit 2007, ajo operon suksesshëm në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut përmes 8 kompanive të saj: 3 Sigurimi Jo-Jete, 3 Sigurimi Jete, 1 kompani risigurimi dhe 1 Fond Pensioni.

Falë strategjisë së tij "par excellence", modelit të biznesit, menaxhimit financiar dhe stafit gjithmonë të përzgjedhur me kujdes, SIGAL është rritur vit pas viti duke arritur sot një pozicion dominues në treg, duke e udhëhequr atë me rreth 30% të tij.

Sot, "SIGAL" është e vetmja kompani që ofron të gjitha klasat e sigurimeve, duke numëruar mbi 2400 punonjës e agentë në mbi 1200 zyra në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, ku operohet me standarte tërësisht evropiane.

Mbi 500 milionë euro dëme të paguara në 25 vite, janë dëshmia më e madhe e fuqisë, përgjegjshmërisë dhe korrektësisë të "SIGAL".

Ndaj dhe sot, nën moton "Jetojmë më mirë së bashku", mbi rreth 1.2 milionë klientë vazhdojnë ti besojnë kësaj kompanie jetën, shëndetin, pronën, automjetin dhe pensionin privat.

AVNI PONARI
CEO i SIGAL Group,
Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut

Rritje e qëndrueshme në Austri dhe Evropën Qendrore e Lindore

Më shumë se 17 milionë klientë në Austri dhe Evropën Qendrore e Lindore i besojnë shërbimit të klasit të parë të Grupit UNIQA. Qëllimi ynë është të njihemi si ofruesi kryesor i shërbimeve në të dy tregjet dhe të garantojmë kënaqësinë maksimale të klientëve – me një vlerësim prej të paktën 4.5 nga 5 yje.

Me më shumë se 200 vite përvojë, UNIQA është një nga ofruesit kryesorë të sigurimeve në Austri. Ne e kemi forcuar ndjeshëm pozicionin tonë në tregun e rajonit të Evropës Qendrore dhe Lindore gjatë viteve të fundit, falë integritit të suksesshëm të ish-kompanive AXA në Poloni, Sllovaki dhe Çeki. Grupi UNIQA vazhdon të fokusohet në mënyrë të qëndrueshme te rritja e qëndrueshme dhe fitimprurëse, pavarësisht sfidave gjeopolitike dhe ekonomike.

14.1 milionë

Klientë ne EQL dhe Lihtenshtein

17.8 milionë

Klientë ne 17 shtete

3.7 milionë

Klientë në Austri

Shenja tregon pozicionin në treg në vendin përkatës.

- Austria
- Polania
- Sllovaki/Çeki
- Hungari
- Ukrainë
- SEE6: Bosnje Herzegovina, Bullgaria, Kroacia, Mali i Zi, Romania, Serbia
- Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut

Misioni ynë

Një kompani shqiptare me standarde evropiane si SIGAL e ka të qartë misionin e saj: të paguajë në kohë rekord dëmet dhe të mbrojë qytetarët mbi bazën e kontratave të sigurimit.

Përgjatë 25 viteve punë, SIGAL si Grup ka paguar më shumë se 500 milionë euro dëme, shifër kjo që tregon qartë seriozitetin, qëndrueshmërinë financiare dhe përgjegjshmërinë ndaj klientëve të saj.

Vetëm për dy tërmetet e fundvitit 2019, SIGAL ka paguar afro 20 milionë euro dëme për klientët e saj.

Krahas përgjegjshmërisë kontraktuale, SIGAL ka dëshmuar përkujdesje maksimale për komunitetin, duke kontribuar në shëndet, art, kulturë, trashëgimi kulturore, sport, turizëm dhe arsim me miliona euro ndër vite.

Veptra të tilla si rikonstruksioni i Teatrit Skampa në Elbasan pas djegies totale, rikonstruksioni i Kinema Millenium Korçë, rikonstruksioni i shtëpisë muze në Korçë e Berat, rikonstruksion shkollash dhe pajisje me mjete shkollore, të gjitha këto mbajnë emrin SIGAL.

Sepse e tillë duhet të jetë një kompani, e cila jo vetëm të marrë por edhe duhet t'i japë mbrapsht komunitetit, nëpërmjet investimeve në fusha të ndryshme. Kjo ka qenë motoja jonë si SIGAL që prej fillimit dhe do të vazhdojë të jetë edhe për të ardhmen.

Sepse ne besojmë që zhvillimi jonë shkon krah për krah me zhvillimin e shoqërisë dhe ekonomisë së vendit tonë.

Parimet dhe vlerat tona udhëzuese

Klientët të parët Ne jemi të fokusuar me vendosmëri në nevojat e klientëve tanë.	Thjeshtësia Ne veprojmë dhe mësojmë nga gabimet	Përgjegjshmëria Ne inkurajojmë njëri-tjetrin për të marrë përgjegjësi.
Integriteti Ne i mbajmë premtimet tona.	Komuniteti Ne bashkëpunojmë përtej kufijve të zakonshëm.	

Bordi Mbikëqyrës



Andreas Brandstetter
Kryetar i Bordit Mbikëqyrës, SIGAL UNIQA
CEO i UNIQA Insurance Group



Wolfgang Kindl
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës,
SIGAL UNIQA



Gerald Mueller
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës,
SIGAL UNIQA



Georgios Bartzis
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës,
SIGAL UNIQA



Vinzenz Benedikt
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës,
SIGAL UNIQA

Kush është “SIGAL”?

SIGAL është një prej grupeve më të mëdha të sigurimeve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

Kompania kryeson tregun e sigurimeve prej vitit 2002, duke zënë rreth 30% të tij në Sigurimet e Jetës, Jo-Jetës dhe Pensionit Privat.

E themeluar në Shkurt 1999, SIGAL operon suksesshëm në të trija shtetet përmes 8 kompanive të saj: 3 Sigurime Jo-Jetë, 3 Sigurime Jete, 1 kompani risigurimi dhe 1 Fond Pensioni Privat.

Portofoli i SIGAL Group është i risiguruar në tregjet më të mëdha botërore teksa kompania bashkëpunon me emra të mëdhenj si: Allianz, AXA, Zurich Re, ‘UNIQA Re’, ‘Munich Re’, ‘Hannover’ Re, AIG dhe IF duke ofruar një garanci më shumë për mbi 1.2 milion klientët e saj.

Ritmet e progresit të SIGAL kanë bërë që shumë publikime profesionale në fushën e sigurimeve ta vlerësojnë atë me shumë çmime dhe vlerësime.



Nr. 1
në tregun e sigurimeve



1.2 milionë
klientë



3 shtete
AL - KS - MKV

Bordi Drejtrues i Grupit SIGAL



AVNI PONARI
CEO, Grupit SIGAL në Shqipëri,
Kosovë, Maqedoni e Veriut



EDVIN HOXHA
Drejtore i Përgjithshëm
SIGAL Life Shqipëri



ALMA TOTOKOÇI
Zv. Drejtore i Përgjithshëm
SIGAL Shqipëri



ELVIS PONARI
Administrator i Përgjithshëm
Fondi i Pensioneve SIGAL



PËRPAM DRINI
Drejtore Ekzekutive
SIGAL Jo-Jetë Kosovë



KALTRINA GASHI
UD. Drejtore Ekzekutive
SIGAL Life Kosovë




DRITON AZIZI
CEO
SIGAL Jo-Jetë Maqedoni e Veriut



ALEKSANDRA ANTOVSKA
CEO
SIGAL Life Maqedoni e Veriut

Struktura e Grupit SIGAL



86.9%

UNIQA Insurance Group



Aksionerët
tanë

13.1%

Investitor Vendas

Ngjarjet Kryesore

SIGAL feston 25 vite sukses, përkushtim dhe besim



SIGAL ka shënuar një moment historik këtë vit: 25-vjetorin e themelimit të saj. Me një histori të gjatë sukcesi në tregun shqiptar dhe atë rajonal, kompania vendosi të festojë këtë përvjetor të rëndësishëm përmes një sërë aktiviteteve që përfshinë jo vetëm stafin dhe partnerët, por edhe komunitetin e gjerë që i ka qëndruar pranë ndër vite.

Festimet kulmuan me një mbrëmje gala madhështore në Tiranë, ku morën pjesë figura të njohura të jetës publike, përfaqësues të biznesit, politikës, medias dhe bashkëpunëtorë nga vendi dhe jashtë tij. Në këtë atmosferë të veçantë, u kujtua rrugëtimi 25-vjeçar i kompanisë përmes një dokumentari emocionues, ndërsa u ndanë edhe çmime dhe mirënjohje për ata që kanë dhënë kontribut të veçantë në his-

torinë e SIGAL.

Në një koncert festiv në Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit, i ideuar në atë formë që të përfaqësonte të trija shtetet ku është prezent Grupi SIGAL UNQA, Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, qindra të ftuarit shijuan interpretimet magjike të tenorit me famë botërore Ramë Lahaj, sopranos Ulpiana Aliaj, këngëtares nga Maqedonia e Veriut Karolina Goçeva dhe Ansambli Kombëtar të Këngëve dhe Valleve.

Koncerti u moderua nga dyshja Ardit Gjebreja-Fjoralba Ponari, ndërsa nuk mungoi edhe shfaqja e një dokumentari ku u shfaq i gjithë rrugëtimi 25-vjeçar i SIGAL.

Gjatë fjalës së tij përshëndetes, z.Avni

Ponari, themelues dhe CEO i SIGAL, bëri një rezymë të të gjithë ecurisë gjatë këtyre 25 viteve, idetë e para të themelimit, vështirësitë që kishte ky udhëtim në hapat e parë dhe arritjet gjatë këtij çerekshkulli.

Sipas tij, ngjarja më e madhe në 25 vitet e SIGAL është padyshim shkrija me kompaninë e njohur austriake “UNIQA Insurance Group”.

“Ngjarja më e madhe në jetën 25 vjeçare të Sigalit, padyshim ka qenë shkrija me kompaninë e njohur austriake “UNIQA Insurance Group”. Gjigandi i sigurimeve evropiane ofroi të ishte partneri ynë duke i dhënë kompanisë tonë një dimension ndërkombëtar.

Ne sot e themi me plot gojë se SIGAL është në Europë, jo vetëm për shërbimin por edhe për standartet europiane që aplikon në çdo aspekt.

Tashmë pozita lider është konsoliduar. Klientët tanë kanë një siguri të pakrahueshme për mbështetjen dhe garancitë që ofron SIGAL UNIQA.

Sigal u bë e para kompani shqiptare me partner ndërkombëtar duke garantuar tregun përmes investitorëve strategjikë, jo vetëm në Shqipëri por edhe në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut”, tha gjatë fjalës së tij Ponari.

I ftuar në event ishte edhe CEO i “UNIQA Insurance Group”, z.Andreas Brandstetter, i cili foli me superlativa për punën dhe arritjet e SIGAL UNIQA gjatë 25 viteve, në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

“Jam shumë i lumtur dhe krenar si president i Grupit “UNIQA Insurance Group” për

kontributin e SIGAL në rritjen e mirëqënies së qytetarëve pasi ata menduan të kujdesen për të gjitha të mirat e tyre.

Kjo është diçka që ju dhe skuadra juaj sollët me shumë qëndrueshmëri në treg.

Nëse kthehemi pas para 25 vjetësh ajo që ndodhi ishte e mrekullueshme dhe padyshim e pabesueshme. Shkëlqimi me elasticitet me guximin për të ndërtuar një kompani sigurimesh private kërkon shumë. Dhe ne ja kemi arritur”, tha ndër të tjera Brandstetter.

Mbrëmja vijoi me përshtypjet e Reshat Arbanës, aktorit të mirënjohur që për shumë vite ka qenë edhe imazh i kompanisë, të presidentit të klubit më të famshëm të basketbollit në Kosovë SIGAL Prishtina, Blerand Stavileci dhe të një prej shumë klientëve të dëmshpërbyler nga SIGAL.

Eventi u mbyll në mënyrën më të bukur të mundshme, teksa në skenë zbrit për të performuar Ansambli i Këngëve dhe Valleve, vallet dhe këngët e të cilit ngritën në peshë publikun.

Kështu, përvjetori i 25-të i SIGAL nuk ishte vetëm një festë simbolike, por një reflektim mbi rrugëtimin, vlerat dhe misionin e kompanisë për të qenë gjithmonë pranë njerëzve, në çdo hap të jetës së tyre. Dhe ndërsa mbyllet ky kapitull i parë i suksesshëm, SIGAL e sheh të ardhmen me më shumë energji, vizion dhe përkushtim se kurrë më parë.





“SIGAL” zhvillon Konferencën Rajonale Ponari: Më të mirët! Shkojmë tek klienti me çdo produkt sigurimi

Me pjesëmarrjen e stafëve nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut, Grupi më i madh i sigurimeve “SIGAL” zhvilloi Analizën Rajonale për 3-mujorin e parë të vitit.

Takimi u hap nga themeluesi dhe CEO i grupit, z.Avni Ponari, i cili gjatë fjalës së tij rënditi disa prej arsyeve pse “SIGAL” mbetet kompania më e madhe dhe më e besuar e sigurimeve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

“Jemi më të mirët në treg pasi jemi i vetmi grup që kemi në përbërjen tonë një kompani risigurimi dhe një fond pensioni privat.

Si asnjë tjetër, ofrojmë për klientët tanë çdo produkt sigurimi që ofron çdo kompani në Europë dhe në botë. Ndaj jemi të vlerësuar kombëtarisht dhe ndërkombëtarisht”, tha ndër të tjera Ponari.



“SIGAL Pension” vlerësohet në “CCIT Awards 2024” Ponari ja dedikon klientëve dhe punonjësve të grupit në 3 shtete



“Fondi më i madh për asetet në administrim dhe më i besueshëm”.

Ky është çmimi për “SIGAL Pension”, fondi më i madh i pensioneve private në Shqipëri, dhënë nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, në 127-vjetorin e krijimit të saj. CCIT AWARDS, ceremonia vjetore e shpërndarjes së çmimeve për më të mirët e sipërmarrjes private të mbarë trevave shqiptare, shënoi momentin kulmor të një viti kalendrik, ku u identifikuan dhe vlerësuan promotorët e ekonomisë.

Përpos identifikimit të më të mirëve, qëllimi i këtij eventi është edhe inkurajimi për t’u përmirësuar më tej, rritja e ndërgjegjësim-it dhe përcjellja e frymës sipërmarrëse në shërbim të shoqërisë dhe progresit.

Gjatë fjalës së tij përshëndetëse, CEO i

Grupit SIGAL, z.Avni Ponari u shpreh ndër të tjera se, “ky çmim shkon për 1.5 milionë klientët e SIGAL në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut dhe për mbi 2,000 punonjësit e saj”.

Ekspertiza: Me mbi 17 vjet përvojë në fushën financiare, “SIGAL Pension” ofron njohuri të thellë në këtë fushë duke ofruar zgjidhje për të përmbushur nevojat unike të kompanisë suaj dhe jo vetëm.

Përshtatja: “SIGAL Pension” bashkëpunon ngushtë me çdo klient për të projektuar një plan pensioni që përputhet me synimet e biznesit dhe preferencat e individëve.

Siguria: “SIGAL Pension” mundëson sigurinë dhe mbrojtjen e investimeve të punonjësve tuaj, duke investuar në instrumenta financiarë të besueshëm (Obligacione Shtetërore).

Takimi me përfaqësues të “UN Women” në Shqipëri SIGAL, e para kompani sigurimi që firmos “Parimet e Fuqizimit të Grave”



Drejtues të SIGAL pritën në një takim përfaqësues të UN Women në Shqipëri. Gjatë takimit, Z.Avni Ponari, CEO i “SIGAL”, u shpreh se kompania që ai drejton po krijon në vazhdimësi një mjedis pune ku të gjithë individët mund të shprehin më të mirën e aftësive të tyre, duke inkurajuar fuqizimin e grave në të gjitha kompanitë e Grupit dhe duke u kujdesur që kontributi i tyre të vlerësohet siç duhet.

Ndërkohë ai ritheksoi angazhimin e tij për të ndërmarrë hapa më të mëdhenj dhe më të shpejtë për fuqizimin e grave në vendin e punës dhe në komunitet.

Z.Ponari vuri në dukje në mënyrë specifike kuotat e grave dhe pozicionet e tyre në hierarkinë e Grupit “SIGAL”, i cili vepron jo thjesht si lider i tregut të sigurimeve por edhe si një model në sektorin privat të biznesit për Fuqizimin e Grave.

“Si CEO i “SIGAL”, jam i përkushtuar në zbatimin e politikave që forcojnë pozicionin e gruas në kompani. Jam i lumtur të pohoj se, aktualisht numri i grave në administrën e SIGAL e ka tejkaluar atë të burrave duke përbërë 51.3% të totalit.

Ndërsa në nivel menaxherial numri i tyre arrin në rreth 42% me premisa për tu rritur akoma më tej në të ardhmen. Ne besojmë fort se, barazia gjinore nuk është vetëm një impenjim moral për kompaninë, por edhe një strategji biznesi.

Duke nxitur një vend pune të larmishëm dhe gjithëpërfshirës, ku gratë kanë mundësi të barabarta për tu rritur profesionalisht, ne jo vetëm që po bëjmë gjënë e duhur, por gjithashtu nxisim kreativitetin dhe rritje të qëndrueshme për kompaninë tonë në veçanti dhe shoqërinë në tërësi”, u shpreh ndër të tjera ai.

Z.Ponari shtoi më tej se, praktikrat e qeverisjes kooperative të SIGAL bazohen në standardet ndërkombëtare dhe udhëhiqen nga vlerat për të cilat Grupi është zotuar, në mënyrë që të garantojnë drejtësi dhe qëndrueshmëri në të gjitha hapat e ndërmarrë.

Më pas z.Ponari dhe z.Ribotta firmosën edhe “Parimet e Fuqizimit të Grave” me SIGAL që bëhet e para kompani sigurimi që ndërmerr një hap të tillë.

Ditëlindja e SIGAL Kosovë

21 vite partneritet, 21 vite siguri, 21 vite histori suksesi



Kompania lider e sigurimeve në Kosovë, SIGAL festoi 21-vjetorin e themelimit të saj.

Pjesë e Grupit "SIGAL", me seli qendrore në Tiranë, kompania ka njohur rritje vit pas viti duke u shndërruar sot në emrin më të besuar të sigurimeve.

"SIGAL Kosovë shënon 21 vjetorin e themelimit të saj!

Për gjatë dy dekadave, kompania jonë ka udhëhequr vazhdimisht rrugën në ofrimin e mbulimit gjithëpërfshirës që mbron atë që ka më shumë rëndësi – jetën, shëndetin, pronën, biznesin, automjetet dhe më gjerë. Ky moment historik nuk është thjesht një pasqyrim i arritjeve tona, por edhe një falënderim i përzemërt për të gjithë njerëzit dhe bizneset që na kanë besuar gjatë viteve. Ne mbetemi të përkushtuar për të mbrojtur çdo aspekt të jetës tuaj, duke siguruar paqe dhe siguri për të gjithë.

"21 vite partneritet! 21 vite siguri! 21 vite histori suksesi!", shkruan kompania në rrjetet e saj sociale.

Si lindi SIGAL Kosova?

SIGAL Kosova u themelua në tetor 2003 duke shënuar zbatimin e strategjisë për ndërkombëtarizim të aktivitetin sigurues të SIGAL sh.a përmes blerjes së një shoqërie ekzistuese sigurimi. Ndërsa në vitin 2011 do të themelohej edhe SIGAL UNIQA LIFE – Kosova.

Sot, pas 21 vjetësh, ajo është kompania më e madhe e sigurimeve në Kosovë kryeson tregun ku operojnë 10 kompani.

Në 21 vite të ekzistencës së saj në Kosovë, SIGAL ka njohur rritje vit pas viti dhe aktualisht numëron mbi 200 milionë Euro prime dhe mbi 100 milionë euro dëmshpërblime tek klientët e saj.

"Tatimpaguesi i Vitit 2024" Tjetër vlerësim për SIGAL-in në Kosovë

Në një mbrëmje gala, traditë tashmë në Kosovë, organizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës, "THE BEST OF KOSOVO 2024", u ndanë çmimet për bizneset dhe sipërmarrjet më të suksesshme në vend.

SIGAL Kosova është vlerësuar me çmimin "Tatimpaguesi i Vitit 2024", vlerësim që e merr prej disa vitesh rradhazi.

"Në mbrëmjen prestigjioze të organizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës, SIGAL UNIQA Group Austria, kompania lider e sigurimeve në Kosovë, është vlerësuar edhe një herë me çmimin "Tatimpaguesi i Vitit 2024".

Ky vlerësim vjen si një dëshmi e përkushtimit dhe angazhimit tonë të vazhdueshëm ndaj çdo klienti dhe përgjegjësie që kemi si kompani.

Marrja e këtij çmimi për disa herë rradhazi vetëm sa forcon vendosmërinë tonë për të përmirësuar shërbimet tona dhe për të vazhduar të kemi një ndikim pozitiv.

Ne jemi thellësisht të nderuar nga kjo njohje dhe mbetemi plotësisht të përkushtuar që të shërbejmë me profesionalizëm, duke ruajtur vlerat tona dhe duke kontribuar në rritjen e ekonomisë së Kosovës", shkruan kompania në rrjetet sociale.

Në 21 vite të ekzistencës së saj në tregun e sigurimeve në Kosovë, SIGAL është jo vetëm kompania më e besuar e sigurimeve por edhe paguesi më i madh i dëmeve, në një vlerë prej rreth 100 milionë eurosh në vite.

SIGAL Kosova është gjithashtu një kontribues i rëndësishëm i jetës sociale në vend, me fokus të veçantë shëndetësinë, edukimin, sportin, artin dhe kulturën.

- Sponsor Gjeneral i Klubit të Basketbollit "SIGAL Prishtina" që prej vitit 2005;
- Sponsor i Federatës së Futbollit të Kosovës;
- Sponsor i Përfaqësueses së Kosovës;
- Sponsor i Federatës së Basketbollit të Kosovës;

Sponsor gjeneral i Superligës së Femrave në futbollin e Kosovës e cila quhet "SIGAL SUPERLIGA E FEMRAVE". Dhe shumë e shumë aktiviteteve të tjera.

SIGAL Kosova u krijua në vitin 2003 duke shënuar zbatimin e strategjisë për ndërkombëtarizimin e SIGAL sh.a (themeluar në vitin 1999 në Tiranë) përmes blerjes së një shoqërie ekzistuese sigurimi.

SIGAL Kosova është kompania më e madhe e sigurimeve në Kosovë dhe në 10-mujorin 2024 zotëronte 14.03% të primeve të Sigurimeve të Jo-Jetës nga 10 kompani që operojnë në treg.

SIGAL ka shtrirë shërbimin e saj si për nga numri i produkteve që ofron ashtu edhe gjeografikisht përmes dhjetra degëve dhe agjencive të veta në gjithë Kosovën: në Deçan, Dragash, Elezit, Ferizaj, Gjakovë, Gjiilan, Glogoc, Istog, Kaçanik, Kamenicë, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mitrovicë, Obiliq, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Shtërpçë, Shtime, Skenderaj, Suharekë, Viti, Vushtri, Xërxë.

SIGAL - Më Shumë se Sigurim: Leadership, Përgjegjësi Shoqërore dhe Besueshmëri në Maqedoninë e Veriut



Që të jesh lider në treg dhe një kompani e standarteve evropiane nuk mjafton thjesht të sjellësh produktet më të mira dhe ti shërbesh në kohë klientëve atëherë kur kanë më shumë nevojë. Duhet të jesh edhe pjesë aktive e shoqërisë ku operon.

Dhe në Maqedoninë e Veriut këtë e bën më së miri “UNIQA”, kompania e sigurimeve, e cila i jep një rëndësi të veçantë përgjegjësisë sociale.

Për këtë qëllim kompania është vlerësuar edhe nga Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri-Perëndimore, në një aktivitet me temë “Përgjegjësia shoqërore e korporatave, filantropia dhe politikat qeveritare: Bashkëpunim për një shoqëri më të fuqishme”.

Gjatë eventit u promovua edhe edicioni i dytë i Librit të Bardhë, ku prezantohen tema nga filantropia dhe përgjegjësia sociale e

kompanive në Maqedoninë e Veriut.

Libri i Bardhë promovon aktivitetet e kompanive anëtare dhe inkurajon anëtarët e saj, por edhe bizneset në përgjithësi, për një qasje më të drejtpërdrejtë ndaj tematikave të rëndësishme shoqërore.

Kompania e sigurimeve “UNIQA AD Shkup” është pjesë e grupit më të madh të sigurimeve në rajon “SIGAL UNIQA” dhe grupit austriak “UNIQA INSURANCE GROUP”.

Ajo operon në tregun maqedonas të sigurimeve prej 19 vitesh tashmë duke shënuar suksese të jashtëzakonshme.

Shërbimi profesional ndal klientit, produkte më të mira dhe novatore dhe pagimi në kohë i dëmeve e bëjnë atë një emër të besueshëm për qytetarët dhe bizneset në Maqedoninë e Veriut.

Vlerësime kombëtare dhe ndërkombëtare

Çmime dhe vlerësime përgjatë vitit 2024

SIGAL ka vijuar të operojë përplot suksese përgjatë vitit 2024 në të tre shtetet e Ballkanit, Kosovë, Maqedoni e Veriut dhe Shqipëri përmes 8 kompanive të saj: 3 sigurime Jo-Jetë, 3 sigurime Jete, 1 kompani risigurimi dhe 1 Fond Pensioni Privat.

Sipas SEE TOP 100, kompania u certifikua si më e madhja e sigurimeve në Evropën Juglindore. Në edicionin vitit 2024 të "Top 100 Insurers" nga SeeNews, SIGAL konfirmoi pozicionin e vetë si e vetmja kompani shqiptare e sigurimeve e përfshirë në këtë renditje prestigjioze për rajonin e Evropës Juglindore.

Kompania u pozicionua në vendin e pesëdhjetë e tretë mes 100 siguresve më të mëdhenj. SIGAL u komfirmua si lider i padiskutueshëm në Shqipëri. Duhet theksuar se, edhe dy filialet e grupit, në Maqedoninë e Veriut dhe në Kosovë, ishin pjesë e TOP 100.

Me mbi 1.5 milionë klientë dhe mbi 100 milionë euro prime vjetore, kjo arritje e përforcon më tej imazhin e saj si një grup sigurimesh me standarde të larta, besueshmëri dhe sukses të qëndrueshëm në treg në rajonin e Ballkanit.

Renditja e revistës "Monitor" për tregun shqiptar, e radhiste SIGAL UNIQA-n si ndër kompanitë më të mëdha vendase dhe si kompaninë siguresë që renditej e para në Shqipëri për vitin 2024.

Gjatë po të njëjtit vit SIGAL Pension, fondi më i madh privat i pensioneve në Shqipëri,

u vlerësua nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë me çmimin "Fondi më i madh për asetet në administrim dhe më i besueshëm", në kuadër të ceremonisë prestigjioze CCIT Awards.

Ky çmim konfirmoi pozicionin udhëheqës të SIGAL Pension në treg dhe besimin që gëzon nga publiku, ndërsa shërbeu edhe si nxitje për përmirësim të mëtejshëm dhe për promovimin e vlerave të sipërmarrjes në shërbim të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror.

Në vitin 2024 SIGAL u certifikua nga "AXE Register" për përmbushjen e kërkesave të standardit "ISO 27001:2022" mbi menaxhimin e sigurisë së informacionit. Kjo certifikatë konfirmon cilësinë në implementimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemeve të sigurisë brenda kompanisë, veçanërisht në fushat e sigurimit dhe risigurimit. Ajo përfaqëson jo vetëm një arritje teknike, por edhe një dëshmi konkrete të përkushtimit të SIGAL për të ofruar standardet më të larta të mbrojtjes së të dhënave për klientët dhe partnerët e saj dhe për të qenë pararojë e zhvillimeve teknologjike.

Partneri ynë, grupi UNIQA, për të cilin ishim përfaqësues në tregun shqiptar, maqedonas dhe kosovar, përgjatë vitit 2024 u rivlerësua me nivelin "A" nga "Standard and Poors", u cilësua një nga 10 markat më të forta të sigurimeve si edhe u certifikua me "EMAS" dhe "ISO 14001" si "pioner i mbrojtjes së mjedisit".



Inovacion që bën diferencën



Bëhuni pjesë e teknologjive më të reja! Audiobooks.al, projekti që ecën në hapat e Inteligjencës Artificiale

SIGAL UNIQA Group Austria është e njohur jo vetëm si kompania më e madhe dhe më e besuar e sigurimeve në Shqipëri, por edhe si kompania më novatore në fushën e zhvillimeve teknologjike.

Leximi është palestra e mendjes. Të shpenzosh kohë duke iu përkushtuar leximit është një aktivitet për të cilin do falenderosh veten më vonë.

Kompania lider e sigurimeve në vend dhe rajon, SIGAL UNIQA Group Austria, i ka dhënë një rëndësi të veçantë edhe përgjegjësi sociale ndaj qytetarëve me një sërë aktiviteteve që synojnë përmirësimin e jetës së tyre, por edhe pasurimin e anës mendore dhe shpirtërore.

Një prej këtyre projekteve është edhe AudioBooks, platforma e parë dixhitale e librave audio në shqip.

Platforma ka për qëllim ruajtjen, zhvillimin dhe trashëgimin brez pas brezi të gjuhës shqipe, kryesisht për fëmijët e shqiptarëve

në Diasporë, të cilët e vuajnë shumë këtë pjesë.

Për këtë gjë ka menduar SIGAL UNIQA Group Austria përmes "SIGAL AudioBooks"-e cila sjell te shqiptarët brenda dhe jashtë kufijve, pa asnjë kosto, librat e autorëve më të njohur, shqiptarë dhe të huaj. Te "SIGAL Audiobooks" e gjejnë veten duke filluar që nga fëmijët e moshave të vogla, duke dëgjuar përrallat e tyre të preferuara, fëmijët pak më të rritur me librat shkollorë apo libra artistikë që u përshtaten moshës së tyre dhe deri tek të rriturit, që mund të dëgjojnë romane, histori, kulturë, e plot libra interesantë dhe me vlera të mëdha.

Librat vijnë tek ju nëpërmjet zërave të njohur të personazheve që kanë shumë vite eksperiencë në gazetari dhe jetën publike, dhe me profesionalizmin dhe zërin e tyre unik përcjellin tek çdo dëgjues librat më të mirë të epokës moderne, si dhe të historisë e kulturës së vjetër mesjetare e të rilindjes.

Por si lindi ky projekt?

"SIGAL Audiobooks" lindi si ide e një individi të njohur për publikun, e një biznesmeni shumë të sukseshëm e njëkohësisht një person që jep një kontribut të madh në zhvillimin dhe përmirësimin e jetës sociale e kulturore të qytetarëve shqiptarë, nëpërmjet projekteve të ndryshme në ndihmë të komunitetit.

Ai është z. Avni Ponari, që gjerësisht njihet si themeluesi dhe drejtuesi i kompanisë më të madhe të sigurimeve në vend dhe rajon, SIGAL UNIQA Group Austria.

Kush nuk e ka bërë ende, le ta shkarkojë tani "SIGAL Audiobooks" në App Store dhe Play Store dhe në këtë mënyrë e merr librarinë kudo me vete, në makinë, udhëtime, punë e kudo tjetër.



"SIGAL", pjesë e Piramidës së Tiranës

Ponari: Lokacioni më i ri i inovacionit në sigurime dhe edukimit financiar

SIGAL prej 25 vjetësh tashmë është kryefjala e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon.

Kompania ka fituar besimin e qytetarëve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut jo vetëm për shërbimin profesional ndaj klientit, mbi 500 milionë euro dëme të paguara por edhe për inovacionin që ka sjellë vazhdimisht.

Dhe një kompani sigurimi kaq novatore, që ecën me hapat e zhvillimit të teknologjisë, nuk mund të mos ishte pjesë e ndërtesës më novatore në Tiranë.

Falë bashkëpunimit me Fondin Amerikan të Zhvillimit, një partner i hershëm dhe shumë i rëndësishëm i SIGAL, dhe Bashkisë së Tiranës, një prej objekteve më të vizituara në

kryeqytet, ka tashmë pjesë të mozaikut të saj të mirëideuar edhe kompaninë më të madhe të sigurimeve, SIGAL.

Themeluesi dhe CEO-s i kompanisë, Avni Ponari, teksa foli mbi rëndësinë që kanë sigurimet në përditshmërinë e gjithsecilit prej nesh, u shpreh se, zyra e SIGAL pranë Piramidës së Tiranës nuk do të jetë thjesht një zyrë ku klientët aktualë dhe të rinj do të marrin shërbime sipas standarteve evropiane por edhe një qendër inovacioni, rekreativiteti dhe auditor leksionesh mbi sigurimet dhe edukimin financiar në përgjithësi.

"Është traditë e SIGAL-it që të jetë gjithmonë pranë gjërave të reja, pranë inovacioneve, pranë zhvillimeve dhe teknologjive. Zhvendosja e një zyre këtu në Qendër të Teknologjisë, mund ta quaj, të Tiranës, afër Piramidës, është një risi për ne sepse me këtë ne përmbushim një detyrim që kemi ndaj stafit tonë dhe ndaj klientëve tanë.

Këtu do të bëhen trajnime të fushave të ndryshme, aq më tepër trajnime për të rinjtë që duan të njohin botën e sigurimeve, një nga më të rëndësishmet në botën e qytetëruar. Për të qenë afër me ne dhe të jenë të punësuarit tanë.

Por nga ana tjetër, ne kërkojmë që, në kuadër të dixhitalizimit dhe futjes së teknologjive të reja, ne t'ju shërbejmë klientëve edhe në pagesën e dëmeve në distancë", u shpreh ndër të tjera Ponari.



FPC Health – Inovacioni që po transformon kujdesin shëndetësor në Shqipëri, nga SIGAL

Në një realitet ku sistemi shëndetësor përballlet me sfida të shumta – që nga mbipopullimi i spitaleve e deri te fragmentimi i informacionit për pacientët – SIGAL sjell një zgjidhje që e çon kujdesin për shëndetin në një tjetër nivel. FPC Health është emri i inovacionit që po sjell transparencë, qasje dhe siguri për çdo individ në Shqipëri dhe më gjerë.

Çfarë është FPC Health? FPC Health është një platformë dixhitale shëndetësore, e integruar plotësisht me sistemin e sigurimeve dhe shërbimeve shëndetësore të SIGAL. Në thelb, ajo është një kartë dixhitale inteligjente që i mundëson çdo klienti të krijojë dhe ruajë një profil të përhershëm shëndetësor, ku përfshihen vizitat, analizat, diagnozat dhe trajtimet, të aksesueshme në çdo kohë dhe nga çdo pajisje. Kjo risi teknologjike nuk është vetëm një përmirësim i shërbimeve ekzistuese, por një transformim i plotë i mënyrës se si trajtohet dhe administrohet shëndeti individual në vendin tonë.

Platformë e aksesueshme për të gjithë FPC Health është pjesë integrale e paketave të sigurimeve shëndetësore të SIGAL, një zhvillim inovativ që do të revolucionarizojë mënyrën se si klientët që kanë një policë sigurimi shëndeti pranë SIGAL të mund të menaxhojnë sa më mirë dhe më thjeshtë sigurimin e tyre. “fpcHealth” përputhet me standardet e larta të teknologjisë dhe sigurisë duke synuar një mjedis dixhital të dizajnuar për të lehtësuar procesin e paraqitjes dhe procesimin të dëmeve shëndetësore. Me anë të një ndërfaqeje të thjeshtë dhe miqësore, përdoruesit mund të hyjnë në sistem, të konsultojnë historikun mjekësor, të ndajnë dokumentacionin me mjekët apo



E shpejtë. E thjeshtë. E sigurt. Sigurimet që mund të blihen online tek SIGAL

Në një botë gjithnjë e më të lidhur me teknologjinë, SIGAL ofron një përvojë të thjeshtë, të shpejtë dhe të sigurt për blerjen e sigurimeve online. Nga komoditeti i shtëpisë apo zyrës suaj, ju mund të siguron veten, familjen dhe pasurinë tuaj në vetëm pak klikime. Ja cilat janë sigurimet që mund të blihen direkt online:



Sigurimet e Automjetit

TPL, Karton Jeshil, Kufitare, Asistencë Rrugore (AutoSOS)



Sigurimi Shëndetësor & Udhëtimit

TeleShëndet, Kartat e Kujdesit Shëndetësor, Shëndet në udhëtim



Sigurimi i Pronës

Shtëpisë/Banesës, për dëmtime, zjarre, vjedhje



Sigurimet e Mjetit Lundrues

Sigurimi i Detyrueshëm për Mjetit Lundrues

Hapni celularin ose laptopin kudo ndodheni, në shtëpi, punë, pushime, madje edhe jashtë Shqipërisë dhe blini ONLINE çdo siguracion që ju nevojitet.

Gjithashtu, SIGAL ONLINE ju ofron mundësinë që, nëse je i siguruar tashmë, të mund të informohesh në kohë rekord se si të veprësh në rast dëmi.

Skuadra jone

Një ekip. Një qëllim.



SIGAL u themelua në shkurt të vitit 1999 dhe prej atëherë operon me sukses në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut përmes 8 kompanive të saj: 3 për Sigurime Jo-Jete, 3 për Sigurime Jete, 1 kompani risigurimi dhe 1 Fond Pensioni. Ajo kryeson tregun në këto shtete dhe renditet ndër 50 kompanitë më të mëdha në Europën Juglindore.

Ky sukses është arritur falë strategjisë së ndjekur, modelit të biznesit, menaxhimit të duhur dhe sigurisht falë stafit profesional. Kompania është rritur vit pas viti, duke arritur sot një pozicion dominues në tregun shqiptar dhe atë rajonal të sigurimeve, pikërisht falë marrëdhënies së veçantë të ndërtuar me stafin e saj.

Ajo ka investuar vazhdimisht në kualifikimin profesional, krijimin e kushteve për rritje dhe zhvillim të potencialit të punonjësve, si dhe në ndërtimin e një komunikimi të qëndrueshëm për shkëmbimin e ideve mbi strategji dhe qasje të reja më efikase.

Në të njëjtën kohë, SIGAL përpaket pandërprerë të afrojtë të rinjtë më të talentuar në tregun e burimeve njerëzore, për t'i bërë pjesë të ekipit të saj.

Ajo është një partner i qëndrueshëm dhe pjesëmarrës aktiv në çdo panair karriere

të universiteteve shqiptare, jo vetëm për të prezantuar industrinë e sigurimeve, por edhe për të rekrutuar drejtpërdrejt më kuriozët dhe më entuziastët për këtë sektor. Takimet për shkëmbim idesh dhe trajnimet e vazhdueshme, brenda dhe jashtë vendit, janë tashmë një traditë e konsoliduar e kompanisë SIGAL.

Sot, SIGAL është e vetmja kompani që ofron të gjitha klasat e sigurimeve, duke numëruar mbi 2400 punonjës dhe agjentë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Ajo ushtron aktivitetin e saj sipas standardeve tërësisht evropiane, duke pasqyruar përpikmërisht kujdesin ndaj nevojave, kërkesave dhe të drejtave të stafit.

Kohëzgjatja mesatare e punonjësve në kompani është mbi 8 vjet, çka tregon aftësinë për të ndërtuar dhe ruajtur marrëdhënie profesionale të qëndrueshme dhe frytdhënëse.

Më shumë se 500 milionë euro dëme të paguara në 25 vite kanë bërë që rreth 1.2 milionë klientë t'i besojnë kësaj kompanie jetën, shëndetin, pronën, automjetin dhe pensionin privat, pa motivimin dhe pa bashkëndarjen me sukses të një filozofie të përbashkët me stafin, nuk do të ishte e mundur.

Përgjegjësi Sociale

“SIGAL Vital Truck” në Divjakë: Shërbim shëndetësor falas dhe afrim më pranë komunitetit



Klinika lëvizëse “SIGAL Vital Truck” qëndroi për dy ditë në prill të 2024 në qytetin e Divjakës, duke ofruar shërbime shëndetësore falas për banorët e zonës. Nisma u shoqërua edhe me një njoftim të rëndësishëm: hapjen së shpejti të një zyre të re në Divjakë, në bashkëpunim me pushtetin vendor. Në një deklaratë për mediat, CEO i SIGAL, z. Avni Ponari, theksoi rëndësinë e sigurimeve si një formë mbrojtjeje gjithëpërfshirëse – për pronat, shëndetin dhe jetën e qytetarëve. Ai vuri në dukje se SIGAL ofron produkte të sigurimit bujqësor dhe shëndetësor që përfshijnë edhe paketa me mbulim të plotë për shpenzimet mjekësore brenda dhe jashtë vendit, me prime që nisin nga vetëm 300 euro në vit.

“Në njërën anë është SIGAL që i promovon dhe i paguan të gjitha faturat dhe shpenzimet dhe kosto e këtij produkti shkon maksimumi deri në 300 euro për vit dhe produkti tjetër është që kujdesesh për veten tënde

duke paguar një prim të caktuar në varësi të gjinisë dhe moshës dhe përfiton një shumë të caktuar nga 500 deri në 500 mijë euro në varësi të primit që paguan”, vijoi ai.

Ndërkohë, Kryetari i Bashkisë Divjakë, z. Josif Gorrea, përshëndeti aktivitetin dhe bashkëpunimin me SIGAL, duke e cilësuar atë si një partner të besuar dhe të rëndësishëm për komunitetin.

Gjithashtu, përfaqësues të Departamentit të Shëndetit në SIGAL prezantuan gamën e gjerë të sigurimeve shëndetësore dhe jetësore që kompania ofron për qytetarët në të gjithë vendin.

Ky aktivitet vjen si pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme të SIGAL për të qenë më afër qytetarëve, duke ofruar jo vetëm produkte sigurimi cilësore, por edhe kujdes shëndetësor të prekshëm në terren.



ORKESTRA E HARQEVE

SIGAL, gjithmonë pranë artit dhe kulturës: Orkestra e Harqeve performon në bregdetin e Adriatikut

Në kuadër të përkushtimit ndaj përgjegjësisë sociale dhe mbështetjes për komunitetin, SIGAL vijon të jetë një nga kontribuuesit më të rëndësishëm në jetën artistike dhe kulturore të vendit.

Një nga ngjarjet më të spikatura ishte mbrëmja muzikore e organizuar në bregdetin e Adriatikut, ku Orkestra e Harqeve "SIGAL" performoi para një audience të për-

bërë nga përfaqësues të lartë të biznesit. Koncerti u prit me duartrokitje dhe vlerësime, duke dëshmuar edhe një herë vlerën që SIGAL i jep artit si mënyrë për të lidhur njerëzit dhe për të frymëzuar shoqërinë.

Orkestra e Harqeve "SIGAL", e themeluar në vitin 2013, është pjesë e Klubit të Artit dhe Kulturës, krijuar nga kompania në vitin 2009. Me 15 instrumentistë profesionistë dhe dirigjent të përhershëm, orkestra ka realizuar me qindra koncerte në qytete të ndryshme të Shqipërisë dhe rajonit, duke promovuar vlerat kulturore dhe artistike.

Ky angazhim është një dëshmi e qartë se SIGAL, përveç rolit të saj si lider në sigurime, është edhe një partner i palëkundur i komunitetit, duke jetuar me bindjen se "Jetojmë më mirë së bashku".

SIGAL vazhdon traditën e pastrimit të bregdetit: Një angazhim i përvitshëm për mjedisin.

Në kuadër të Ditës Botërore të Mjedisit, punonjësit e SIGAL kanë vijuar traditën e përvitshme të pastrimit të zonave bregdetare në Shqipëri, duke dhënë një kontribut konkret për mbrojtjen e ambientit dhe sensibilizimin e komunitetit.

Në Velipojë dhe Golem, degët e kompanisë u angazhuan vullnetarisht për të pastruar zonat më problematike përgjatë vijës bregdetare, duke hequr mbeturinat dhe duke dhënë shembull për një sjellje më të përgjegjshme qytetare.

Ky aksion është pjesë e politikave të qën-

drueshme të kompanisë, që në thelb përfshijnë harmoninë mes aktivitetit të përditshëm dhe kujdesit ndaj natyrës. SIGAL beson se zhvillimi nuk mund të jetë i qëndrueshëm pa një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm.

Përveç aksioneve fizike në terren, kompania ka ndërmarrë edhe hapa konkretë për të reduktuar ndikimin në mjedis, përmes shërbimeve online që ulin përdorimin e letrës dhe ndihmojnë në uljen e ndotjes.

Ky angazhim është një vazhdimësi e misionit të SIGAL, që synon jo vetëm sigurimin financiar të individëve dhe bizneseve, por edhe një kontribut të vazhdueshëm për një shoqëri më të mirë, më të shëndetshme dhe më të ndërgjegjshme.

Aksionet për pastrimin e bregdetit do të vijojnë edhe në ditët në vijim në qytete të tjera të Shqipërisë.



“Reja” nën mbrojtjen e SIGAL Kompania lider siguron instalacionin e famshëm në zemër të Tiranës



Një nga veprat më të njohura të instalacionit të artit publik, “Reja”, ideuar nga artisti i mirënjohur japonez Sou Fujimoto, qëndron prej disa vitesh në zemër të Tiranës, përpara Galerisë së Arteve duke u shndërruar në një ambient kulturor, me aktivitete të shumta për publikun.

Vepra e mirënjohur, e cila ka qëndruar edhe në Galerinë “Serpentine” në Londër, nuk është thjesht një metaforë e motit por një vepër e mirëfilltë arti.

Dhe ku ka art sigurisht që nuk mund të mungonte kompania më e madhe e sigurimeve, SIGAL.

Kompania, e njohur jo vetëm për produktet më novatore të sigurimit dhe mbi 500 milionë euro dëmshpërblime në 25 vjet, është një mbështetëse e fuqishme e artit dhe kulturës.

Për këtë arsye, “Reja” është marrë në sigurim nga SIGAL, si një garanci se instalacioni në fjalë është i sigurtë nga çdo ngjarje e papritur që mund ta dëmtojë atë.

“SIGAL është shoqëria më e madhe e sigurimit në Shqipëri dhe do të jetë një nga sponsorët gjeneralë, që do të kujdeset për sigurimin e pavionit dhe programin e aktiviteteve publike”, shkruan Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit në websiten e saj.

Kjo është një tjetër dhuratë që SIGAL i bën kryeqytetit teksa më herët ka sponsorizuar aktivitete të ndryshme dhe ka ndërtuar fusha sportive.

SIGAL zotohet se sponsorizime të tilla në art, kulturë, sport do të vijojnë edhe në të ardhmen pasi kompania beson fort se me art, kulturë e sport jetohet më mirë.

SIGAL, mbështetëse e “KOSMOS Tirana Music Festival”, aktiviteti që rigjallëroi jetën kulturore në kryeqytet

Mbyllet edicioni i tretë i “KOSMOS Tirana Music Festival”.

Në bashkëpunim me Universitetin e Arteve dhe Liceun “Jordan Misja”, “Kosmos Tirana Music Festival” orgsnizoi masterklase dhe workshope orkestrale për muzikantët e ri shqiptarë.

Gjithçka nisi më 26 deri dhe u mbyll mbrëmjen e djeshme ku në 4 koncerte të ndryshme 10 artistë vendas dhe ndërkombëtarë dhuruan emocione të shumta për artdashësit në Tiranë.

Një event që i dhuroi gjallëri jetës kulturore në Tiranë ku nuk mund të mungonte kompania më madhe e sigurimeve, SIGAL.

“SIGAL është krenare që mbështeti këtë ngjarje të rëndësishme, duke i dhënë artit dhe muzikës rëndësinë e merituar.

Faleminderit të gjithëve që ishin pjesë e kësaj eksperience të mrekullueshme”, shkruan SIGAL në rrjetet e saj sociale.

SIGAL, gjithmonë pranë Artit dhe Kulturës Prej mbi 25 vjetësh në treg tashmë, kompania më e madhe dhe më e besuar e sigurimeve në vend, SIGAL, i ka dhënë një rëndësi të veçantë edhe përgjegjësisë sociale teksa ka qenë mbështetëse e shumë aktiviteteve, në fusha të ndryshme.

Pikërisht në kuadër të Përgjegjësisë Sociale ndaj Komunitetit dhe nën moton “Jetojmë më mirë së bashku”, SIGAL, në vitin 2009 ngriti Klubin e Artit dhe Kulturës.



Në këtë klub janë zhvilluar dhjetëra aktivitete kulturore ndër të cilat ekspozita pikturë, mbrëmje muzikore, portrete artistësh, promovime librash dhe seminare me tematika të ndryshme.

Duke besuar se arti në përgjithësi dhe muzika në veçanti lumturon njerëzit duke shtuar shpresën tek ta, prej vitit 2013, pjesë e Klubit të Artit është Orkestra e Harqeve “SIGAL”, e përbërë nga 15 instrumentistë profesionistë dhe një dirigjent.

Orkestra u ngrit nën idenë e themeluesit dhe drejtuesit të kompanisë, z. Avni Ponari ndërsa prej vitit 2013 ka dhënë me qindra koncerte në thuajse të gjitha qytetet e Shqipërisë, Vlorë, Elbasan, Durrës, Pogradec, Butrint, Shkodër, Lezhë, Valbonë etj, në Kosovë, rajon etj.



SPORT

Sigurimi për Sportistët SIGAL partneri besnik i FSHF. Ndërtimi një karrierë të suksesshme

Federata Shqiptare e Futbollit dhe SIGAL zhvilluan një takim informues në "Shtëpinë e Futbollit" me përfaqësues të klubeve të Kategorisë Superiore në prag të fillimit të sezonit të ri futbollistik 2024/2025, që do të ngrejë siparin të dielën më 18 gusht.

Fokusi i diskutimeve ishte përditësimi i politikave të sigurimit të lojtarëve të Kategorisë Superiore dhe protokollet që ndiqen në rastet e dëmtimeve të lojtarëve.

SIGAL prezantoi disa paketa të sigurimit për

klubet, që përfshijnë lojtarët e akademive, të cilët mund të aktivizohen edhe me ekipin e parë dhe mund të përfitojnë nga rimbursimi në rast dëmtimi.

Federata Shqiptare e Futbollit dhe SIGAL kanë një bashkëpunim të suksesshëm që prej vitit 2016-të. SIGAL është një ndër sponsorët kryesorë të FSHF-së dhe Kombëtares së futbollit teksa kontributi dhe mbështetja gjatë gjithë këtyre viteve ka qenë e madhe.

Por çfarë mbulon "SIGURIMI I SPORTISTËVE" nga SIGAL?

Si sportistë profesionistë, por edhe nëse jeni sportistë amator, ju do të keni nevojë për sigurimin nga dëmtimet apo aksidentet që mund të ndodhin.

PAKETA E "SIGURIMIT PËR SPORTISTËT" NGA SIGAL OFRON MBULIM PËR:

- Humbje jete në rast aksidenti sportiv

- Paaftësi e përkohshme në rast aksidenti sportiv
- Paaftësi e përkohshme (Shpërblim ditor)
- Shpenzime mjekësore në rast aksidenti sportiv

Përfitimet:

- Garanci financiare për sportistin për shpenzime mjekësore nga aksidenti
- Vlerë për punëdhënësin që siguron sportistët
- Garanci për ekipin që detyrimet që mund ti lindin i paguan siguruesi

Kujt mund ti ofrohet?

- Të gjitha Federatave
- Të gjitha ekipeve sportive
- Sportistëve në sporte individuale

Sa kushton?

Dhe nuk kanë qenë të paktë sportistët që kanë përfituar nga ky sigurim.

Një prej tyre është edhe basketbollistja e Flamurtarit, Serena Brahimaj.

"Për këdo që merret me sport rreziku për dëmtime është shumë i lartë. Ndaj sigurimi është shumë i rëndësishëm. Këtë e vërteton edhe eksperiencia ime personale.

Pas një dëmtimi që pësova në këmbë mu desh ti drejtohesha një prej spitaleve private në vend dhe fatmirësisht gjithçka shkoi mirë dhe sot jam sërish në fushën e lojës".

SIGAL, gjithmonë në mbështetje të Sportit Sporti ka një rëndësi të veçantë për një shoqëri. Jo vetëm në aspektin fizik dhe mendor por edhe përfaqësimit në kompeticione ndërkombëtare si ambasadorja më e mirë e vendit.

Për këtë SIGAL ka qenë dhe vazhdon të jetë përkrah sportit si sponsor zyrtar i Kombëtares Shqiptare të Futbollit dhe klubit

më të famshëm të basketbollit në Kosovë, SIGAL Prishtina. Por pa anashkaluar edhe investime të tjera.

Nuk duhet të ndaleni. Nëse hasni në një pengesë, SIGAL është pranë jush në çastet tuaja më të vështira. Për këtë arsye, ju ftojmë të blini Sigurimi nga Aksidentet për Sportistët në mënyrë që karriera juaj të mos mbetet në duart e fatit.

Kampionët me kampionët Vijon bashkëpunimi KB Prishtina-SIGAL UNIQA



Klubi i Basketbollit Prishtina dhe kompania e sigurimeve, SIGAL UNIQA Group Austria vazhdojnë bashkëpunimin ndërmjet tyre.

Kryetari i klubit Blerand Stavileci tha gjatë konferencës për media se, bashkëpunimi me SIGAL UNIQA e ka ndihmuar Prishtinën që ta vazhdoj rrugën e sukseseve dhe fitimin e trofeve të shumtë.

Ai shtoi se për 21 vjet bashkëpunim këto dy brende kanë qenë shembull i bashkëpunimit edhe për klubet tjera në Kosovë, ndërsa shtoi se CEO i SIGAL UNIQA, Avni Ponari ka qenë gjithmonë afër klubit duke e mbështetur atë në situata të mira por edhe të vështira.

Nga ana tjetër, Avni Ponari theksoi se këto dy brende janë rritur duke shënuar suksese të përbashkëta dhe duke arritur trofe të shumtë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Ai shtoi se ndihet krenar me bashkëpunimin e KB Prishtinës gjatë gjithë këtyre viteve dhe është i lumtur që do të vazhdojë ta mbështesë këtë klub.

SIGAL UNIQA, GJITHMONË PRANË SPORTIT
SIGAL UNIQA ka qenë gjithmonë një ogur i mirë për sportin dhe sportistët.

Luiza Gega e ka nisur aktivitetin e saj me logon e SIGAL UNIQA-s. Edhe Izmir Ismajlaj e ka nisur aktivitetin e tij po me logon e kompanisë më të madhe të sigurimeve.

Me sponsor gjeneral SIGAL UNIQA-n, Valbona ishte ekipi që udhëhoqi për 5 vite rresht basketbollin në Shqipëri. Ndërsa sot vijon të jetë sponsorë të kombëtareve të futbollit dhe të basketbollit në Shqipëri dhe Kosovë dhe mbështet një seri aktiviteteve sportive siç është edhe "LIGA UNIKE" në basketboll.

Në SIGAL UNIQA besojnë fort se Sporti është mjeti më efikas i edukimit, i argëtimit, i parandalimit të sëmundjeve, dhe forcimit të marrëdhënieve sociale.

Trofetë e fituar nga SIGAL PRISHTINA:
Superliga Kosovare të Basketbollit
1991, 2002, 2003, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2014, 2015, 2016, 2017, 2019



Kupa e Kosovës
2002, 2003, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2013, 2014, 2016, 2017, 2018, 2019, 2021

Liga Ballkanike
2014-2015; 2015-2016; 2023-2024



Ambassador's Cup në Judo dhe Karate përmbillet me sukses në Tirana Olympic Park, me mbështetjen e SIGAL

Më 3 nëntor 2024, Tirana Olympic Park u shndërrua në një qendër entuziazmi dhe kompetence sportive ndërsa priti ngjarjen prestigjioze të Ambassador's Cup për disiplinat e Judos dhe Karates.

Ky aktivitet, i cili mbledhi bashkë sportistë të rinj dhe me përvojë nga Shqipëria dhe rajoni, shënoi një tjetër hap të rëndësishëm në promovimin e sporteve luftarake në vendin tonë.

Një faktor kyç në suksesin e eventit ishte mbështetja e SIGAL, një kompani që ka treguar përkushtim të vazhdueshëm ndaj zhvillimit të sportit dhe aktiviteteve kulturore në rajon.

Përkushtimi për sportin dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

Ambassador's Cup u organizua me synimin për të nxitur bashkëpunimin ndërkombëtar përmes sportit, duke sjellë së bashku sportistë, trajnerë, ambasadorë dhe entuziastë të kulturave të ndryshme. Eventu ishte një mundësi e veçantë për të promovuar vlerat e disiplinës, respektit dhe frymës së garës së ndershme. SIGAL, si një mbështetëse e fuqishme e eventit, kontribuoi në krijimin e një atmosfere të sigurt dhe të organizuar për pjesëmarrësit dhe për të gjithë ata që ndoqnë garat.

Mbështetja e SIGAL për Ambassador's Cup është dëshmi e mëtjeshme e përkushtimit të kompanisë për të qenë një faktor pozitiv në jetën e komunitetit. Përmes sponsorizimeve dhe mbështetjes për aktivitete sportive të këtij lloji, SIGAL synon të inkurajojë një mënyrë jetese të shëndetshme dhe të përfshijë më shumë të rinj në aktivitete që përçojnë vlera pozitive.

Jehona Mediatike

Ponari propozon zgjidhjen për pensionet: Sigurim i detyrueshëm me dy pjesë



Teksa pensioni shtetëror, për shkak edhe të krizës që ndodhet, nuk ofron të ardhura të mjaftueshme për përballimin e kostove të jetesës.

1 në 5 shqiptarë sot është i moshuar. Nga rreth 2.4 milionë qytetarë në total, më shumë se 473 mijë janë mbi 65 vjeç.

Ekspertët po shqyrtojnë opsione të ndryshme që mund të ndihmojnë skemën por edhe qytetarët që këta të fundit të kenë të ardhura të kënaqshme dhe të mjaftueshme në momentin që ndalojnë së punuari.

I ftuar në emisionin “Pro Business” në Klan Plus, CEO i SIGAL UNIQA, Avni Ponari u shpreh se, kombinimi i pensionit shtetëror me atë që merr në privat bën që shuma të jetë e kënaqshme për pensionistët dhe ti përgjigjet kostove të jetesës.

AVNI PONARI: Shumë ndërmarrje dhe shumë individë, po afrohen me shumë shpejtësi dhe po krijojnë vlerat e tyre për pensionin dhe kjo është një garanci

shumë e mirë sepse në qoftëse në shtet ti ke një pension 20 mijë lekë të reja dhe do marrësh 400 apo 500 në privat, pra pensioni yt shkon 700 mijë lekë (të vjetra) në total i gjithi së bashku. Kështu që krijimi i kësaj incentive dhe krijimi këtij sistemi të tillë e bën të mundur që ti të marrësh një vlerë të caktuar. Shqipëria është nga të paktat vende që nuk e ka kolonën e dytë të investimeve. Që do të thotë, shteti përveç Sigurimeve Shoqërore që është 27% që paguhet nga paga, atëherë kjo 27 ndahet në 25 përshebull do ti çosh tek Sigurimet Shoqërore dhe 2% janë të detyrueshme ti çosh te një skemë e pensioneve private. Pra, ky është një stimulim shumë i madh, një mbështetje e madhe dhe një lehtësim i barrës së sistemit të Sigurimeve Shoqërore. Z.Ponari dha edhe një shembull se si mund të përfshihet pensioni privat me detyrim duke e ndarë në dy pjesë.

AVNI PONARI: Skema aktuale ka mangësi. Dhe nga ajo që kam dëgjuar thuhet se nuk funksionon se në Shqipëri janë 700 mijë pensionistë që marrin pensionin dhe janë 700 mijë të punësuar. Pra raporti është

1 me 1. Atëherë duke qënë ky raport, në të gjithë botën është 1 me 2, me 3 me 4, pra 4 punojnë dhe 1 merr pension. Ne nuk kemi këtë skemë. Kjo skemë duhet të ishte vendosur 20 vite përpara ose 30 vite përpara. Kjo skemë e cila ndante sigurimin e detyrueshëm në dy pjesë, tek sigurimet vullnetare 2%, 1%, 1.5%, pastaj qytetarët këtë 2% mund ta plotësojnë edhe me para të tjera për të marrë një pension më të lartë. Ka një gjë që Instituti i Sigurimeve Shoqërore do që të jetë pesha e madhe, që të gjitha fondet të shkojnë tek ai, por

dashamirësia e Institutit, e Ministrisë së Financave, e Qeverisë me ligj e përcaktojnë qartë dhe e bëjnë. Pra Maqedonia e Veriut është me këtë skemë, Bosnja dhe vendet e Rajonit pothuajse të gjitha janë me këtë skemë. Edhe vendet e tjera përreth nesh janë me këtë skemë, pasi këto janë më eficientë dhe krijojnë mundësi të çdo njeriu të kenë një pension normal dhe kushte të mira jetese. Në Gjermani përshembull njerëzit investojnë në 2-3 fonde”.

“Sigurimi anti-Tumor” dhe “Jetë Plus”/ Ponari shpjegon në “Wake Up” paketat e sigurimit që shpëtojnë jetë



CEO i “SIGAL UNIQA”, z.Avni Ponari ishte i ftuari i emisionit “Wake Up” në Top-Channel dhe Top Albania Radio ku foli mbi sigurimet dhe ato çfarë ofron kompania që ai drejton.

Teksa jemi ende në “Tetorin Rozë” dhe kur sëmundjet e rënda njohin rritje të vazhdueshme, Ponari u ndal tek dy produktet unike që ofron “SIGAL UNIQA”: **Sigurimi**

“Jetë Plus” dhe ai “Anti-Tumor”.

“Periudha pas Covid ka bërë shumë ndryshime në sistemin shëndetësor dhe ndryshimet janë jo të pakta. Kompani të mëdha si SwissRe kanë bërë studime dhe kanë dalë në shumë konkluzione. Shfaqja e kancerit po bëhet pak më masive, por themelore është fakti që kanceri sot është

plotësisht i shërueshëm.

Për çdo rast kompanitë kanë krijuar këto paketa, sigurimin AntiTumor që janë shumë të rëndësishme dhe shumë të veçanta, sepse njerëzit mund të përfitojnë në mënyrë të menjëherëshme edhe në cash vlera të caktuara, por edhe mbulim në sigurim në spitalet më të mira të Europës, në një vlerë deri në 1 milion euro. Të gjitha këto vlera janë ato që i ofrohen çdo klienti që ka këtë lloj sigurimi.

Mbulimi i Antitumorit ka një kosto të vogël për klientin që varion nga 50 euro në vit deri në aq sa do të gjesh shumën e siguruar. Pra për 50 euro në vit, në rast konstatimi do të marrësh 10 000 euro. Është i mjaftueshëm për të bërë kontrolle dhe për ta ndihmuar veten në pjesën dërrmuese të spitaleve të Europës.

E veçanta është se ne marrim dy konstatime, dy opinione. Në 7% të rasteve të konstatuara me kancer të siguruar te SIGAL, 7% kanë rezultuar jo me kancer pasi kemi marrë opinionet në spitalet në Europë. I është dhënë diagnoza këtu me kancer, i është dërguar diagnoza në spitalet dhe kemi marrë opinionin tjetër që nuk ka rezultuar me kancer. Marrja e dy-tre opioneve të tjera është shumë e rëndësishme”, tha Ponari.

Po nëse është një person që nuk është i siguruar dhe është konstatuar me kancer, ka dëshirë të bëjë sigurimin në kompaninë tuaj?

“Sëmundjet paraekzistuese nuk mund të futen brenda skemës, sepse është një lloj si të jetë një makinë e prishur dhe ti ta sigurosh me KASKO. Ka një kohë pritje. Nëse dikush do të bëjë sigurimin Antitumor, ai duhet të paraqitet, të marrë siguracionin dhe për 6 muaj është në periudhë pritje. Pas 6 muajsh çdo gjë që ndodh, mbulohet nga kompania e sigurimit”, u shpreh CEO i SIGAL UNIQA, i cili ka edhe një mesazh për qytetarët:

“Ajo që dua t’i them të gjithë qytetarëve është se, nëse futesh në një skemë sigurimi shëndetësore private mos dil më. Në moshat mbi 65 vjeç asnjë kompani sigurimi nuk ju merr më në sigurim, prandaj përfshihesh në një moshë më të re. Futesh në historikun e kompanisë”.

Më pas z.Ponari u ndaj edhe te Sigurimi “Jetë Plus”.

“Varianti i dytë është Jetë Plus që ka një kosto pak më të lartë. Këto janë produkte që shiten masivisht në Europë dhe SHBA. Jetë Plusi përveç kancerit, ka edhe sëmundje të tjera, siç është transplant, zemra dhe sëmundje të tjera. Është një paketë e plotë dhe ka një mbrojtje deri në 1 milion euro për klientin.

Të gjitha faturat që të përkasin ty si klient, deri në vlerën 1 milion euro i paguan SIGAL. Klienti ka të drejtë nga tre spitale, ta zgjedhë vetëm njërin. Madje me Jetë Plus paguhet edhe një shoqërues me 100 euro në ditë gjatë kohës së qëndrimit në spital”.

A janë të sensibilizuar shqiptarët kur vjen puna të blerja e paketëve të shëndetit?

“Brezi i ri është më i ndërgjegjshëm, është më afër gjërave të reja që ndodhin në botë, ka një rritje të njerëzve që vijnë vullnetarisht apo e blejnë në rrjetet tona online. Ka një rritje të ndërgjegjësimit të njerëzve, ka një rritje të fluksit”.

Po kompanitë që kanë stafe të mëdha, afrohen për të bërë këto lloj sigurimesh?

“Këto sigurime në i kemi me korporata më shumë, bankat, kompanitë e mëdha në Shqipëri, pothuajse të gjitha ambasadat, grupe pedagogësh të universiteteve. Është një kategori mjaft e madhe grupimesh që i kërkojnë dhe i kanë marrë”, tha ndër të tjera Avni Ponari.



Pensionet private/ Ponari: Shqiptarët po investojnë për të “pleqëruar me dinjitet”

Shqiptarët po investojnë për të “pleqëruar me dinjitet”.

Pasiguritë ekonomike bashkë me plakjen e shpejtë të popullsisë nga njëra anë, shtuar dhe faktin se ajo që të moshuarit në vend marrin nuk mjafton, po i shtyn qytetarët drejt skemave private të pensioneve.

Nga pak më shumë se 38 mijë fundvitin e shkuar, numri i atyre që kontribuojnë vullnetarisht arriti në gati 40 mijë në fund të marsit.

“Ligji i fundit për rregullimin e skemës së pensioneve private vullnetare ka bërë të mundur dhe ka krijuar disa incentiva për disa punonjës që futen në këto skema.

Nga ana tjetër, ligji ka krijuar edhe lehtësi të punëmarrësit që të bëjë një pjesë të zbritshme nga paga e punonjësve. Kjo ka bërë që të rritet numri i të interesuarve”, thotë për A2 CNN Avni Ponari, CEO i SIGAL UNIQA Group Austria.

Të dhënat nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare tregojnë se vlera e parave të investuara në skemat private të pensioneve në fund të marsit arriti në 6.8 miliardë lekë duke u zgjeruar me 5.4% në raport me fundvitin e shkuar.

Po a ja vlen investimi në skemat private dhe sa mund të jetë vlera e pensionit që i moshuari do të marrë kur të arrijë moshën? “Nis nga 30-40, 50 apo edhe 70 mijë lekë nga skema vullnetare private dhe 20-30 mijë lekë nga ajo publike. Në fund, ai që del në pension merr rreth 1 milionë lekë të vjetra në muaj”, vijon Ponari.

Ponari thekson edhe nevojën për më shumë ndërgjegjësim tek qytetarët.

“Duhet nisur me ndërgjegjësimin. Si çdo gjë e re edhe skema private vullnetare e pensioneve paragjykohet. Duhet të mësohemi mos paragjykojmë gjithçka.”

Shtimi i sëmundjeve kancerogjene Ponari: Me SIGAL UNIQA, shërbime në klinikat dhe spitalet më të mira në botë

Edhe për shkak të COVID-19 dhe pasojave që la pas, numri i rasteve me kancer në Shqipëri, ashtu si në të gjithë botën, po njihet vetëm rritje, duke mos kursyer as moshat e reja.

Në Shqipëri regjistrohen mbi 7000 raste të reja me kancer çdo vit duke bërë që përveç presionit psikologjik për tu përballur me sëmundje të tilla, qytetarët të përballen edhe me shpenzime të mëdha financiare. Sepse kurimi i sëmundjeve kaq serioze kërkon shumë para.

Por ka gjithmonë një dritare shprese.

Në një intervistë për Top News, CEO i kompanisë më të madhe të sigurimeve SIGAL UNIQA, e njohur për produktet e saj unike në sigurimet shëndetësore, Avni Ponari na njeh me atë çfarë ofron kompania që ai drejton në luftën kundër sëmundjeve tumorale, “Sigurimi anti-Tumor” dhe “Jetë Plus”.

“SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA një nga kompanitë më të mëdha në rajon, ka kohë që ka nxjerrë në treg produkte që janë shumë të rëndësishme.

Ne nuk parandalojmë sëmundje, ne e



mjekojmë dhe e kurojmë në metoda më të mira të sotme botërore dhe shkencore.

Mendoj që është moment i rëndësishëm që çdo qytetar shqiptar t’ju drejtohet zyrave të SIGAL kudo ku ndodhet, edhe online e të ketë këtë lloj sigurimi që është shumë i rëndësishëm”, u shpreh ndër të tjera Ponari.

Humbi jetën në minierë, SIGAL UNIQA dëmshpërblen familjen me 60 milionë lekë/ Ponari- bizneseve: Siguroni punonjësit tuaj!

Aksidentet janë bërë sot pjesë e përditshmërisë sonë. Çdo ditë, në çdo cep të Shqipërisë, dëgjojmë për aksidente të ndryshme me pasoja për jetën e njeriut. Kjo për shkak të pakujdesive por edhe për shkak të ritmeve të zhvillimeve ekonomike, që po rriten ditë pas dite, kryesisht në sektorë si ndërtimi apo minierat.

I tillë ishte edhe aksidenti fatal në Minierën

e Thekënit në Martanesh, të martën e 21 Majit, ku si pasojë e një aksidenti në galeri humbi jetën 29-vjeçari Armond Peshku.

Kompania ku punonte i riu i kishte siguruar punonjësit e saj pikërisht pranë “SIGAL UNIQA Group Austria”, konform ligjit Nr.1109, datë 30.7.2008 “PËR SIGURIMIN PUNONJËSVE, TË PUNËSUAR NË VEPRIMTARINË MINERARE, NGA AKSIDENTET NË PUNË”.

Për ti shprehur ngushëllimet familjes dhe për të përmbushur një detyrim kontraktual të kompanisë që ai drejton, dëmshpërblimin prej 60 milionë Lekësh, familjen Peshku në Martanesh e vizitoi edhe CEO i “SIGAL UNIQA Group Austria”, z. Avni Ponari.

“Ne përmbushëm një detyrim sot. Sepse kompania ku djali i tyre punonte, kishte bërë sigurimin e punonjësve të të gjithë minierës. Çka bëri të mundur që, ne, menjëherë pas njoftimit, nuk pritëm asgjë më tepër, për ti ardhur në ndihmë familjes. Familjes natyrisht që nuk mund tu kthejmë të afërmin e tyre por një pjesë të asaj dhimbje ta kalojnë duke përmbushur ne detyrimin tonë financiar.

Një shumë prej 60 milionë lekësh shkon në duart e prindërve të të ndjerit. Duke bërë të mundur për ne përmbushjen e detyrimit një javë pas ndodhjes së aksidentit. Dhe natyrisht familjes për ti krijuar një lehtësim në dhimbjen që ata kanë”, tha ndër të tjera Ponari.

Në fund, nuk mungoi edhe një sensibilizim për të gjitha kompanitë në Shqipëri.

“Unë sot, këtu nga Martaneshi, i bëj thirrje të gjithë kompanive kudo që ndodhen, siç bëri kompania ku punonte djali i Muharremi, të tregojnë kujdes për punonjësit e tyre. Të bëjnë sigurimin nga aksidentet, të bëjnë sigurimin e jetës. Ky lloj siguri sot është domosdoshmëri për çdo njeri, për çdo kompani”.



Zjarre, tërmete.../ Ponari: Sigurimi, mundësia e vetme për të mbrojtur pronën

Kapriçot e motit, zjarret thuajse të përditshme në banesa dhe biznese dhe së fundmi edhe tërmetet kanë rikthyer tek ne rrezikun që i kanoset çdo prone që posedojmë.

Por pavarësisht se Shqipëria, për shkak të pozicionit gjeografik, rënditet mes vendeve më të rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore, sërish vihet re një ndërgjegjësim minimal tek qytetarët mbi rëndësinë e sigurimeve.

Në një intervistë për Top News, CEO i SIGAL UNIQA Group Austria, z. Avni Ponari është shprehur se, nisur nga këto të dhëna, Sigurimi i Pronës nga këto rreziqe është një domosdoshmëri dhe diçka që e bën e

gjithë bota.

“Prania e zjarreve sot është bërë një fenomen sa mund të quhet edhe i zakonshëm. Nga ana tjetër, edhe përmbytjet, edhe tërmetet e ditëve të fundit tregojnë që përsëri atë që ne e kemi thënë gjithmonë: Shqipëria ndodhet në atlasin botëror për rreziqet evidente siç janë zjarret, tërmetet dhe katastrofat e tjera.

Mbi këtë bazë, ajo që unë do të thoja është që, qytetarët duhet të zgjedhin një rrugë që është e domosdoshme dhe që është e përbotshme, sigurimet.

Sigurimet nuk i parandalojnë këto ngjarje, sigurimet zvogëlojnë dëmin. Ato i rikthejnë financiarisht në gjendje e mëparshme.

Kështu që, ne kur flasim dhe tërheqim vëmendjen, me bindjen se njerëzit duhet ta dinë se ka një mundësi për të mbrojtur shtëpinë nga zjarri, ka një mundësi për të mbrojtur shtëpinë nga tërmeti. Apo për të mbrojtur shtëpinë nga përmbytjet. Dhe

këto bëhen përmes sigurimit që është aq i domosdoshëm dhe aq i përbotshëm”.

Themeluesi dhe CEO i kompanisë më të madhe të sigurimeve në Shqipëri na tregon edhe se sa kushton Sigurimi i Shtëpisë. “Por a është e vështirë të sigurohesh? Natyrisht që jo! Sa janë kostot e sigurimit? Natyrisht që janë të vogla!

Ka ardhur momenti që çdo njeri duhet ta ketë përcaktuar në ndërgjegjen e tij një shpenzim fare të vogël për Sigurimin e Banesës, qoftë nga zjarri, qoftë nga tërmeti, qoftë nga rreziqe të tjera. Dhe kostoja shkon 1 euro në vit për metër katror. Pra është një kosto mjaft e vogël. Njerëzit nuk e dinë çfarë do të thotë kjo.

Nëse një apartament është 100 metër katrorë maksimumi i sigurimit shkon rreth 100 euro në vit. Dhe ti je i mbrojtur edhe nga zjarri, edhe nga tërmeti, edhe nga fatkeqësitë të tjera”.

Në fund të intervistës, z. Ponari ka një apel për qytetarët.

“Unë dua ti them çdo qytetari që, është e mundur për ta bërë këtë sepse i bie 50 cent në ditë apo më pak. Dhe për të qenë i sigurtë në ditët e ardhshme me pasurinë e krijuar me shumë mund”.

Pse të zgjidhni sigurimin e shtëpisë apo apartamentit tek SIGAL UNIQA?

Ajo është kompania më e madhe dhe më e besuar e sigurimeve në Shqipëri dhe një ndër 50 më të mëdhatë në Europën Juglindore.

Si mund ta blejmë Sigurimin e Pronës?

Në çdo zyrë SIGAL UNIQA në qytetin tuaj ose Online në www.sigal.com.al

Mbroni shtëpinë, apartamentin dhe çdo pronë tjetër nga zjarri dhe katastrofat natyrore.

Elvis Ponari: Sigurimet dhe pensionet private, prirje drejt dixhitalizimit dhe inovacionit

“Shoh një prirje drejt dixhitalizimit dhe inovacionit më të madh në sektorët e sigurimeve dhe pensione”

Kështu shprehet në një intervistë për “FIAA”, “Foreign Investors Association of Albania”, Elvis Ponari, CEO i “SIGAL UNIQA Fond Pensioni”.

Ponari flet edhe për tregun e sigurimeve, ndikimin e zhvillimeve teknologjike në këtë sektor, lidhjen e tij të fortë me Austrinë ndërsa nuk mungojnë as këshillat.

INTERVISTA:

FIAA: Ju jeni CEO i “SIGAL UNIQA Fond Pensioni”. Sa sfiduese është të operosh në një fushë ende të panjohur për qytetarët shqiptarë? Pse ka kuptim kërkimi i zgjidhjeve të pensioneve private në Shqipëri dhe cila është përvoja austriake në këtë drejtim?

Ponari: Të operosh në një fushë që është ende e panjohur për shumë shqiptarë mund të jetë vërtet sfiduese, por gjithashtu paraqet një mundësi për edukim dhe informim. Pensionet private u ofrojnë individëve mundësinë për të marrë kontrollin e së ardhmes së tyre financiare në dorë, në vend që të mbështeten vetëm tek pensionet shtetërore.

Duke kuptuar përfitimet e pensioneve private dhe duke hedhur poshtë çdo bestytini apo keqkuptim, shqiptarët mund të marrin vendime të drejta nga të cilat do të përfitojnë në planin afatgjatë.

FIAA: Një nga arritjet e fundit në sektorin tuaj ka qenë miratimi i ligjit për fondet private të pensioneve. Si Kryetar i Shoqatës së Siguruesve të Jetës, Fondeve të Investimit dhe Pensioneve Private, a ju është dashur të përdorni ndonjë “shtrëngim duarsh sekret” për të miratuar këtë ligj?

Ponari: Mund të them se lobimi për ligjin



për fondet private të pensioneve erdhi më tepër pas përpjekjesh të tëra bashkëpunimi. Shoqata punoi me vendosmëri për të edukuar politikëbërësit dhe publikun për rëndësinë e pensioneve private sa i përket sigurisë financiare pas daljes në pension. Ishte një proces sfidues, por në fund shpërblyes, pasi ligji ka pasur një ndikim pozitiv në industrinë dhe tek qytetarët shqiptarë.

FIAA: Si një person i përfshirë thellësisht në sektorët e sigurimeve dhe pensioneve, cilat janë disa tendenca apo rritje kryesore që parashikoni të formësojnë industrinë në Shqipëri në vitet e ardhshme?


Ponari: Nuk mund të parashikoj të ardhmen me siguri, por shoh një prirje drejt dixhitalizimit dhe inovacionit në sektorët e sigurimeve dhe pensioneve. Tashmë po shohim përdorimin e Inteligjencës Artificiale dhe analitikës së të dhënave për të thjeshtuar proceset dhe për të përmirësuar përvojat e klientëve.

Teksa teknologjia vazhdon të evoluojë, kush e di çfarë zhvillimesh emocionuese kemi përpara!

Ndoshta një ditë ne do të sigurojmë hoverboard-et tona kundër përplasjeve dhe lëndimeve, apo edhe do të krijojmë fonde pensioni për asistentët tanë robotë!

Tregu i Sigurimeve

SIGAL – Lider Rajonal në Sigurime: Një vit sukcesi në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut



Viti 2024 shënoi një tjetër kapitull të rëndësishëm në historinë 25-vjeçare të Grupit SIGAL, duke konfirmuar pozicionin e padiskutueshëm si lider absolut në tregun e sigurimeve në Shqipëri, në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

Me një model biznesi të ndërtuar mbi trans-

parencën, përgjegjshmërinë, cilësinë dhe përkushtimin ndaj klientit, SIGAL ka arritur të ofrojë shërbime të nivelit evropian për mijëra qytetarë dhe biznese në të gjithë rajonin, duke u bërë një emër që mishëron sigurinë dhe besimin.

Shqipëri

Në Shqipëri, performanca e SIGAL gjatë vitit 2024 ka qenë mbresëlënëse dhe dominuese në të gjitha segmentet e tregut.


Sipas të dhënave zyrtare nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), kompania ka përmbyllur vitin me një pjesë tregu prej 27% në sigurimet e Jetës dhe Jo-Jetës, një tregues i qartë i diferencimit nga çdo konkurrent tjetër.

Në sigurimet e pronës, SIGAL ka arritur të mbulojë 40.2% të tregut, duke garantuar siguri për pasuritë e mijëra familjeve dhe bizneseve shqiptare. Në segmentin e sigurimeve shëndetësore dhe aksidenteve, kompania mban një pozicion lider me 50.34% të tregut, ndërsa në sigurimet motorike për automjete mbulimi ka arritur në 20.91%.

Këto rezultate dëshmojnë jo vetëm pozicionimin si lider i tregut, por mbi të gjitha besimin që qytetarët dhe bizneset shqiptare kanë ndërtuar me SIGAL ndër vite. Vetëm në katër muajt e parë të vitit 2025, SIGAL ka paguar mbi 641 milionë lekë dëme në sigurimet e Jetës dhe Jo-Jetës, duke përfshirë 396 milionë lekë në sigurime motorike, 124 milionë në sigurime shëndetësore dhe 72 milionë në sigurime prone – shifra që konfirmojnë fuqinë financiare dhe përkushtimin real për t'i qëndruar pranë klientit në çdo moment.

Fondi Pensioneve

Gjatë vitit 2024, Fondi i Pensionit Privat SIGAL ka ruajtur një pozicion të rëndësishëm në tregun shqiptar të pensioneve private, duke zotëruar 39.12% të tregut total, sipas të dhënave zyrtare të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Kjo pjesëmarrje reflekton rritjen e besimit të kontribuuesve ndaj menaxhimit të qëndrueshëm dhe profesional të fondit, i cili ka ofruar kthime të qëndrueshme dhe një strategji të kuj-



deshme investimesh. SIGAL ka vijuar të promovojë kulturën e kursimit për pleqëri, duke zgjeruar ndjeshëm rrjetin e anëtarëve dhe duke ndihmuar qytetarët të ndërtojnë siguri financiare për të ardhmen e tyre.

Në të tre vendet ku është i pranishëm, Grupi SIGAL UNIQA ka ndërtuar një kulturë të fortë korporative që i jep prioritet inovacionit dhe teknologjisë, duke ofruar platforma dixhitale të avancuara, shërbime moderne si tele-mjekësia dhe një gamë të gjerë produktesh të përshtatura për nevojat e çdo individi, familjeje apo biznesi. Përdorimi i platformave online për blerjen, menaxhimin dhe aktivizimin e produkteve të sigurimit, si dhe asistencë 24/7 nëpërmjet kanaleve të ndryshme të komunikimit, janë bërë tashmë standard i pandashëm i shërbimit të SIGAL.


Kosovë

Në Kosovë, SIGAL ka vijuar të forcojë pozicionin si një nga kompanitë më të rëndësishme në sektorin e sigurimeve, me një pjesëmarrje totale në treg prej afërsisht 14% në segmentet jetë dhe jo-jetë. Gjatë vitit 2024, kompania ka realizuar një nga marrëveshjet më të rëndësishme strategjike në tregun kosovar, duke firmosur një

partneritet me TEB Bank për ofrimin e produkteve të sigurimit përmes degëve bankare.


Ky bashkëpunim i ri, i licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës, i jep mundësi qytetarëve të kenë akses të shpejtë dhe të lehtësuar në shërbimet sigurative të SIGAL përmes një rrjeti të gjerë degësh. Përveç rritjes në aspektin tregtar, SIGAL Kosovë ka dhënë një shembull të fuqishëm edhe në aspektin.

Ky angazhim institucional për barazinë gjinore në drejtim dhe menaxhim është një dëshmi konkrete e vlerave që përfaqëson SIGAL dhe vullnetit për të qenë një kompani moderne, e përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse.



Maqedoni e Veriut


Në Maqedoninë e Veriut, pavarësisht sfidave dhe ndryshimeve të natyrës korporative, UNIQA ka vijuar të ruajë një pozicion të rëndësishëm në një treg që gjatë vitit 2024 ka shënuar rritje të qëndrueshme me mbi 90,171 mijë denarë prime të shkruara bruto. Me një pjesëmarrje të konsiderueshme jetë dhe jo-jetë – kompania ka vazhduar të jetë një ofrues i besuar për qytetarët dhe bizneset maqedonase.



Të dhëna Financiare 2023


TË DHËNA FINANCIARE

Grupi SIGAL
Prime të shkruara për katër vitet e fundit (në euro)



Kompania	2021 (në Euro)	2022 (në Euro)	2023 (në Euro)	2024 (në Euro)
SIGAL UNIQA AL Jo-Jetë dhe Risigurime	37,453,000	45,641,000	52,879,000	58,348,000
SIGAL Life UNIQA AL	6,163,000	6,754,000	7,952,000	8,362,000
SH.A.F.P SIGAL Life UNIQA	4,661,000	4,613,000	3,959,000	4,684,000
SIGAL UNIQA KS Jo-Jetë	14,070,000	16,493,000	19,047,000	22,101,000
SIGAL Life UNIQA KS	1,436,000	2,020,000	2,336,000	3,187,000
UNIQA MKV Jo-Jetë	16,642,000	18,565,000	21,230,000	24,388,000
UNIQA Life MKV	4,023,000	4,641,000	4,994,000	5,158,000
GRUPI	84,446,000	98,728,000	112,398,000	126,228,000

Prime të shkruara sipas produkteve për vitin 2024



Lloji i Produktit	AL (në Euro)	KS (në Euro)	MKV (në Euro)	Grupi (në Euro)
Pasuri	20,719,572	4,639,321	5,350,243	24,203,883
Motorike	37,146,174	12,566,262	15,359,712	63,768,003
Jetë, Shëndet dhe Aksidente	17,455,150	7,733,331	8,458,939	31,695,294
Marina & Aviacioni	1,686,398	348,603	377,247	1,769,391
Risigurime*	107,332	0	0	107,332
Pensione Vullnetare*	4,684,196	0	0	4,684,196
TOTALI	71,394,441	25,287,516	29,546,142	126,228,099

* Produktet e Pensioneve vullnetare dhe Risigurimet ofrohen vetëm në Shqipëri përkatësisht nga kompanitë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Risigurime dhe SH.A.F.P SIGAL Life UNIQA.

RAPORTI I
AUDITUESVE
TE PAVARUR

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a.

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara sipas
Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
per vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

PËRMBAJTJA

Raporti i audituesit të pavarur i

Pasqyrat financiare të konsoliduara

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar.....	1
Pasqyra e konsoliduar e fitimit dhe humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra e konsoliduar e flukseve monetare	4

1. Informacion i përgjithshëm	5
2. Bazat e përgatitjes	6
3. Politika domethënëse kontabël	7
4. Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme në zbatimin e politikave kontabël	15
5. Shpallje të reja të kontabilitetit	16
6. Administrimi i rrezikut të veprimtarisë së sigurimit	17
7. Administrimi i rrezikut financiar	22
8. Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	26
9. Depozita me afat me bankat	27
10. Investime të mbajtura me kosto të amortizuar	28
11. Investime të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	28
12. Shpenzime të shitjes së kontratave	28
13. Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit	28
14. Aktive të risigurimit	31
15. Shpenzime të shtyra të marrjes në sigurim	31
16. Aktive afatgjata materiale dhe jomateriale dhe aktive me të drejtë përdorimi	32
17. Aktive të tjera	33
18. Detyrime të kontratave të sigurimit për dëme	34
19. Detyrime të kontratave të sigurimit për primin e pafitur	34
20. Detyrime të tjera nga veprimtaria e sigurimit dhe risigurimit	34
21. Detyrime të qirasë	34
22. Detyrime të tjera	35
23. Kapitali aksionar	35
24. Rezerva për veprimtarinë e sigurimit	35
25. Prime të shkruara bruto	36
26. Prime të shkruara ceduar risigruerës	36
27. Të ardhura të tjera	36
28. Shpenzimet e marrjes në sigurim	36
29. Shpenzime administrative dhe marketingu	37
30. Shpenzime të tjera të veprimtarisë së sigurimit	37
31. Tatimi mbi fitimin	37
32. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara	37
33. Transaksionet me palët e lidhura	38
34. Menaxhimi i rrezikut të kapitalit	39
35. Shpalosje e vlerës së drejtë	40
36. Ngjarje pas datës së raportimit	41



Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar aksionerëve të Sigal Uniqa Group Austria SH.A.:

Opinionin ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara të Sigal Uniqa Group Austria SH.A. ("Shoqëria") dhe të filialeve të saj (së bashku "Grupi"), janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Ligjin 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".

Ne kemi audituar

Pasqyrat financiare të konsoliduara të grupit përfshijnë:

- pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2024;
- pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më atë datë;
- pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më atë datë;
- pasqyrën e konsoliduar të flukseve monetare për vitin e mbyllur më atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara, të cilat përfshijnë informacione domethënëse për politikën kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Baza për opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA).

Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave të konsoliduara financiare të raportit tonë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të bazuar opinionin tonë.

Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga grupi në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit (që përfshin edhe Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK") dhe kërkesat e Kodit të Etikës për Audituesit Ligjorë që janë të zbatueshme për auditimin tonë të pasqyrave financiare të konsoliduara në Shqipëri. Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së dhe kërkesat e Kodit të Etikës për Audituesit Ligjorë.

Informacione të tjera

Drejtuesit janë përgjegjës për përgatitjen e informacioneve të tjera. Informacionet e tjera të cilat pritet të na vendosen në dispozicion pas datës së raportit tonë përfshijnë Raportin Vjetor, por nuk përfshijnë pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportin tonë të auditimit.

Opinionin ynë për pasqyrat financiare të konsoliduara nuk përfshin informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim asnjë formë sigurie në lidhje me to.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare të konsoliduara, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më sipër kur të na vendosen në dispozicion dhe, gjatë këtij procesi, të vlerësojmë nëse informacionet e tjera nuk pajtohen në mënyrë të rëndësishme me pasqyrat financiare të konsoliduara apo me kuptueshmërinë që ne kemi mbledhur gjatë auditimit, ose nëse informacionet e tjera përmbajnë anomali të rëndësishme.

Kur ne të lexojmë Raportin Vjetor, nëse ne arrijmë në përfundimin se në të gjenden anomali të rëndësishme, ne jemi të detyruar t'ia komunikojmë këtë çështje drejtuesve dhe personave të ngarkuar me qeverisjen.

PricewaterhouseCoopers Assurance Services SH.P.K.
Rruga Ibrahim Rugova, Sky Tower 9/1, Tiranë, Shqipëri
T: +355 (4) 2242 254, F: +355 (4) 2242 639, www.pwc.com/al

Regjistruar me Qendrën Kombëtare të Biznesit me Numër Unik të Identifikimit të Subjektit NUIS/NIPT: L92014010J
Regjistruar në Regjistrin Publik të Audituesve Ligjorë me Vendim nr. 701, 03.07.2020 të Komitetit të Regjistrimit

Përgjegjësitë e drejtuesve dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare të konsoliduara

Drejtuesit janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me Ligjin 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", dhe për kontrollet e brendshme, të cilat ata i gjykojnë të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara pa anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, drejtuesit janë përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Grupit për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vendosur në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur drejtuesit synojnë që Grupi të likuidohet apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç këtyre.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Grupit.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi, nuk përmbajnë anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por ajo nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një anomali materiale. Anomali mund të vijë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të kenë ndikim në vendimet ekonomike të marra nga përdoruesit në bazë të këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalisë materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një anomali materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një anomali si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose shmangie të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë kuptueshmëri të kontrolleve të brendshme që mund të jenë të nevojshme për hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efikasitetin e kontrolleve të brendshme të Grupit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe të shënimeve shpjeguese të përgatitura nga drejtuesit.
- Arrijmë në një përfundim në lidhje me përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga drejtuesit dhe, bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e Grupit për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të përfshijmë një rezervë në opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së Grupit.

- Planifikojmë dhe kryejmë auditimin e grupit për të marrë evidencë të përshtatshme dhe të mjaftueshme në lidhje me informacionin financiar të njësive ekonomike apo aktiviteteve tregtare brenda grupit si bazë për të mbështetur shprehjen e një opinionit për pasqyrat financiare të konsoliduara. Ne jemi përgjegjës për të udhëhequr, mbikëqyrur, dhe për të rishikuar punën e kryer të auditimit për qëllime të auditimit të grupit. Ne mbetemi përgjegjës të vetëm në lidhje me opinionin tonë të auditimit.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontrolleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

Auditues Ligjor

Jonid Lamllari



PricewaterhouseCoopers Assurance Services SH.P.K.

3 qershor 2025

Tiranë, Shqipëri



SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.
Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2024
(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Aktive			
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	8	357,683	391,466
Depozita me afat me bankat	9	11,226,029	10,351,874
Investime të mbajtura me kosto të amortizuar	10	3,415,996	3,429,514
Investime të mbajtura me vlerë të drejtë	11	641,349	474,529
Shpenzime të shitjes së kontratave	12	89,602	72,658
Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit	13	1,246,746	1,223,783
Aktive të risigurimit	14	2,265,167	1,600,911
Shpenzime të shtyra të marrjes në sigurim	15	964,357	926,275
Tatim fitimi i arkëtueshëm		24,649	68,412
Aktive afatgjata materiale dhe jo-materiale dhe aktive me të drejtë përdorimi	16	1,346,451	1,438,218
Aktive të tjera	17	558,981	577,492
Totali i aktiveve		22,137,010	20,555,132
Detyrimet			
Detyrime të kontratave të sigurimit për dëme	18	9,198,389	8,235,272
Detyrime të kontratave të sigurimit për primin e pafituar	19	5,984,265	5,498,283
Detyrime nga veprimtaria e sigurimit dhe e risigurimit	20	668,356	708,184
Tatim fitimi për t'u paguar		10,263	26,292
Detyrime të qirasë	21	138,121	191,372
Detyrime të tjera	22	438,121	449,379
Totali i detyrimeve		16,437,515	15,108,782
Kapitali			
Kapitali aksionar	23	2,232,909	2,232,909
Rezerva të tjera të kapitalit		52,133	52,133
Rezerva për veprimtarinë e sigurimit	24	771,756	710,153
Rezerva përkthimi		(851,602)	(652,919)
Fitimi i mbartur		3,430,762	3,046,905
Totali i kapitalit që i përket aksionerëve të Shoqërisë mëmë		5,635,958	5,389,181
Interesi jo kontrollues		63,537	57,169
Totali i kapitalit		5,699,495	5,446,350
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		22,137,010	20,555,132

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë miratuar nga drejtuesit e Grupit më 26 maj 2025 dhe janë nënshkruar në emër të tyre nga:

[Signature]
Ayni Ponari
Drejtore e përgjithshme



[Signature]
Klement Mersini
Drejtore e departamentit të financës

Shënimet në faqet 5 deri në 41 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.
Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse
(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	2024	2023
Prime të shkruara bruto	25	12,065,367	11,497,618
Prime të shkruara ceduar risiguresit	26	(1,490,090)	(1,496,491)
Prime të shkruara neto		10,575,277	10,001,127
Ndryshimi në rezervën e primeve të pafituara		(546,310)	(451,660)
Ndryshimi në rezervën e risiguresit për primet pafituara		100,962	40,070
Të ardhura neto nga veprimtaria e sigurimit		10,129,929	9,589,537
Të ardhura nga interesi		385,793	278,916
Të ardhura të tjera	27	354,505	560,971
Të ardhura neto		10,870,227	10,429,424
Ndryshimi në detyrimet e kontratave të sigurimit për dëme		(1,217,990)	(639,058)
Ndryshimi në pjesën e risiguresit në detyrimet e kontratave të sigurimit për dëme		478,504	(393,202)
Dëme të paguara		(4,172,471)	(3,672,773)
Dëme të paguara nga risiguresit		367,721	599,499
Shpenzime për dëme neto		4,544,236	(4,105,534)
Shpenzime të marrjes në sigurim	28	(2,289,790)	(2,219,765)
Shpenzime administrative dhe marketingu	29	(2,393,163)	(2,179,782)
Shpenzime të tjera të veprimtarisë së sigurimit	30	(497,852)	(442,238)
Fitim/(humbje) nga kursi i këmbimit		(256,900)	(560,877)
Fitimi para tatimit		888,286	921,228
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	31	(148,061)	(152,753)
Fitimi i vitit		740,225	768,475
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse			
Zërat që janë ose mund të riklasifikohen më pas në fitim ose humbje			-
Tatim i shtyrë			-
Përkthimi i një njësie të huaj në monedhën raportuese		(198,683)	(210,021)
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		541,542	558,454
Fitimi që i përket:			
Aksionerëve e Shoqërisë mëmë		733,857	761,198
Interesi jo kontrollues		6,368	7,277
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse që i përket:			
Aksionerët të Shoqërisë mëmë		535,174	551,177
Interesi jo kontrollues		6,368	7,277

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.
Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital
(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

	Kapitali aksionar	Rezerva të tjera të kapitalit	Rezerva për veprimtarinë e sigurimit	Rezerva e përkthimit	Fitim i mbartur	Kapitali që i përket aksionerëve të Shoqërisë mëmë	Interesi jo kontrollues	Totali
Gjendja më 1 janar 2023	2,232,909	52,133	710,153	(442,898)	2,585,707	5,138,004	49,892	5,187,896
Fitimi i vitit	-	-	-	-	761,198	761,198	7,277	768,475
Përkthimi i një njësie të huaj në monedhën raportuese	-	-	-	(210,021)	-	(210,021)	-	(210,021)
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse të vitit	-	-	-	(210,021)	761,198	551,177	7,277	558,454
Përvetësimi i fitimit të mbartur	-	-	-	-	-	-	-	-
Dividendë të paguar	-	-	-	-	(300,000)	(300,000)	-	(300,000)
Totali i kontributeve dhe shpërndarja tek aksionerët	-	-	-	-	(300,000)	(300,000)	7,277	(300,000)
Gjendja më 31 dhjetor 2023	2,232,909	52,133	710,153	(652,919)	3,046,905	5,389,181	57,169	5,446,350
Fitimi i vitit	-	-	-	-	733,857	733,857	6,368	740,225
Përkthimi i një njësie të huaj në monedhën raportuese	-	-	-	(198,683)	-	(198,683)	-	(198,683)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	61,603	-	-	61,603	-	61,603
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit	2,232,909	52,133	771,756	(851,602)	3,780,762	5,985,958	6,368	6,049,495
Përvetësimi i fitimit të pashpërndarë	-	-	-	-	-	-	-	-
Dividendë të paguar	-	-	-	-	(350,000)	(350,000)	-	(350,000)
Totali i kontributeve dhe shpërndarja tek aksionerët	-	-	-	-	(350,000)	(350,000)	-	(350,000)
Gjendja më 31 dhjetor 2024	2,232,909	52,133	771,756	(851,602)	3,430,762	5,635,958	63,537	5,699,495

Shënimet në faqet 5 deri në 41 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.
Pasqyra e konsoliduar e flukseve monetare

(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	2024	2023
Flukset monetare nga veprimtaritë shfrytëzuese			
Fitimi para tatimit		888,286	921,228
<i>Rregullimet</i>			
Amortizimi	16	212,907	234,090
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata materiale	13	205,916	114,837
Fitimi i parealizuar i investimeve ne letra me vlerë të drejtë të mbajtura në fitim ose humbje gjatë vitit		3,319	(2,565)
Të ardhura nga interesi		(385,794)	(278,916)
Shpenzime interesi		11,289	9,039
Flukset monetare nga veprimtaritë shfrytëzuese përpara ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet e veprimtarisë shfrytëzuese		935,924	997,713
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e veprimtarisë shfrytëzuese:</i>			
Llogaritë e arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit		(228,879)	(18,480)
Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim		(38,082)	(20,774)
Aktive të risigurimit		(664,256)	484,786
Aktive të tjera		1,566	(87,329)
Detyrime ndaj risiguresve		(39,828)	(23,955)
Detyrime të kontratave të sigurimit për dëme		1,449,099	352,997
Detyrime të tjera		(11,259)	(79,988)
Tatim fitimi i paguar		(120,327)	(240,556)
Interesi i paguar		(11,289)	-
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e veprimtarisë shfrytëzuese		1,272,670	1,364,414
Flukse monetare të përdorura në veprimtaritë investuese			
Flukse dalëse nga blerja e aktiveve afatgjata materiale	16	(155,529)	(254,286)
Flukse hyrëse nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		8,383	13,195
Investime në depozita me afat me bankat		(861,097)	108,467
Maturime të investimeve të mbajtura me kosto të amortizuar		288,267	246,268
Flukset dalëse nga investimet në letra me vlerë të mbajtura me kosto të amortizuar		(438,795)	(1,372,625)
Interesa të marra		369,963	273,676
Flukse monetare të përdorura në veprimtaritë investuese neto		(788,809)	(985,305)
Flukse monetare të përdorura në veprimtaritë financiare			
Dividendë të paguar	23	(350,000)	(300,000)
Pagesa të qirasë		(98,244)	(49,077)
Flukse monetare të përdorura në veprimtaritë financiare neto		(448,244)	(349,077)
Rritje në mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre neto		35,617	30,033
Efekti i ndryshimeve të kursit të këmbimit në mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre		(69,400)	34,127
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të vitit		391,465	327,306
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të vitit	8	357,683	391,466

Shënimet në faqet 5 deri në 41 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.
Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare të konsoliduara – 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Sigal Uniqa Group Austria SH.A, (“Shoqëria”) dhe filialeve të saj (së bashku, “Grupi”), janë përgatitur në përputhje me dispozitat e raportimit financiar të ligjit 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”. Politikat kontabël të përdorura në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara janë paraqitur në Shënimin 3. Pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 përfshijnë Shoqërinë dhe filialet e saj (së bashku të referuara si ‘Grupi’ dhe individualisht si ‘entitete në grup’).

Shoqëria është e themeluar dhe e vendosur në Shqipëri që nga viti 1999 si shoqëri aksionare sigurimi në përputhje me ligjin nr. 8081, datë 7 mars 1996, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar me vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë, nr. 20863, datë 22 shkurt 1999. Shoqëria aktualisht është subjekt i ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” datë 4 korrik 2004 (“Ligji Shqiptar i Sigurimeve”). Më 31 dhjetor 2024, Shoqëria mëmë ndërmjetëse është UNIQA Österreich Versicherungen AG, Vjenë, Austri e cila nga ana tjetër është në pronësi të Uniqa Insurance Group AG. Pala e fundit kontrolluese e Grupit është UNIQA Versicherungsverein Privatstiftung, Vjenë, Austri.

Shoqëria ka nënshkruar një marrëveshje për blerjen e aksioneve më 21 nëntor 2024 me Sigal Business Center SH.P.K, e cila është në pronësi të plotë të Z. Ponari, për transferimin e aksioneve të saj. Marrëveshja është e kushtëzuar nga miratimi i autoriteteve rregullatore të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë, si dhe nga disa kushte të tjera, dhe mbetet e vlefshme deri në nëntor 2025. Transferimi i pronësisë do të ndodhë sapo të përfundojë miratimi i marrëveshjes nga tre autoritetet dhe të kryhet pagesa. Në datën e këtyre pasqyrave financiare, pronësia ende nuk ishte transferuar pasi miratimet nga autoritetet rregullatore përkatëse nuk ishin marrë.

Veprimtaria kryesore: Aktivitetet kryesore të biznesit të saj përfshijnë ofrimin e shërbimeve të sigurimit për automjetet motorike, pronën, shëndetin, marinën dhe aviacionin, jetën dhe lloje të tjera të sigurimit. Grupi operon gjithashtu si një entitet menaxhues i fondeve të pensionit.

Vendndodhja e biznesit: Adresa e Shoqërisë është Blv. “Zogu I”, nr. 1, Tiranë, Shqipëri.

Filialet kryesore operative dhe aktivitetet e tyre janë si më poshtë:

Veprimtaria në Shqipëri

Sigal Life Uniqa Group Austria SH.A. (99.9% e pronësisë së Sigal Uniqa Group Austria SH.A.)- Në vitin 2004, Grupi hyri në biznesin e sigurimit të jetës në Shqipëri duke krijuar Sigal Life SH.A, kapitali aksionar i së cilës aktualisht është 99.9% në pronësi të Shoqërisë.

Shoqëria Administruese e Fondeve. Sigal Life Uniqa Group Austria Shoqëri e Administrimit të Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SH.A. (51% pronësi e Sigal Life Uniqa Group Austria SH.A.)- është blerë më 31 mars 2011 nga AVEL Sh.p.k. Përqindja e interesave të pronësisë të zotëruara nga interesat jo kontrolluese është 49% dhe përqindja e të drejtave të votës që zotërohen nga interesat jo kontrolluese është e njëjtë me përqindjen e interesave të mbajtur të pronësisë.

Veprimtaria në Kosovë

Sigal Uniqa Group Austria SH.A. – Prishtinë (100% pronësi e Sigal Uniqa Group Austria SH.A.)

është themeluar në vitin 2003, si degë e Sigal Uniqa Group Austria SH.A. në territorin e Kosovës të administruar nga OKB. Licenca është lëshuar më 23 tetor 2003 nga Banka dhe Autoriteti i Pagesave të Kosovës (tani Banka Qendrore e Kosovës) dhe entiteti është regjistruar si degë e Uniqa Group Austria SH.A. Në vitin 2012, dega ndryshoi statusin e saj ligjor në filial.

Sigal Life Uniqa Group Austria SH.A. – Prishtinë (100% pronësi Sigal Uniqa Group Austria SH.A.)

është themeluar më 10 maj 2011 me qëllim të ushtrimit të biznesit të sigurimit të jetës në Kosovë.

Veprimtaria në Maqedoninë e Veriut

Uniqa A.D. Shkup (99.94% e pronësisë së Sigal Uniqa Group Austria sh.a.)- është themeluar më 15 prill 2004 si Sigal SHA - Shkup. Është e licencuar për të ofruar 13 klasa sigurimesh të jo-jetës. Linjat kryesore të veprimtarisë janë sigurimet e lidhura me mjetet motorike (MTPL, policat kufitare, kartoni jeshile), pasuri dhe aksidentet. Gjatë vitit 2007 emri zyrtar është ndryshuar në “UNIQA AD Skopje”.

Uniqa Life AD Skopje (100% pronësi e Sigal Uniqa Group Austria SH.A.)- u themelua më 29 qershor 2011 për të ushtruar aktivitetin e sigurimit të jetës në Maqedoni.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.
Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare të konsoliduara – 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm (vazhdim)

Përfaqësuesi i Shoqërisë është Z. Avni Ponari, Drejtor i Përgjithshëm. Këshilli Mbikëqyrës gjatë vitit 2023 dhe deri në datën e miratimit të këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara është i përbërë nga:

Andreas Brandstetter	Kryetar
Wolfgang Kindl	Anëtar
Mag. Gerald Muller	Anëtar
Gerogios Bartzis	Anëtar
Vinzenz Benedict	Anëtar

2. Bazat e përgatitjes
Deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë përgatitur në përputhje me dispozitat e raportimit financiar të ligjit 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” sipas konventës së kostos historike. Politikat kontabël të Grupit përfshihen në Shënimin 3. Pasqyrat financiare të konsoliduara të Shoqërisë mëmë përfundimtare, Uniqa Insurance Group AG, janë të disponueshme për përdorim publik që përputhen me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të miratuara nga BE-ja.

Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare të konsoliduara paraqiten në Lek Shqiptar (“ALL”), që është monedha funksionale e Shoqërisë. Të gjitha shumat janë rrumbullakosur në mijëshen më të afërt, përveç nëse tregohet ndryshe.

Përkthimi i valutës së huaj
Transaksionet dhe gjëndjet

Aktivitet dhe detyrimet monetare përkthehen në monedhën funksionale të secilës njësi ekonomike sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë (“BSH”) në fund të periudhës raportuese përkatëse. Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga shlyerja e transaksioneve dhe nga përkthimi i aseteve dhe detyrimeve monetare në monedhën funksionale të secilës njësi ekonomike sipas kursit zyrtar të BSH-së në fund të vitit, njihen në fitim ose humbje. Të gjitha fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit paraqiten në pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, në zërin ‘Fitim/(humbje) nga kursi i këmbimit’. Përkthimi sipas kursit të fundvitit nuk aplikohet për zërat jo-monetarë që maten me kosto historike. zërat jo-monetarë që maten me vlerë të drejtë në një monedhë të huaj, përfshirë investimet në kapital, përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Efektet e ndryshimeve të kursit të këmbimit mbi zërat jo-monetarë të matur me vlerë të drejtë në një monedhë të huaj regjistrohen si fitim ose humbje nga vlera e drejtë.

Shoqëritë e Grupit

Rezultatet dhe pozicioni financiar i çdo njësie ekonomike të Grupit (monedha funksionale e asnjërës prej të cilave nuk është monedhë e një ekonomie hiperinflacioniste) përkthehen në monedhën e prezantimit si më poshtë:

- (i) aktivet dhe detyrimet për çdo pasqyrë të pozicionit financiar përkthehen me kursin e fundvitit në fund të periudhës përkatëse raportuese;
- (ii) të ardhurat dhe shpenzimet përkthehen me kursin mesatar të këmbimit;
- (iii) komponentët e kapitalit neto janë përkthyer me kursin historik; dhe
- (iv) të gjitha diferencat e kurseve të këmbimit njihen në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Kur humbet kontrolli mbi një filial me një monedhë funksionale të ndryshme nga ajo funksionale ose e prezantimit të Grupit, diferencat e kurseve të këmbimit të njohura më parë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse riklasifikohen në fitim ose humbje për vitin si pjesë e fitimit ose humbjes nga nxjerrja jashtë përdorimit. Në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të pjesshëm të një filiali pa humbje të kontrollit, pjesa përkatëse e diferencave të akumuluar të konvertimit të monedhave riklasifikohen në interesin jo kontrollues brenda kapitalit.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.
Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare të konsoliduara – 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)
Bazat e konsolidimit
i) Kombinimet e biznesit

Për kombinimet e biznesit llogaritjen bëhen duke përdorur metodën e blerjes kur kontrolli i transferohet Grupit (shih (d) (ii)). Shuma e transferuar në blerje matet përgjithësisht me vlerën e drejtë, siç janë aktivet neto të identifikueshme. Çdo emër i mirë që krijohet testohet çdo vit për zhvlerësim. Çdo fitim nga një blerje njihet në fitim ose humbje të menjëherëshme. Kostot e transaksionit njihen si shpenzime kur ndodhin, përveç nëse lidhen me emetimin e letrave me vlerë të borxhit ose kapitalit. Shuma e transferuar nuk përfshin shumat që lidhen me zgjidhjen e marrëdhënieve para-ekzistuese. Shuma të tilla përgjithësisht njihen në fitim ose humbje.

ii) Filialet

Filialet janë subjekte të kontrolluara nga Grupi. Grupi kontrollon një njësi ekonomike kur ajo është e ekspozuar ose ka të drejta ndaj kthimeve të ndryshueshme nga përfshirja e saj me njësinë ekonomike dhe ka aftësinë të ndikojë në këto kthime nëpërmjet fuqisë së saj mbi njësinë ekonomike. Pasqyrat financiare të filialeve janë të përfshira në pasqyrat e konsoliduara nga data kur fillon kontrolli, deri në datën kur ai përfundon.

iii) Interesi jo kontrollues

IJK matet fillimisht me pjesën e tyre proporcionale të aktiveve neto të identifikueshme të blera në datën e blerjes. Ndryshimet në interesin e Grupit në një filial që nuk rezultojnë me humbje të kontrollit kontabilizohen si transaksione të kapitalit neto.

iv) Humbja e kontrollit

Kur Grupi humbet kontrollin mbi një filial, ai çregjistron aktivet dhe detyrimet e filialit, dhe çdo IJK të lidhur dhe përbërës të tjerë të kapitalit neto. Çdo fitim ose humbje që rezulton njihet në fitim ose humbje. Çdo interes i mbajtur në ish-filialin matet me vlerën e drejtë kur humbet kontrolli.

v) Transaksionet e eliminuara në konsolidim

Tepricat dhe transaksionet brenda grupit, si dhe çdo e ardhur dhe shpenzim i përcaktuar që rrjedh nga transaksionet brenda grupit, eliminohen. Fitimet e përcaktuara që rrjedhin nga transaksionet me të investuarit e kontabilizuar në kapital eliminohen kundrejt investimit në masën e interesit të Grupit në të investuarin. Humbjet e përcaktuara eliminohen në të njëjtën mënyrë si fitimet e përcaktuara, por deri në masën kur nuk ka evidencë për rënie të vlerës.

3. Politika domethënëse kontabël

Politikat kontabël të përcaktuara më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare të konsoliduara dhe janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme nga Grupi, përveç rasteve kur deklarohet ndryshe.

(a) Klasifimi i kontratave të sigurimit

Produktet e Grupit klasifikohen në fillim, për qëllime kontabël, si kontrata sigurimi. Një kontratë, e cila klasifikohet si kontratë sigurimi, mbetet si kontratë sigurimi derisa të gjitha të drejtat dhe detyrimet të shuhet ose të skadojnë. Kontratat sipas të cilave Grupi pranon një rrezik të rëndësishëm sigurimi nga një palë tjetër (policëmbajtësi) duke rënë dakord të kompensojë policëmbajtësin ose përfituesin tjetër nëse një ngjarje e caktuar e pasigurt e ardhshme (ngjarja e siguruar) ndikon negativisht tek policëmbajtësi ose përfituesi tjetër, klasifikohen si kontrata sigurimi.

Rreziku i sigurimit është një rrezik i ndryshëm nga rreziku financiar. Rreziku financiar është rreziku i një ndryshimi të mundshëm në të ardhmen në një ose më shumë nga një normë interesi të caktuar, çmimi i instrumetave financiarë, çmimi i mallit, kursi i këmbimit valutor, indeksi i çmimeve ose normat, një vlerësim kredie ose indeksi i kredisë ose ndryshorë të tjerë, të parashikuar në rastin të një ndryshori jofinanciar që ai nuk është specifik për një palë në kontratë. Kontratat e sigurimit mund të transferojnë gjithashtu një rrezik financiar.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.
Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare të konsoliduara – 31 dhjetor 2024
(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)
3. Politikat domethënëse kontabël (vazhdim)
(b) Njohja dhe matja e kontratave të sigurimit
i) Kontratat e sigurimit të përgjithshëm

Detyrimet nga veprimtaria e sigurimit janë llogaritur në mënyrë të veçantë për të gjitha produktet e sigurimit dhe janë të përbëra nga primet e pafituara, rreziku i detyrimeve të ardhshme (të pambaruara) dhe humbjet lidhur me detyrimet e ardhshme (të papaguara në datën e mbylljes të vitit financiar). Detyrimet e veprimtarisë së sigurimit (provizionet) paraqesin vlerësime të pagesave të ardhshme për dëmet e raportuara dhe të paraportuara. Grupi nuk i aktualizon detyrimet e sigurimit. Çdo ndryshim në vlerësim është reflektuar në rezultatet e operacioneve në periudhën në të cilën vlerësimet janë ndryshuar. Vlerësimi i detyrimeve të sigurimit është një proces kompleks që lidhet dhe kërkon përdorimin e vlerësimeve dhe gjykimeve të posaçme. Filialet e Shoqërisë kanë përdorur kërkesat e rregullatorëve ose strukturave mbikëqyrëse të sigurimit sipas territorit për të përcaktuar detyrimet e veprimtarisë së sigurimit.

ii) Primet nga aktiviteti i përgjithshëm i sigurimit

Primet e shkruara bruto përbëjnë shumën e detyruar gjatë vitit financiar në përputhje me sigurimin e drejtpërdrejtë pavarësisht faktit se këto shuma i përkasin plotësisht ose pjesërisht një periudhë kontabël të mëpasshme. Primet paraqiten pa përfshirë detyrimet e komisioneve ndaj agjentëve/ndërmjetësve dhe përjashtojnë taksën dhe tarifën mbi primet. Primet konsiderohen të fituar që nga data kur i bashkëlidhet rrezikut, për periudhën e dëmshpërblimit, në bazë të rrezikut të nënshkruar. Llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi për të cilat shuma e detyruar vlerësohet të jetë e paarkëtueshme fshihen.

iii) Rezerva e primit të pafituar ("UPR")
Sigurimi i Jo Jetës

Rezerva e primit të pafituar në të gjitha linjat e biznesit përfshin atë pjesë të primeve të shkruara e cila vlerësohet se do të fitohet në vitin pasardhës, duke përdorur metodën proporcionale 1/365, e rregulluar në mënyrë që të reflektojë çdo ndryshim të ndodhjes së rrezikut gjatë periudhës së mbuluar nga kontrata. Rezerva e primit të pafituar është ajo pjesë e primit e cila lidhet me periudha pas datës së raportimit. Primi i pafituar llogaritet nga primet e shkruara të cilat paraqiten bruto nga detyrimet e komisioneve ndaj agjentëve/ndërmjetësve dhe gjithashtu përjashtojnë taksën dhe tarifën mbi primet. Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim shtyhen veçmas si aktiv.

Sigurimi i Jetës

Rezerva për "Jetën e Debitorit" dhe sigurimin e "Jetës së Kombinuar" është përlogaritur nëpërmjet metodave aktuariale duke marrë në konsideratë vlerën e pa-maturuar të policës së sigurimit të rregulluar me koeficientin e rrezikut të vdekshmërisë, për rrezikun e humbjes së jetës si dhe ndërkohë UPR-ja për rrezikun e humbjes së jetës nga aksidentet dhe të shëndetit. Grupi ka përdorur metodën pro-rata (metodën 1/365) për të përcaktuar primin e pafituar. Primi i pafituar për sigurimin e mbrojtjes së pagesave ("PPI") është llogaritur bruto para shpenzimeve të marrjes në sigurim. Efekti i koston së marrjes në sigurim është vlerësuar bazuar në normën e koston së marrjes në sigurim kundrejt primit të shkruar bruto.

iv) Shpenzimet e marrjes në sigurim
Sigurimi i Jo Jetës

Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim përfaqësojnë shpenzimet e ndodhura të marrjes në sigurim dhe të ardhurave të marra, të cilat korrespondojnë me rezervën e primit të pafituar. Ato janë përcaktuar si pjesë e shpenzimeve të marrjes në sigurim si përqindje në planin teknik të sigurimeve dhe që lidhen me periudhat ndërmjet fundit të periudhës raportuese dhe datës së përfundimit të afatit të kontratës së sigurimit.

Shpenzimet e marrjes në sigurim përcaktohen si kosto që rrjedhin nga marrja në sigurim e kontratave të reja të sigurimit, duke përfshirë kostot e drejtpërdrejta, siç janë komisionet e marrjes në sigurim.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.
Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare të konsoliduara – 31 dhjetor 2024
(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)
3. Politikat domethënëse kontabël (vazhdim)
Sigurimi i Jetës

Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim llogariten në bazë të policave të sigurimit të jetës me kursim, afateve të rregullta dhe afateve të veçanta. Për policat "Jeta me Afat", kostot e shtyra të marrjes në sigurim llogaritet në bazë të komisionit të përcaktuar në baza individuale të policave. Komisioni i paguar për çdo policë është i ndarë nga shuma e shkruar e asaj police. Raporti që rezulton është shumëfishuar me rezervat e primit të pafituar të primeve bruto të shkruara. Rrjedhimisht, kostot e marrjes shtyhen përgjatë kohëzgjatjes së policave përkatëse. Për policat e sigurimit me kursim, kostot e shtyra të marrjes në sigurim janë llogaritur në përputhje me Grupi ka zbatuar qasjen e thjeshtuar të specifikuar në standardet e grupit Uniqa. Kështu që për llogaritje është përdorur skedari i thjeshtuar i standardeve i ofruar nga Grupi, së bashku me komisionet, zbritjen, vonesën dhe normat e vdekshmërisë.

Shpenzimet e marrjes në sigurim përkufizohen si kosto që rrjedhin nga blerja e kontratave të reja të sigurimit, duke përfshirë kostot direkte, siç janë komisionet e blerjes dhe koston e hartimit të dokumentit të sigurimit.

iv) Risigurimi

Grupi cedon primet e siguruara dhe rrezikun duke zvogëluar kështu potencialin e humbjes neto nëpërmjet diversifikimit të rrezikut që krijohet nga linja e biznesit MTPL dhe aksidenteve përfshirë këtu dhe kartonin jeshil, sigurimin e pasurisë, marinës dhe aviacionit, detyrime civile dhe të tjera dhe linja të tjera biznesi.

Risigurime të tilla përfshijnë marrëveshje të tejkallimit të humbjeve dhe marrëveshjet fakultative. Vetëm kontratat që përfshijnë transferimin e një pjesë të konsiderueshme të rrezikut të sigurimit dhe kohës regjistronen si aktive risigurimi. Marrëveshjet e risigurimit nuk e çlirojnë Shoqërinë nga detyrimet e drejtpërdrejta ndaj policëmbajtësit. Detyrimet e risigurimit përfshijnë llogari të pagueshme për kontrata të jashtme risigurimi dhe njihen si shpenzime kur afati i tyre mbaron.

Primet e risiguruara ose primet e ceduara tek risiguresit njihen si shpenzime në mënyrë që të jenë konsistente me njohjen e primeve të lidhura me kontratat e sigurimit. Për aktivitetin e përgjithshëm të sigurimit, primet e risigurimit njihen si shpenzime në periudhën në të cilën mbulimi i risigurimit jepet në bazë të modeleve të rrezikut të risiguruar. Pjesa e pashpenzuar e primit të risigurimit të ceduar përfshihet në llogaritë e arkëtueshme nga risigurimi. Shuma e njohur si aktive të risigurimit matet në mënyrë konsistente me matjet e provizionit të mbajtur për kontratat lidhura të sigurimit. Shumat e njohura si aktive risigurimi maten mbi një bazë që është në përputhje me matjen e provizionit të mbajtur në lidhje me kontratat përkatëse të sigurimit.

Aktivitet nga risigurimi përfshijnë komisionet e risigurimit në lidhje me primet e ceduara tek risiguresit dhe arkëtimet nga shoqëria risiguresë në përputhje me dëmin e paguar. Këto janë klasifikuar si aktive nga risigurimi dhe paraqiten të veçanta, nëse ka. Aktivitet nga risigurimi vlerësohen për zhvlerësim në datën e raportimit. Një aktiv konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka tregues si rezultat i një ngjarje të ndodhur pas njohjes fillestare, që Grupi mund të mos arkëtojë të gjitha shumat dhe ngjarja ka një ndikim të matshëm në shumat që Grupi do të marrë. Grupi nuk ka pasur fitime ose humbje nga aktivet e risigurimit në datën e raportimit.

(d) Instrumentat financiarë

Instrumentet financiare të Grupit maten me koston e amortizuar ose me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Grupi klasifikon detyrimet financiare jo-derivative në detyrime të tjera financiare

Njohja. Instrumentet financiare të Grupit (aktivet dhe detyrimet) regjistrohen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare evidentohet nga çmimi i transaksionit. Një fitim ose humbje nga njohja fillestare regjistrohet vetëm nëse ka një diferencë midis vlerës së drejtë dhe çmimit të transaksionit, i cili mund të evidentohet nga transaksione të tjera aktuale të tregut në të njëjtin instrument ose nga një teknikë vlerësimi, të dhënat e së cilës përfshijnë vetëm të dhëna nga tregjet e vëzhgueshme.

Klasifikimi. Aktivitet financiare të Grupit klasifikohen në depozita, llogari të arkëtueshme dhe letra me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVPTL). Llogaritë e arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit janë aktive të sigurimit. Letrat me vlerë të emetuara nga Qeveria Shqiptare nuk klasifikohen si të mbajtura deri në maturim pasi nuk ka treg aktiv për këto letra dhe për rrjedhojë ato përmbushin përkufizimin e huave dhe llogarive të arkëtueshmeve. Detyrimet financiare klasifikohen si detyrime të tjera financiare (përfshirë detyrimet nga kontratat e sigurimit dhe detyrimet të tjera) dhe llogariten kur pala tjetër përmbush detyrimet e saj sipas kontratës dhe mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.
Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare të konsoliduara – 31 dhjetor 2024
(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

3. Politikat domethënëse financiare (vazhdim)

Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme të sigurimit are janë aktive financiare jo-derivative të pakuotuar me pagesa fikse ose të përcaktueshme të ndryshme nga ato që Grupi synon të shesë në periudhën e afërt. Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme përfshijnë depozitat me afat pranë bankave, llogaritë e tjera të arkëtueshme, bonot dhe obligacionet e thesarit të emetuara nga Qeveria Shqiptare mbahen me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke i zbritur provizionin për humbjet e shkaktuara nga zhvlerësimi.

Çregjistrimi. Grupi çregjistron aktivet financiare kur (a) aktivet janë shlyer ose të drejtat për flukset monetare nga aktivet skadojnë ose (b) Shoqëria ka transferuar të drejtat për flukset monetare nga aktivet financiare ose ka hyrë në një marrëveshje ndërkohë që (i) ose ajo transferon të drejtat për të marrë rrjedhë parash kontraktuale në një transaksion në të cilin kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit financiar janë transferuar ose (ii) as nuk transferon e as nuk ruan në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk mban kontrollin e aktivitetit financiar. Kontrolli ruhet nëse pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për t'ia shitur aktivin në tërësi një pale të tretë të palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë në shitje. Grupi çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, ndërprerë apo përfunduar.

Matja e koston shtë amortizuar. Kostoja e amortizuar është shuma në të cilën instrumenti financiar njihet në njohjen fillestare minus çdo ripagim të kryegjësë, plus interesin e përlogaritur, dhe për aktivet financiare minus çdo zhvlerësim për humbjet e shkaktuara nga zhvlerësimi. Interesi i përlogaritur përfshin amortizimin e kostove të transaksionit të shtyra në njohjen fillestare dhe të çdo primi ose aktualizimi deri në maturim duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat e përlogaritura nga interesi dhe shpenzimet e përlogaritura nga interesi, duke përfshirë kuponin e përlogaritur dhe zbritjen ose primin e amortizuar (përfshirë tarifën e shtyra në fillim, nëse ka), nuk paraqiten veçmas dhe përfshihen në vlerat kontabël të zërave të lidhur në pasqyrën e pozicionit financiar.

Kompensimi. Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen, dhe shuma neto e raportuar në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e zbatueshme ligjrisht për të kompensuar shumën e njohura, dhe ka një qëllim që ose të shlyhet në bazë neto, ose të realizohet aktivi dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm kur lejohen nga standardet e kontabilitetit ose për fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga një grup transaksionesh të ngjashme, për shembull në aktivitetin tregtar të Grupit.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura me kosto të amortizuar. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje kur ndodhin për shkak të një ose më shumë ngjarjeve ("ngjarjeve të humbjes") që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit financiar dhe që kanë një ndikim në shumën ose kohën e flukseve monetare të vlerësuar të ardhshme të aktivitetit financiar ose grupi i aktiveve financiare që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme. Nëse Grupi përcakton se nuk ekziston asnjë evidencë objektive që zhvlerësimi ka ndodhur për një aktiv financiar të vlerësuar individualisht, qoftë i rëndësishëm apo jo, ajo e përfshin aktivin në një grup aktivesh financiare me karakteristika të ngjashme të rrezikut kreditor dhe i vlerëson ato bashkarisht për zhvlerësim.

Faktorët kryesorë që Grupi merr në konsideratë në përcaktimin nëse një aktiv financiar është i zhvlerësuar janë statusi i tij i vonuar, detyrimet që mund të kompensohen për të njëjtin klient dhe realizueshmëria e kolateralit të lidhur, nëse ka. Kriteret e tjera kryesore të mëposhtme përdoren gjithashtu për të përcaktuar nëse ka evidencë objektive që ka ndodhur një humbje nga zhvlerësimi:

- çdo pjesë ose këst është i vonuar dhe pagesa e vonuar nuk mund t'i atribuohet një vonese të shkaktuar nga sistemet e shlyerjes.
- pala tjetër përjeton një vështirësi të konsiderueshme financiare siç dëshmohej nga informacioni i saj financiar që merr Grupi.
- pala tjetër konsideron falimentimin ose një riorganizim të aktivitetit.
- ka një ndryshim të pafavorshëm në statusin e pagesës së palës tjetër për shkak të ndryshimeve në kushtet ekonomike kombëtare ose lokale që ndikojnë në palën tjetër.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.
Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare të konsoliduara – 31 dhjetor 2024
(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

3. Politikat domethënëse financiare (vazhdim)

Investimet të mbajtura me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes

Investimet në fondet e investimeve i referohen produkteve në të cilat policëmbajtësi merr përsipër rrezikun e investimit, ku siguruesi nuk ka shumë të garantuar. Siguruesi blen njësi në fondet e investimit me primin e investimit të përcaktuar në propozim dhe sipas polices të lëshuar në bazë të kontratës së sigurimit të jetës. Aktivet financiare në FVTPL fillimisht njihen me vlerën e drejtë në datën e transaksionit, ose kosto, ndërsa kostot e transaksionit njihen drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave. Vlera e drejtë është shuma për të cilën një aktiv mund të këmbëhet, ose një detyrim të shlyhet, ndërmjet palëve të njohura dhe të gatshme në një transaksion.

Grupi mban aktive financiare, ekspozimi i vlerës së drejtë të të cilave kompensohet atë të detyrimeve sipas kontratave të sigurimit që maten duke përdorur teknika që përfshijnë informacionin aktual të tregut. Grupi raporton si detyrimet e sigurimit me vlerën aktuale, ashtu edhe aktivet financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, në mënyrë që të eliminojë mospërputhjen që përndryshe do të rezultonte nga matja e detyrimeve të sigurimit me kosto dhe aktivet financiare si të disponueshme për shitje ose me kosto të amortizuar.

Njësitë në fondet e investimeve të blera në favor të këtyre marrëveshjeve maten në çdo datë raportimi duke përdorur vlerën e aktiveve të fondit në nivel njësie. Vlerësimi i kuotave llogaritet dhe vihet në dispozicion të publikut nga depozitari i fondit të investimeve. Kjo është norma me të cilën një investitor mund të blejë ose shesë një njësi nga emetuesi. Grupi supozon se emetuesi, dmth, fondi i hapur i investimeve, si një njësi ekonomike që i nënshtrohet mbikëqyrjes së veçantë, përdor njësi të certifikuar për të përcaktuar vlerën e drejtë.

(e) Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë paratë në dorë, depozitat e mbajtura në bankë dhe investime të tjera afatshkurtra me likuiditet të lartë me maturitet origjinal prej tre muajsh ose më pak nga data e blerjes që janë subjekt i një rreziku të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë dhe përdoren nga Grupi në menaxhimin e angazhimeve të tij afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre mbahen me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(f) Depozita me afat

Depozitat me afat paraqiten në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar në shumën e kryegjësë së papaguar dhe klasifikohen me maturitet fillestar më shumë se tre muaj. Interesi përlogaritet duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe llogaritet në bazë proporcionale dhe është pjesë e bilancit të depozitave me afat në fund të vitit. Depozitat me afat mbahen me kosto të amortizuar.

(g) Llogaritë e arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit dhe llogari të tjera të arkëtueshme

Llogaritë e pagueshme nga veprimtaria e sigurimit dhe llogaritë e tjera të pagueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë duke zbritur kostot e transaksionit të drejtpërdrejtë që të cilit i përkasin.

(h) Llogaritë e pagueshme nga veprimtaria e sigurimit dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme nga siguri dhe të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë duke zbritur çdo kosto transaksioni që i përkasin në mënyrë të drejtpërdrejtë.

(f) Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Aktivitet afatgjata materiale maten me kosto duke zbritur zhvlerësimin e akumuluar (shënimi 16) dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka. Kostoja përfshin shpenzimet që i takojnë drejtpërdrejt koston së blerjes së aktivitetit. Kur pjesët e një aktiviteti kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato konsiderohen si elementë të veçantë (pjesë përbërëse kryesore) të pajisjes.

Humbjet dhe fitimet nga nxjerrja jashtë përdorimit të një elementi të pajisjeve përcaktohen përmes krahasimit të të ardhurave të gjeneruara nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën e mbetur të pajisjes, dhe njihen neto brenda të ardhurave të tjera në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.
Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare të konsoliduara – 31 dhjetor 2024
(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)
3. Politikat domethënëse financiare (vazhdim)
(ii) Kostot e mëpasshme

Kosto e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbetur të elementit nëse pritet që prej këtij zëvendësimi të rrjedhin përfitime të ardhshme ekonomike për Grupin dhe nëse kjo kosto mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të riparimit të përhershëm të ndërtesës dhe pajisjeve njihen në pasqyrën e të ardhura shpenzimeve kur ato ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi

Toka nuk zhvlerësohet. Zhvlerësimi i përmirësimeve të objekteve me qira realizohet përmes metodës lineare mbi jetëgjatësinë e vlerësuar të aktiveve, ndërsa vlerësimi i aktiveve të tjera aftagjata materiale llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur. Normat e përcaktuara të zhvlerësimit janë si më poshtë:

Kategoria	2024	2023
Përmirsimet e ndërtesave	2.5 - 5	2.5 - 5
Pajisje zyre	10 - 20	10 - 20
Mjete motorike	20	20
Pajisje kompjuterike	25	25

Vlera e mbetur, nëse, është e rëndësishme rivlerësohet çdo vit. Përmirësimet e qirasë kapitalizohen dhe amortizohen gjatë periudhës më të vogël të jetës së tyre të dobishme dhe afatit të qirasë.

(g) Aktive me të drejtë përdorimi

Grupi jep me qira zyra të ndryshme. Kontratat mund të përmbajnë komponentë të qirasë dhe jo-qirasë. Grupi ka zgjedhur të mos ndajë përbërësit e qirasë dhe jo-qirasë dhe në vend të kësaj i llogaritet këto si një përbërës të vetëm qiraje. Aktivet me të drejtën e përdorimit maten me koston që përfshin shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë.

Aktivët me të drejtën e përdorimit maten me koston që përfshin sa më poshtë:

- shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë,
- çdo pagesë qiraje e bërë në ose përpara datës së fillimit minus çdo stimul qiraje të marrë,
- çdo kosto fillestare direkte.

Aktivët me të drejtën e përdorimit zakonisht amortizohen gjatë periudhës më të shkurtër të jetës së dobishme të aktivit dhe afatit të qirasë në bazë lineare. Nëse Grupi është në mënyrë të arsyeshme i sigurt se do të ushtrojë një opsion blerjeje, aktivi i së drejtës së përdorimit amortizohet gjatë jetës së dobishme të aktiveve bazë. Amortizimi i zërave të aktiveve me të drejtën e përdorimit llogaritet duke përdorur metodën lineare gjatë jetëgjatësisë së tyre të dobishme të parashikuar të ndërtesave.

(h) Aktivët jomateriale

Aktivët jomateriale të Grupit, përveç emrit të mirë, kanë jetë të dobishme të përcaktuar dhe kryesisht përfshijnë programe kompjuterike të kapitalizuara, patenta, marka tregtare dhe licenca. Licensat e fituara të programeve kompjuterike, patentat dhe markat tregtare kapitalizohen në bazë të kostove për blerjen dhe vënien në përdorim të tyre.

Kostot e zhvillimit që lidhen drejtpërdrejt me programet kompjuterike të identifikueshëm dhe unik të kontrolluar nga Grupi regjistrohen si aktive jomateriale nëse është e mundshme një hyrje e përfitimeve ekonomike në rritje që tejkalojnë kostot. Kostot e kapitalizuara përfshijnë kostot e stafit të ekipit të zhvillimit të programeve kompjuterike dhe një pjesë të përshtatshme të shpenzimeve të përgjithshme përkatëse. Të gjitha kostot e tjera që lidhen me programin kompjuterik, përsëmbull, mirëmbajtja e tij, shpenzohen kur ndodhin. Aktivët jomateriale amortizohen duke përdorur metodën lineare gjatë jetëgjatësisë së tyre të dobishme prej 4 deri në 10 vjet.

Aktivët jomateriale shpalosen së bashku me aktivet afatgjate materiale në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar dhe shënimet përkatëse të pasqyrave financiare të konsoliduara.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.
Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare të konsoliduara – 31 dhjetor 2024
(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)
3. Politikat domethënëse financiare (vazhdim)

Në fund të çdo periudhe raportuese, Grupi rishikon vlerat kontabël të aktiveve të tij jomateriale për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues të zhvlerësimit. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, Grupi vlerëson shumën e rikuperueshme, e cila përcaktohet si më e larta midis vlerës së drejtë të një aktivi minus kostot e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Vlera kontabël reduktohet në shumën e rikuperueshme dhe humbja nga rënia në vlerë njihet në fitim ose humbje për vitin. Një humbje nga rënia në vlerë e njohur për një aktiv në vitet e mëparshme anulohet kur është e përshtatshme nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën në përdorim të aktivit ose vlerën e drejtë minus kostot e shitjes.

(i) Kapitali aksionar

Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital. Kostot e lidhura me emetimin e aksioneve të reja paraqiten në kapital si pakësim, neto nga tatimi mbi fitimin. Çdo tejkallim i vlerës së drejtë të shumës së marrë mbi vlerën nominale të aksioneve të emetuara regjistrohet si prim i aksioneve në kapital.

Dividendët

Dividendët regjistrohen si detyrim dhe zbriten nga kapitali neto në periudhën në të cilën janë deklaruar dhe miratuar. Çdo dividend i deklaruar pas periudhës raportuese dhe përpara se pasqyrat financiare të konsoliduara të autorizohen për emetim janë shpalosur në shënimin e ngjarjeve pas periudhës raportuese.

(j) Rezerva për veprimtarinë e sigurimit

Rezerva e rrezikut të sigurimit krijohet bazuar në legjislacionin e sigurimeve në vendet ku Grupi operon, dhe ajo përbën një pjesë të caktuar të fitimit të periudhës së mëparshme nëse fitimi nuk përdoret për të mbuluar humbjet e akumuluar të trashëguara nga vitet e mëparshme. Kjo rezervë krijohet për të garantuar fondin e aftësisë paguese dhe të fondit të garancisë.

(k) Njohja e të ardhurave

Politika kontabël në lidhje me të ardhurat nga kontratat e sigurimit është shpalosur në shënimet 4.b.ii. Të ardhurat nga interesi mbi aktivet financiare njihen duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat e grupit nga shërbimet përfshijnë kompensimin, të ardhurat nga rimbursimi, shërbimet e agjencisë, të ardhurat nga komisionet. Të ardhurat nga komisioni lidhen me tarifat e menaxhimit të fondeve, të cilat njihen si të ardhura bazuar në një përqindje të caktuar të vlerës së aktiveve neto të fondeve të menaxhuara në çdo datë raportimi në baza vjetore, d.m.th., në periudhën kontabël në të cilën janë kryer shërbimet.

(l) Përfitimet e punonjësve
Sigurimet shoqërore të detyrueshme

Grupi paguan kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore që ofrojnë përfitime pensioni për punonjësit pas daljes në pension. Autoritetet përkatëse të sigurimeve shoqërore janë përgjegjëse për sigurimin e kufirit minimal të përcaktuar ligjërisht për pensionin sipas një plani pensioni me kontribute të përcaktuara. Kontributi i Grupit në planin e përfitimeve të pensioneve ngarkohet në fitim dhe humbje në momentin që ndodh dhe Grupi nuk ka detyrime të mëtejshme.

(p) Detyrimet e qirasë

Detyrimet që rrjedhin nga një qira maten fillimisht maten mbi bazën e vlerës aktuale. Detyrimet e qirasë përfshijnë vlerën aktuale neto të pagesave fikse (duke përfshirë pagesat fikse në substancë), minus çdo stimul qiraje të arkëtueshme.

Opsionet e zgjatjes dhe përfundimit janë të përfshira në një numër të qirave të pronës. Këto terma përdoren për të maksimizuar fleksibilitetin operacional në drejtim të menaxhimit të aktiveve të përdorura në operacionet e Grupit. Shumica e opsioneve të zgjatjes dhe përfundimit të mbajtura janë të ushtrueshme si nga Grupi ashtu edhe nga qiradhenësi përkatës. Opsionet e zgjatjes (ose opsionet e periudhës pas përfundimit) përfshihen në afatin e qirasë vetëm nëse qiraja është në mënyrë të arsyeshme e sigurt se do të zgjatet (ose nuk do të përfundojë). Pagesat e qirasë që do të kryhen sipas disa opsioneve të arsyeshme të zgjatjes përfshihen gjithashtu në matjen e detyrimit. Pagesat e qirasë skontoen duke përdorur normën e interesit të nënkuptuar në qira.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.
Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare të konsoliduara – 31 dhjetor 2024
(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

3. Politikat domethënëse financiare (vazhdim)

Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtësisht, gjë që është përgjithësisht rasti për qiratë e Grupit përdoret norma rritëse e huamarrjes, që është norma që Grupi duhet të paguajë për të marrë hua fondet e nevojshme për të marrë një aktiv me vlerë të ngjashme me aktivi me të drejtën e përdorimit në një mjedis të ngjashëm ekonomik me terma, kolateral dhe kushte të ngjashme.

Për të përcaktuar normën në rritje të huamarrjes, Grupi:

- përdor një qasje ngritjeje që fillon me një normë interesi pa rrezik të rregulluar për rrezikun e kredisë, dhe
- bën rregullime specifike të qirasë, p.sh. afati, vendi, monedha dhe kolaterali.

Kostot financiare ngarkohen në fitim ose humbje gjatë periudhës së qirasë në mënyrë që të prodhojnë një normë konstante periodike të interesit për tepicën e mbetur të detyrimit për çdo periudhë. Pagesat e lidhura me qiratë afatshkurtra të pajisjeve, mjeteve motorike dhe të gjitha qiratë e aktiveve me vlerë të ulët njihen në bazë lineare si shpenzim në fitim ose humbje. Qiratë afatshkurtra janë qiratë me një afat qiraje prej 12 muajsh ose më pak.

(q) Provizionet për detyrimet dhe tarifat

Provizionet për detyrimet dhe tarifat janë detyrime jo-financiare në kohë ose vlerë të papërcaktuar. Provizionet përlllogariten kur Grupi ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv për shkak të ngjarjeve të ndodhura më parë, dhe përfitime ekonomike të kërkuhen për të shlyer detyrimin pas një vlerësimi të shumës së detyrimit. Provizionet maten me vlerën aktuale të shpenzimeve që pritet të kërkuhen për të shlyer detyrimin duke përdorur një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për detyrimin. Rritja e provizionit për shkak të kalimit të afatit kohor njihet si shpenzim interesi në shpenzimet financiare.

Taksat dhe tarifat, të tilla si tatimet përveç tatimit mbi fitimin ose tarifat rregullatore bazuar në informacionin që lidhet me një periudhë përpara se të lindte detyrimi për të paguar, njihen si detyrime kur ndodh ngjarja detyruese që shkakton pagimin e një takse, siç identifikohet nga legjislacioni, e cila sjell detyrimin për të paguar taksën. Taksat dhe tarifat, përveç tatimit mbi fitimin ose tarifat rregullatore, njihen si detyrime kur ndodh ngjarja detyruese që shkakton pagimin e një takse, siç identifikohet nga legjislacioni, e cila sjell detyrimin për të paguar taksën. Nëse një taksë paguhet përpara ngjarjes detyruese, ajo njihet si një parapagim. Ndër të tjera, mbi të njëjtën bazë, Grupi krijon provizion për fondin e kompensimit të sigurimit motorik, i cili ndahet nga rregullatorët për të gjitha shoqëritë e sigurimit bazuar në peshën e tyre në tregun e sigurimit të mjeteve motorike.

(r) Tatimi mbi fitimin

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin përfshijnë tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë i cili njihet në fitim ose humbje, përveç në masën që lidhet me zërat e njohur drejtpërdrejt në kapital ose në OCI. Interesi dhe gjobat që lidhen me tatimet mbi të ardhurat, duke përfshirë trajtimet e pasigurta tatimore, llogariten sipas SNK 37 Provizionet, Detyrimet dhe Aktivitet Kontingjente.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual përfshin tatimin e pritshëm të pagueshëm ose tatimin e pritshëm për të ardhurat ose humbjen e tatueshme për vitin dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm ose të arkëtueshëm në lidhje me vitet e mëparshme. Shuma e tatimit aktual të pagueshëm ose të arkëtueshëm është vlerësimi më i mirë i shumës së tatimit që pritet të paguhet ose merret që pasqyron pasigurinë në lidhje me tatimet mbi të ardhurat, nëse ka. Ajo matet duke përdorur normat tatimore të miratuara ose në mënyrë thelbësore në datën e raportimit. Aktivitet dhe detyrimet tatimore aktuale kompensohen vetëm nëse plotësohen disa kritere.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferenca të përkohshme ndërmjet vlerës të mabrtura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimore. Aktivitet tatimore të shtyra njihen për kreditë tatimore të papërdorura dhe diferencat e përkohshme të zbritshme deri në masën që është e mundshme që fitimet e tatueshme në të ardhmen do të jenë të disponueshme kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Fitimet e ardhshme të tatueshme përcaktohen në bazë të planeve të biznesit.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.
Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare të konsoliduara – 31 dhjetor 2024
(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

3. Politikat domethënëse financiare (vazhdim)

Aktivitet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në masën që nuk është më e mundshme që përfitimi tatimor përkatës do të realizohet; këto reduktime anulohen kur probabiliteti i fitimeve të tatueshme në të ardhmen përmirësohet. Aktivitet tatimore të shtyra të panjohura rivlerësohen në çdo datë raportimi dhe njihen në masën që është bërë e mundshme që fitimet e tatueshme në të ardhmen do të jenë të disponueshme kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të zbatohen për diferencat e përkohshme kur ato kthehen, duke përdorur normat tatimore të miratuara ose të miratuara në mënyrë thelbësore në datën e raportimit. Matja e tatimit të shtyrë pasqyron pasojat tatimore që do të pasonin nga mënyra në të cilën Grupi pret, në datën e raportimit, të rikuperojë ose të shlyejë vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të tij. Aktivitet dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen vetëm nëse plotësohen disa kritere. Grupi nuk ka njohur asnjë aktiv ose detyrim tatimor të shtyrë në këto pasqyra financiare të konsoliduara duke qenë se drejtimi e konsideron ndikimin e tij të mos jetë material.

4. Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme në zbatimin e politikave kontabël

Grupi bën vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe në vlerat kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën e drejtimit dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë e ngjarjeve të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme sipas rrethanave. Drejtimi gjithashtu bën disa gjykime, përveç atyre që përfshijnë vlerësime, në procesin e zbatimit të politikave kontabël. Gjykimet që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerësimet që mund të shkaktojnë një rregullim të rëndësishëm në vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar përfshijnë:

Pretendimet dhe përfitimet e policëmbajtësit

Vlerësimi i detyrimit përfundimtar që lind nga pretendimet e bëra sipas kontratave të sigurimit është vlerësimi kontabël më kritik i Grupit. Vendimet e Grupit për humbjet e raportuara dhe të pararaportuara dhe vendosja e provizioneve rezultuese dhe risigurimeve të rikuperueshme rishikohen dhe përditësohen çdo vit, dhe rregullimet që rezultojnë nga ky rishikim pasqyrohen në fitim ose humbje.

Procesi bazohet në supozimin se përvoja e kaluar, e përshtatur për efektin e zhvillimeve aktuale dhe tendencave të mundshme, është një bazë e përshtatshme për parashikimin e ngjarjeve të ardhshme. Menaxhimi i rrezikut të sigurimit është diskutuar në detaje në Shënimin 7, ndërsa dispozitat e kontratave të sigurimit janë analizuar në Shënimin 18.

Dëmet që lidhen me veprimtarinë e përgjithshme të sigurimit

Dëmet e ndodhura përfshijnë kostot e shlyerjes dhe trajtimit të dëmeve të paguara dhe të papaguara që lindin nga ngjarjet që kanë ndodhur gjatë vitit financiar së bashku me rregullimet në provizionet e dëmeve të vitit të kaluar.

Sigurimi i jo jetës

Kërkesat e papaguara vlerësohen duke shqyrtuar pretendimet individuale dhe duke bërë kompensim për dëmet e shkaktuara por të paraportuara, efektin e ngjarjeve të parashikueshme të brendshme dhe të jashtme, të tilla si ndryshimet në procedurat e trajtimit të dëmeve, inflacioni, tendencat gjyqësore, ndryshimet legjislative dhe përvoja dhe tendencat e kaluara. Provizionet për dëmet e papaguara nuk zbriten. Rregullimet për provizionet e pretendimeve të krijuara në vitet e mëparshme pasqyrohen në pasqyrat financiare të periudhës në të cilën janë bërë rregullimet dhe shpalosen veçmas nëse janë të rëndësishme. Provizioni për dëmet e shkaktuara por të paraportuara është vlerësuar në bazë të metodës së trekëndësheve të paguar për produktin e Detyrimeve ndaj Palëve të Treta (“MTPL”) ndërsa për linjat e tjera të biznesit përdoret një metodologji e thjeshtuar e bazuar në raportin e primit të fituar.

Sigurimi i jetës

Provizioni përfaqëson koston përfundimtare të vlerësuar të shlyerjes së të gjitha dëmeve, duke përfshirë kostot e shlyerjes direkte dhe indirekte, që lindin nga ngjarjet që kanë ndodhur deri në datën e raportimit, duke përfshirë një vlerësim për koston e dëmeve të shkaktuara por të pa raportuara (IBNR) në atë datë. Provizioni për dëmet e papaguara krijohet rast pas rasti me shumën e pagesës së pritshme. Provizioni për dëmet e shkaktuara por të pa raportuara krijohet duke përdorur metodën e shkallëve zinxhir. Pretendimet e biznesit të sigurimit të jetës pasqyrojnë koston e të gjitha dëmeve që lindin gjatë vitit, duke përfshirë bonuset e policave të alokuara në pritje të një deklaratë bonusi.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.
Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare të konsoliduara – 31 dhjetor 2024
(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)
4. Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme në zbatimin e politikave kontabël (vazhdim)
i) Rezerva të tjera matematikore të sigurimit të jetës

Provizioni i sigurimit të jetës llogaritet mbi bazën e policës duke përdorur metodën e perspektivës neto. Supozimet mbi vdekshmërinë dhe normën e interesit të përdorura në rezervim janë në përputhje me supozimet e çmimit ku një interval prej 80 deri në 85% e kthimit shtesë kthehet pasi kalon afati i policës.

ii) Kostot e trajtimit të dëmeve

Kostot e trajtimit të dëmeve përbëhen nga shpenzimet e jashtme të trajtimit të dëmeve dhe nuk përfshijnë shpenzimet e brendshme të trajtimit të dëmeve të cilat konsiderohen të jenë jo të rëndësishme në krahasim me kostot e jashtme. Grupi krijon një provizion për kostot e trajtimit të dëmeve brenda provizioneve përkatëse të trajtimit të dëmeve, përveç rezervave për dëmet e papaguara.

iii) Detyrimet për dëmet në proces gjyqësor

Një pjesë e konsiderueshme e dëmeve janë në proces gjyqësor. Ndërsa drejtimi konsideron se detyrimet e sigurimit për dëmet dhe dëmet e paguara nga risiguruesit, duke përfshirë rezervat dhe kushtëzimet për dëmet sipas një procesi ligjor, janë deklaruar në mënyrë të drejtë, detyrimi përfundimtar mund të ndryshojë si rezultat i informacionit dhe ngjarjeve të mëvonshme dhe mund të rezultojë në rregullime të rëndësishme të shumave.

Rregullimet në shumat e detyrimeve të sigurimit pasqyrohen në pasqyrat financiare për periudhën në të cilën janë bërë rregullimet.

Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve
Sigurimi i jo-jetës

Në çdo datë raportimi Grupi kryen teste për të siguruar përshtatshmërinë e rezervave të dëmeve. Testet primare të kryera janë analiza “Raporti i dëmeve” dhe analiza “Run-off” e rezervave të dëmeve. Analiza e raportit të dëmeve kryhet çdo vit individualisht në linjat kryesore të biznesit. Llogaritja kryhet për dëmet veçmas, si dhe për dëmet që përfshijnë shpenzimet e marrjes në sigurim dhe çdo shpenzim tjetër të trajtimit të dëmeve. Në kryerjen e kësaj analize, Grupi merr parasysh vlerësimet aktuale të flukseve dalëse monetare. Grupi nuk i aktualizon këto flukse monetare të vlerësuara sepse shumica e dëmeve priten dhe kërkohen të shlyhen brenda një viti.

Për më tepër, Grupi kryen çdo vit një analizë “Run-off” të rezervave të dëmeve për të vlerësuar metodologjinë e tij të rezervimit. Analiza “Run-off” kryhet në bazë të RBNS dhe IBNR veçmas si dhe në bazë të kombinuar. Në rast se analiza tregon mospërputhje të mëdha, rregullimet e duhura bëhen në metodologjinë e rezervimit. Nëse identifikohet një mangësi, ajo do të ngarkohet menjëherë në fitim ose humbje duke krijuar një rezervë për rrezikun e paskaduar nga humbjet që rrjedhin nga Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve.

Sigurimi i jetës

Në çdo datë raportimi, Grupi kryen teste për të siguruar mjaftueshmërinë e detyrimeve të kontratës së sigurimit të jetës. Testet primare të kryera janë analiza e raportit të dëmeve. Analiza e raportit të dëmeve kryhet çdo vit në linjat kryesore të biznesit të jetës individualisht (jeta në kredi dhe jeta e kombinuar). Llogaritja kryhet vetëm për dëmet, si dhe për dëmet që përfshijnë kostot e blerjes dhe çdo kosto tjetër të trajtimit të dëmit. Në kryerjen e kësaj analize, Grupi merr parasysh vlerësimet aktuale të daljeve të parasë. Grupi nuk i skanton këto flukse monetare dalëse të vlerësuara sepse shumica e dëmeve pritet të shlyhen brenda një viti. Për më tepër, Grupi kryen çdo vit një analizë të rrjedhës së detyrimeve të kontratave të sigurimit për të vlerësuar metodologjinë e rezervimit të tij. Nëse identifikohet një mangësi, ajo do të ngarkohet menjëherë në fitim ose humbje duke krijuar një provizion rreziku të paskaduar nga humbjet që rrjedhin nga Testi i Mjaftueshmërisë së Përgjegjësisë. Grupi ka llogaritur LAT-në për sigurimin afatgjatë të jetës përmes metodave të jo-jetës dhe për jeta në kursim përmes metodave të jetës bazuar në vlerësimet aktuale të flukseve të ardhshme të parasë në mënyrë që të vlerësojë përshtatshmërinë e rezervës për jetë në kursim. Supozimet dhe ndjeshmëritë janë të shpalosura në Shënimin 6 të këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

5. Shpallje të reja të kontabilitetit

Grupi pritet të adaptojë Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNRF), nga 1 janari 2025. SNRF 1 do të zbatohet duke u aplikuar në mënyrë të përshtatshme me rrethanat.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.
Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare të konsoliduara – 31 dhjetor 2024
(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)
6. Administrimi i rrezikut të veprimtarisë së sigurimit

Grupi pranon rrezikun e sigurimit nëpërmjet kontratave të sigurimit ku merr përsipër rrezikun e humbjes nga personat ose shoqëritë. Grupi është i ekspozuar ndaj pasigurive lidhur me kohën, shpeshtësinë dhe madhësinë e dëmeve sipas këtyre kontratave.

Rreziku i sigurimit lidhet me pasigurinë e biznesit të sigurimeve. Përbërësit më të rëndësishëm të rrezikut të sigurimit janë rreziku i primit dhe rreziku i rezervës. Këto kanë të bëjnë me përshtatshmërinë e niveleve të primit të sigurimit dhe mjaftueshmërinë e provizioneve në lidhje me detyrimet e sigurimit dhe bazën e kapitalit. Rreziku i primit është i pranishëm kur polica lëshohet përpara se të ketë ndodhur ndonjë ngjarje e siguruar.

Rreziku është që shpenzimet dhe humbjet e shkaktuara do të jenë më të larta se primi i marrë. Rreziku i rezervës përfaqëson rrezikun që niveli absolut i provigjoneve teknike është vlerësuar gabimisht ose që pretendimet aktuale do të luhaten rreth vlerës së mesatares statistikore.

Administrimi i rreziqeve

Grupi administron rrezikun e saj nëpërmjet strategjisë së saj të planit të risigurimit brenda një kuadri të përgjithshëm të administrimit të rrezikut. Çmimi bazohet në supozime që kanë të bëjnë me ecurinë dhe përvojën mëparshme. Ekspozimet ndaj rreziqeve administrohen përmes kufizimeve dhe kritereve të vendosura në kontratat e nënshkruara. Risigurimi minimizon efektin e humbjes potenciale të Grupit nga ngjarje të mëdha ose katastrofike dhe gjithashtu ndikon në aksesin e specialistëve ndaj rreziqeve dhe lehtëson administrimin e kapitalit. Politikat e risigurimit janë të dakordësuara me risiguruesit e aprovuar, të kuotuar ose bazohen në terma të limiteve të marrëveshjes për kufjtë e humbjeve. Kapitali rregullator administrohet duke iu referuar rrezikut të sigurimit në të cilin është ekspozuar Grupi.

Sigurimi i jo-jetës

Grupi menaxhon rrezikun e tij nëpërmjet procedurave e marrjes në sigurim (përfshirë kufijtë, miratimet, çmimet, dizajnin e produktit) dhe strategjinë e risigurimit brenda një kuadri të përgjithshëm të menaxhimit të rrezikut. Çmimi bazohet në supozime që kanë parasysh tendencat dhe përvojën. Ekspozimet menaxhohen duke pasur kufizime dhe kritere të dokumentuara të nënshkrimit. Risigurimi bëhet për të zbutur efektin e humbjes së mundshme të Grupit nga ngjarje individuale të mëdha ose katastrofike dhe për të siguruar akses ndaj rreziqeve të specializuara dhe për të ndihmuar në menaxhimin e kapitalit. Policat e risigurimit shkruhen me risiguruesit e aprovuar ose mbi bazën e marrëveshjeve me kuota ose mbi bazën e marrëveshjes së tejkalimit të humbjes. Kapitali rregullator gjithashtu menaxhohet (megjithëse jo ekskluzivisht) duke iu referuar rrezikut të sigurimit ndaj të cilit Grupi është i ekspozuar. Grupi regjistron pronat, detyrimet dhe rreziqet motorike kryesisht për një kohëzgjatje dymbëdhjetë mujore. Rreziqet më të rëndësishme lindin nga fatkeqësitë natyrore, ndryshimet klimatike dhe katastrofa të tjera (p.sh. ngjarje me ashpërsi të lartë, me frekuencë të ulët). Përqendrimi i rrezikut mund të lindë gjithashtu nga një kontratë e vetme sigurimi e lëshuar për një lloj të caktuar demografik të policës, brenda një vendndodhjeje gjeografike ose për lloje të biznesit tregtar.

Shpërndarja e dëmeve të paguara është përmbledhur si më poshtë duke iu referuar detyrimeve të kontratave të sigurimit:

	Bruto	2024 Risigurimi	Neto	Bruto	2023 Risigurimi	Neto
Linja e biznesit të jo jetës						
Mjete motorike	4,440,794	(225,007)	4,215,786	3,061,834	(209,199)	2,852,635
Prona	2,335,769	(1,496,661)	839,108	779,938	(424,835)	355,103
Shëndeti dhe aksidentet	129,587	-	129,587	81,274	-	81,274
Totali	6,906,149	(1,721,669)	5,184,481	3,923,046	(634,034)	3,289,012

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.
Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare të konsoliduara – 31 dhjetor 2024
(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

6. Administrimi i rrezikut të veprimtarisë së sigurimit (vazhdim)

Shpërndarja e dëmeve të paguara sipas vendndodhjes është përmbledhur më poshtë duke iu referuar detyrimeve të kontratave të sigurimit:

	Bruto	2024 Risigurimi	Neto	Bruto	2023 Risigurimi	Neto
Vendndodhja						
Shqipëria	3,631,909	(734,376)	2,897,533	3,185,199	(594,418)	2,590,781
Kosova	2,527,383	(936,029)	1,591,354	35,155	(10,747)	24,408
Republika e Maqedonisë së Veriut	746,857	(51,263)	695,594	702,692	(28,869)	673,823
Totali	6,906,149	(1,721,668)	5,184,481	3,923,046	(634,034)	3,289,012

Shpërndarja e rezervave për primin e pafituar (UPR) sipas llojit të kontratës është përmbledhur më poshtë duke iu referuar detyrimeve të kontratave të sigurimit:

	Bruto	2024 Risigurimi	Neto	Bruto	2023 Risigurimi	Neto
Linja e biznesit të jo jetës						
Mjete motorike	3,097,513	(1,053)	3,096,460	2,351,108	(436)	2,350,672
Prona	1,375,478	(387,041)	988,437	2,187,267	(275,505)	1,911,762
Shëndeti dhe aksidentet	410,390	(11,028)	399,362	1,661,615	(16,231)	1,645,384
Totali	4,883,381	(399,122)	4,484,259	6,199,990	(292,172)	5,907,818

Përqendrimi i provizioneve të primit (UPR) sipas vendndodhjes është përmbledhur më poshtë duke iu referuar vendndodhjeve:

	Bruto	2024 Risigurimi	Neto	Bruto	2023 Risigurimi	Neto
Vendndodhja						
Shqipëria	2,945,359	(294,025)	2,651,334	2,663,953	(233,288)	2,430,665
Kosova	804,729	(24,080)	780,649	12,496	(347)	12,149
Republika e Maqedonisë së Veriut	1,133,293	(81,017)	1,052,276	3,523,541	(58,537)	3,465,004
Totali	4,883,381	(399,122)	4,484,259	6,199,990	(292,172)	5,907,818

Sigurimi i jetës

Në parim, të gjitha produktet e jetës të marra në sigurim nga Grupi mbulojnë rrezikun e vdekshmërisë, në disa raste mbulimi është i kufizuar në mbulim të pjesshëm, humbje për shkak të aksidenteve. Produktet e tjera përveç fondit të kompensimit kanë karakteristika të ngjashme të produkteve me afat të shkurtër dhe janë të rinovueshme çdo vit me një opsion për të ndryshuar primin nga Grupi. Termat dhe kushtet e kontratave të sigurimit që kanë një efekt material në shumën, kohën dhe pasigurinë e flukseve monetare të ardhshme që rrjedhin nga kontrata e sigurimit janë paraqitur më poshtë.

Sigurimi i jetës për hua

Kontratat e klasifikuara si “Sigurim i Jetës për hua” janë përgjithësisht polica vjetore të rinovueshme që mbulojnë rrezikun e vdekjes dhe ofrohen për bankat sëbashku me kredinë. Shuma e siguruar zvogëlohet paralelisht me ripagimin e kredisë.

Sigurimi i kombinuar

Sigurimi i kombinuar përbëhet nga polica përmes të cilave Grupi nënshkruan mbulimet në grup. Kontratat e jetës me afat shlyejnë përfitimet e garantuara në rast vdekjeje të cilat janë të përcaktuara në shumën e sigurimit fikse që nuk varen nga Grupi. Kontratat lëshohen për individë dhe grupe individësh.

Jeta me kursim

Përfshin sigurimin e jetës dhe një komponent kursimi. Përfitimet nga ky produkt i merr i siguruari nëse ai/ajo jeton në datën e maturimit të policës ose trashëgimtarët në rast të kundërt. Data e maturimit varion nga 5 në 30 vjet. Në rast të daljes nga sigurimi gjatë tre viteve të parë të policës, Grupi nuk ka asnjë detyrim ndaj policëmbajtësit ardhmen. Përfitimi në rast vdekjeje është i barabartë me pjesën e rezervës për kursimin dhe shumën e siguruar e cila varion nga ALL 135,251 deri në ALL 10,392,155.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.
Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare të konsoliduara – 31 dhjetor 2024
(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

6. Administrimi i rrezikut të veprimtarisë së sigurimit (vazhdim)

Pas kësaj periudhe, Grupi paguan vlerat e përcaktuara nga kushtet në policë. Produkti është afatgjatë dhe me përfitime të garantuara, madhësia e të cilave pritet të rritet në të Përqendrimi i jetës për rezervën teknike dhe matematikore, rezervën e primit të pafituar, aktivet e risigurimit është përmbledhur më poshtë:

31 dhjetor 2024	RBNS dhe IBNR	Rezerva matematikore	UPR	Totali	Risigurimi	Neto
Lloji i produktit						
Sigurim Jeta për hua	1,071,469	-	866,803	1,938,272	(10,373)	1,927,898
Sigurim Jeta e kombinuar	-	-	161,472	161,472	(9,240)	152,232
Sigurim Jetë me kursim	-	1,220,769	72,609	1,293,378	(132)	1,293,510
Totali	1,071,469	1,220,769	1,100,884	3,393,122	(19,481)	3,373,640

31 dhjetor 2023	RBNS dhe IBNR	Rezerva matematikore	UPR	Totali	Risigurimi	Neto
Lloji i produktit						
Sigurim Jeta për hua	206,816	-	732,044	938,860	(12,070)	926,790
Sigurim Jeta e kombinuar	-	-	133,595	133,595	(8,706)	124,889
Sigurim Jetë me kursim	-	1,606,331	68,617	1,674,948	(9)	1,674,939
Totali	206,816	1,606,331	934,256	2,747,403	20,785	2,726,618

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Rezerva për dëmet pezull	140,649	136,000
Rezerva për dëmet e paraportuara (“IBNR”)	37,302	30,162
Kontrata të tërhequra	51,107	40,654

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Provizion për rezervat teknike	229,058	206,816
Rezerva matematikore – Jeta me kursim	1,507,915	1,569,349
Rezerva e primit të pafituar – Jeta me kursim	40,383	409,404
Rezerva të tjera matematikore	1,548,298	1,978,753

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Rezerva për sigurimin me afat	1,064,894	961,101
Rezerva për sigurimin individual	550,870	55,587
Rezerva për primin e pafituar	1,615,764	1,016,688
Rezerva matematikore dhe për primin e pafituar	3,164,063	3,898,863
Rezerva për kontratat e sigurimit, bruto	3,393,121	4,100,679
<i>Të rikuperueshme nga risiguresit</i>		
Rezerva për sigurimin me afat	(11,507)	(7,721)
Rezerva për sigurimin personal të jetës	(1,510)	(3,292)
Pjesa e risiguruesit në detyrimet e sigurimit	(13,017)	(11,013)
Rezerva për kontratat e sigurimit, neto	3,151,046	4,089,666

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.
Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare të konsoliduara – 31 dhjetor 2024
(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

6. Administrimi i rrezikut të veprimtarisë së sigurimit (vazhdim)

Dëmet aktuale të sigurimit të jo-jetës krahasuar me vlerësimet

Tabela e mëposhtme tregon dëmet aktuale të shkaktuara krahasuar me vlerësimet e mëparshme për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024 dhe 2023:

	2024	2023
RBNS		
Vlerësimet për dëmet në fillim të vitit(A)	3,434,109	3,451,831
Dëmet e periudhave të mëparshme të paguara gjatë vitit	(1,120,252)	(1,297,131)
Vlerësimet në fund të vitit për dëme të periudhave të mëparshme	(2,819,834)	(2,305,261)
Shmangia në Lekë '000 (B)	(505,977)	(150,561)
Shmangia në Lekë % (B/A)	(14.7%)	(4.36%)
IBNR		
Vlerësimet për dëmet në fillim të vitit (A)	2,187,999	1,983,468
Dëmet e periudhave të mëparshme të raportuara gjatë vitit	(438,426)	(511,126)
	(1,687,377)	(1,390,384)
Shmangia në Lekë '000 (B)	62,196	81,958
Shmangia në Lekë % (B/A)	2.8%	4.13%
Rezervat teknike për dëmet		
Vlerësimet për dëmet në fillim të vitit	5,622,109	5,435,298
Dëme të paguara dhe të raportuara gjatë periudhës	(1,558,677)	(1,808,257)
Vlerësimet në fund të vitit për dëmet	(4,507,211)	(3,695,645)
Shmangia në Lekë '000	(443,779)	(57,205)
Shmangia në Lekë %	(7.89%)	(1.05%)

Drejtimi rishikon vlerësimet dhe supozimet e dëmeve bazuar në zhvillimin aktual të dëmeve dhe bën rregullimet e duhura për metodologjitë e dëmeve.

Risigurimi dhe përqëndrimi i rrezikut- segmenti i biznesit të jetës

Risigurimi përdoret për të menaxhuar rrezikun e sigurimit. Megjithatë, kjo nuk anashkalon detyrimin e Grupit si sigurues kryesor. Nëse një risigurues nuk paguan një dëm, Grupi mbetet përgjegjës për pagesën ndaj mbajtësit të policës. Aftësia kreditore e risiguruesve merret në konsideratë në baza vjetore duke rishikuar fuqinë e tyre financiare përpara përfundimit të çdo kontrate. Grupi ka ceduar rrezikun e sigurimit për të kufizuar ekspozimin ndaj humbjeve nga nënshkrimi dhe për të minimizuar efektin e humbjeve nga sigurimi i jetës së kredisë, nëpërmjet traktateve të risigurimit të lidhura me SCOR Global Life.

Testi i mjaftueshmërisë së rezervave dhe supozimeve aktuariale – segmenti i biznesit të jetës

Grupi llogarit dhe përcakton një rezervë sigurimi të jetës (rezervë matematikore) për të siguruar pagesat e ardhshme sipas policave të sigurimit afatgjata. Shumë faktorë ndikojnë në llogaritjen e këtyre rezervave duke përfshirë, vdekshmërinë, anulimet dhe interesin teknik. Rezerva e sigurimit të jetës llogaritet në bazë të supozimeve aktuale për parametrat bazë. Për të llogaritur rezervën matematikore, Grupi përdor metodën e perspektivës neto. Grupi përdor grafikët e vdekshmërisë të publikuara në territoret përkatëse. Interesi teknik i përdorur në llogaritjen e primeve varion nga 0% në 6% në varësi të datës së lëshimit të policës, llojit të kontratës dhe monedhës përkatëse. Rezervat e kombinuara të portofolit llogariten me një normë interesi jo më të lartë se 2.25%. Rezervat e kombinuara të portofolit dhe për portofolin e jetës së huamarrësit llogariten me një normë interesi 0% për sigurimin me afat vjetor dhe me një normë interesi të garantuar për kontratat me premi të vetme për periudha më të gjata se një vit. Grupi përdor metodën zinxhir për të llogaritur rezervën IBNR. Kostot e menaxhimit të kërkesave nuk përfshihen në trekëndëshat e përdorur. Ato llogariten veçmas në masën 2% të rezervës për dëmet në pritje. Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve bazohet në analizën e parametrave kryesorë të cilët kanë ndikimin më të madh në llogaritjen e rezervës. “Vdekshmëria” është rreziku që mbulohet nga të gjithë produktet e sigurimit që Grupi ka.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.
Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare të konsoliduara – 31 dhjetor 2024
(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

6. Administrimi i rrezikut të veprimtarisë së sigurimit (vazhdim)

Të dhënat për rrezikun e “vdekshmërisë” për 2024 janë si më poshtë

	159,513 njerëz
Numri i personave të prekshëm nga rreziku i vdekjes	
Mosha e personave të prekshëm nga rreziku i vdekjes	18–72-vjeç
Numri i pagesave për të siguruarit që kanë vdekur në 2023	149 raste (këtu janë përfshirë edhe humbje jete të viteve të mëparshme)
Intervali i numrit të vdekshmërisë të llogaritur në 1,000 njerëz	0.66 deri në 47
Numri i të siguruarve të ndjeshëm ndaj rrezikut të vdekjes përfaqëson numrin e personit të siguruar të jetës, vdekja e mundshme e të cilit do të kërkonte pagesa nga Grupi për të shlyer dëmin.	

Analiza e ndjeshmërisë

Faktorët kryesor që ndikojnë në fitimin e shoqërisë është niveli i raportit të dëmeve dhe shpenzimeve. Tabela më poshtë paraqet një stimulim, duke marrë në konsideratë ndryshime drastike për dëmet e ndodhura ose rritje në shpenzime dhe efekti i saj në kapitalin neto të Grupit dhe aftësinë paguese në dispozicion. Për qëllime të simulimit, modeli përdor një rritje të dëmeve të barabartë me dëmin më të madh të ndodhura gjatë dy viteve të fundit dhe një rritje të shpenzimeve administrative prej 10%.

Situata më 31 dhjetor 2024	2024
Aktual	134,449
Rritje në dëmet e ndodhura– e barabartë me dëmin më të madh të shkaktuar në dy vitet e fundit	(24,047)
Rritje në shpenzime (+10%)	(18,796)

Rreziqet e lidhura me kontratat e sigurimit të jo-jetës janë komplekse dhe subjekt i një numri variablash që e komplikojnë analizën kualitative të ndjeshmërisë. Grupi përdor teknika statistikore dhe aktuariale duke përfshirë tregues të tillë si raporti i humbjes së pritur. Grupi e konsideron si të mjaftueshëm detyrimin për dëmet e jo-jetës në sigurim që njihet në pasqyrat e pozicionit financiar për qëllime të veçanta. Megjithatë, përvoja aktuale do të ndryshojë nga rezultati i pritur.

Një përmbledhje e humbjeve nga dëmet dhe raporti i kombinuar për vitin 2024 dhe 2023 është si më poshtë:

	2024	2023
Raporti i dëmeve	37.7%	35.6%
Raporti i shpenzimeve	42.9%	49.9%
Raporti i kombinuar	80.6%	85.5%

Rezultatet e analizës së ndjeshmërisë që tregojnë ndikimin mbi fitimin përpara tatimit paraqiten më poshtë.

Për këtë lloj ndjeshmërie tregohet ndikimi i një ndryshimi në një faktor të vetëm, duke mbajtur supozimet e tjera të pandryshuara.

	Ndikimi	2024	Ndikimi	2023
Raporti i dëmeve				
10% rritje në raportin e dëmeve	Humbje	(454,423)	Humbje	(400,611)
10% rënie në raportin e dëmeve	Fitim	454,423	Fitim	400,611
Raporti i shpenzimit				
10% rritje në raportin e shpenzimeve	Humbje	(518,080)	Humbje	(484,179)
10% rënie në raportin e shpenzimeve	Fitim	518,080	Fitim	484,179
Raporti i kombinuar				
10% rritje në raportin e kombinuar	Humbje	(972,503)	Humbje	(884,790)
10% rënie në raportin e kombinuar	Fitim	972,503	Fitim	884,790

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.
Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare të konsoliduara – 31 dhjetor 2024
(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

7. Administrimi i rrezikut financiar

Funksioni i administrimit të rrezikut brenda Grupit kryhet në lidhje me rreziqet financiare, rreziqet operacionale dhe rreziqet ligjore. Rreziku financiar përfshin rrezikun e tregut (përfshirë rrezikun e monedhës, rrezikun e normës së interesit dhe rrezikun tjetër të çmimit), rrezikun e kredisë dhe rrezikun e likuiditetit. Objektivat kryesore të funksionit të menaxhimit të rrezikut financiar janë vendosja e kufijve të rrezikut dhe më pas sigurimi që ekspozimi ndaj rreziqeve të qëndrojë brenda këtyre kufijve. Funksionet e menaxhimit të rrezikut operacional dhe ligjor synojnë të sigurojnë funksionimin e duhur të politikave dhe procedurave të brendshme, në mënyrë që të minimizohen rreziqet operacionale dhe ligjore. Grupi nuk përdor instrumente financiare derivative për të mbrojtur këto ekspozime ndaj rreziqeve.

Rreziku i tregut

Grupi merr përsipër ekspozimin ndaj rreziqeve të tregut. Rreziqet e tregut lindin nga pozicionet e hapura në (a) monedhat e huaja, (b) aktivet dhe detyrimet me interes dhe (c) produktet e kapitalit, të cilat të gjitha janë të ekspozuara ndaj lëvizjeve të përgjithshme dhe specifike të tregut. Menaxhmenti vendos kufizime mbi vlerën e rrezikut që mund të pranohet, i cili monitorohet në baza ditore. Megjithatë, përdorimi i kësaj qasjeje nuk parandalon humbjet jashtë këtyre kufijve në rast të lëvizjeve më të rëndësishme të tregut. Ndjeshmëritë ndaj rreziqeve të tregut të përfshira më poshtë bazohen në një ndryshim në një faktor duke i mbajtur të gjithë faktorët e tjerë konstant. Në praktikë kjo nuk ka gjasa të ndodhë dhe ndryshimet në disa nga faktorët mund të lidhen - për shembull, ndryshimet në normën e interesit dhe ndryshimet në normat e valutës së huaj.

Rreziku valutor

Grupi i kryen transaksione si në monedhën vendase ashtu edhe në monedhe të huaj; si rrjedhim lindin ekspozime ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit. Rreziku i monedhës është rreziku që vlera e drejtë ose flukset monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të luhaten për shkak të ndryshimeve në kursin e këmbimit. Rreziku valutor në portofolin e investimit administrohet duke përdorur parimet e përputhjes së aktiveve/detyrimeve. Kursi zyrtar i zbatueshëm (lekë ndaj njësisë valutore) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 ishte si më poshtë:

	31 dhjetor 2024		31 dhjetor 2023	
	Mesatare	Mbyllja	Mesatare	Mbyllja
USD	93.04	94.26	100.61	93.94
Euro	100.7	98.15	108.75	103.88
CHF	105.75	104.27	111.91	112.10
Denari Maqedonas	1.639	1.6	1.767	1.689

Aktivitet dhe detyrimet e Shoqërisë të shprehura në valutë të huaj më 31 dhjetor 2024 janë si më poshtë:

	ALL	EUR	USD (ekuivalentë në '000 lekë)	CHF	Denari Maqedonas	Totali
AKTIVET						
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	74,639	200,967	10,168	72	71,838	357,683
Depozita me afat me bankat	2,473,695	6,621,692	563,998	-	1,566,644	11,226,029
Investime të mbajtura me kosto të amortizuar	1,159,700	867,203	-	-	1,389,093	3,415,996
Investime të mbajtura me vlerë të drejte (FVTPL)	-	47,999	-	-	593,350	641,349
Llogaritë e arkëtueshme	145,602	625,487	20,133	-	455,524	1,246,746
Aktive të risigurimit	76,268	2,154,847	34,052	-	-	2,265,167
Aktive të tjera	12,199	188,835	-	-	186,318	387,352
Totali i aktiveve financiare	4,031,705	10,617,428	628,351	72	4,262,767	19,540,323
DETYRIMET						
Detyrime të kontratave të sigurimit	(5,402,844)	(6,371,049)	(85,647)	(400)	(3,322,714)	(15,182,654)
Detyrime nga veprimtaria e sigurimit dhe risigurimit	(195,068)	(72,605)	-	-	(400,683)	(668,355)
Detyrime të qirasë	(80,690)	(57,431)	-	-	-	(138,121)
Detyrime të tjera	(114,650)	(56,342)	-	-	(48,855)	(219,847)
Totali i detyrimeve financiare	(5,793,252)	(6,557,427)	(85,647)	(400)	(3,772,251)	(16,208,977)
Pozicioni neto në monedhë të huaj	(1,851,149)	4,149,603	542,704	(328)	490,516	3,331,346

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.
Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare të konsoliduara – 31 dhjetor 2024
(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

7. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Aktivitet dhe detyrimet e Shoqërisë të shprehura në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2023 janë si më poshtë:

	ALL	EUR	USD (ekuivalentë në '000 lekë)	CHF	Denari Maqedonas	Totali
AKTIVET						
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	77,079	228,924	11,006	138	74,318	391,465
Depozita me afat me bankat	1,979,456	6,282,645	523,088	-	1,566,685	10,351,874
Investime të mbajtura me kosto të amortizuar	1,177,234	931,778	-	-	1,291,011	3,400,023
Investime të mbajtura me vlerë të drejte (FVTPL)	-	44,680	-	-	429,848	474,528
Llogaritë e arkëtueshme	171,578	566,522	14,820	-	470,863	1,223,783
Aktive të risigurimit	82,763	1,405,803	31,777	-	80,568	1,600,911
Aktive të tjera	15,876.00	249,089	8	-	3,129	268,102
Totali i aktiveve financiare	3,503,986	9,709,441	580,699	138	3,916,422	17,710,686
DETYRIMET						
Detyrime të kontratave të sigurimit	(4,818,613)	(5,805,580)	(56,545)	(538)	(3,052,279)	(13,733,555)
Detyrime nga veprimtaria e sigurimit dhe risigurimit	(383,308)	(99,332)	(9,657)	-	(215,886)	(708,183)
Detyrime të qirasë	(149,866)	(41,506)	-	-	-	(191,372)
Detyrime të tjera	(234,352)	(115,166)	-	-	(99,862)	449,380
Totali i detyrimeve financiare	(5,351,787)	(5,946,418)	(66,202)	(538)	(3,268,165)	(14,633,110)
Pozicioni neto në monedhë të huaj	(1,836,289)	3,763,023	514,497	(400)	648,257	3,089,088

Ndjeshmëria ndaj rrezikut të luhatjeve të monedhave të huaja

Tabela e mëposhtme detajon ndjeshmërinë e Grupit ndaj rritjes dhe uljes së valutave të huaja përkatëse kundrejt lekut shqiptar. Një ndryshim i tillë në kursin e këmbimit të huaj përdoret kur raportohet për rrezikun e monedhës së huaj brenda personelit drejtues kryesor dhe përfaqëson vlerësimin e drejtimit për ndryshimin e arsyeshëm të mundshëm në kursin e këmbimit të huaj. Për çdo analizë të ndjeshmërisë është treguar ndikimi i ndryshimit në një faktor të vetëm, me supozime të tjera të pandryshuara. Analiza e ndjeshmërisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 janë treguar përkatësisht si më poshtë :

	Impakti	Ndikimi në pasqyrën e fitim humbjes dhe kapital për 2024
Euro rritet me 10% kundrejt lekut	Fitim	376,302
Euro ulet me 10% kundrejt lekut	Humbje	(376,302)
USD rritet me 10% kundrejt lekut	Fitim	51,450
USD ulet me 10% kundrejt lekut	Humbje	(51,450)
CHF rritet me 10% kundrejt lekut	Fitim	40
CHF ulet me 10% kundrejt lekut	Humbje	(40)
NKMD rritet me 10% kundrejt lekut	Fitim	64,825
NKMD ulet me 10% kundrejt lekut	Humbje	(64,825)
Ndikimi në pasqyrën e fitim humbjes dhe kapital për 2023		
Euro rritet me 10% kundrejt lekut	Fitim	309,303
Euro ulet me 10% kundrejt lekut	Humbje	(309,303)
USD rritet me 10% kundrejt lekut	Fitim	43,732
USD ulet me 10% kundrejt lekut	Humbje	(43,732)
CHF rritet me 10% kundrejt lekut	Fitim	(34)
CHF ulet me 10% kundrejt lekut	Humbje	34
NKMD rritet me 10% kundrejt lekut	Fitim	46,614
NKMD ulet me 10% kundrejt lekut	Humbje	(46,614)

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.
Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare të konsoliduara – 31 dhjetor 2024
(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

7. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit përbëhet nga rreziku që vlera e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të luhatet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe rrezikut që maturimet e aktiveve me interes të ndryshojnë nga maturimet e detyrimeve me interes të përdorura. për të financuar ato asete. Prandaj, kohëzgjatja për të cilën norma e interesit është fiksuar në një instrument financiar tregon se në çfarë mase ai është i ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit. Aktivet dhe detyrimet e Grupit mbajnë norma interesi fikse në treg. Më 31 dhjetor 2024 dhe 2023, Grupi nuk ka politika dhe procedura formale për menaxhimin e rreziqeve të normës së interesit pasi drejtimi e konsideron këtë rrezik si të parëndësishëm për aktivitetin e Grupit. Aktivet dhe detyrimet financiare të Grupit mbajnë norma interesi të tregut.

	Jo i ndjeshëm ndaj interesit	Interesi fiks deri në 1 vit	Interesi fiks më shumë se 1 vit	Totali
Aktive				
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	357,683	-	-	357,683
Depozita me afat me bankat	2,584,526	5,783,467	2,858,036	11,226,029
Investime të mbajtura me kosto të amortizuar	-	834,325	2,581,671	3,415,996
Investime të mbajtura me vlerë të drejte (FVTPL)	641,349	-	-	641,349
Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit	1,226,126	20,620	-	1,246,746
Aktive të risigurimit	2,265,167	-	-	2,265,167
Aktive të tjera financiare	387,352	-	-	387,352
Totali i aktiveve financiare	7,462,203	6,638,412	5,439,707	19,540,322
Detyrimet				
Detyrime nga kontratat e sigurimit për dëmet	(15,182,654)	-	-	(15,182,654)
Detyrime nga sigurimit dhe risigurimit	(668,355)	-	-	(668,355)
Detyrim të qirasë	(147,042)	(19,408)	(24,922)	(191,372)
Detyrime të tjera financiare	(219,847)	-	-	(219,847)
Totali i detyrimeve financiare	(16,217,898)	(19,408)	(24,922)	(16,262,228)
Hendeku IR më 31 dhjetor 2024	(8,755,695)	6,619,004	5,414,785	3,278,094

	Jo i ndjeshëm ndaj interesit	Interesi fiks deri në 1 vit	Interesi fiks më shumë se 1 vit	Totali
Assets				
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	391,466	-	-	391,466
Depozita me afat me bankat	2,383,438	5,333,486	2,635,668	10,352,591
Investime të mbajtura me kosto të amortizuar	-	830,424	2,569,599	3,400,023
Investime të mbajtura me vlerë të drejte (FVTPL)	474,528	-	-	474,528
Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit	1,614,281	27,052	-	1,641,333
Aktive të risigurimit	195,685	682,248	-	877,933
Aktive të tjera financiare	631,773	-	-	631,773
Totali i aktiveve financiare	6,101,329	6,935,568	5,205,267	18,242,164
Detyrimet				
Detyrime nga kontratat e sigurimit për dëmet	(10,514,080)	-	-	(10,514,080)
Detyrime nga sigurimit dhe risigurimit	(4,270)	-	-	(4,270)
Detyrim të qirasë	(155,933)	(20,581)	(26,429)	(202,943)
Detyrime të tjera financiare	(1,243,329)	-	-	(1,243,329)
Totali i detyrimeve financiare	(11,917,612)	(20,581)	(26,429)	(11,964,622)
Hendeku IR më 31 dhjetor 2023	(5,816,283)	6,914,987	5,178,837	6,277,542

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.
Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare të konsoliduara – 31 dhjetor 2024
(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

7. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Rreziku kreditor

Rreziku kreditor i referohet rrezikut që njëra palë në një instrument financiar do të shkaktojë humbje financiare për palën tjetër duke dështuar në përmbushjen e një detyrimi. Në rrjedhën normale të biznesit të saj me marrjen e primeve, këto fonde investohen për të paguar për detyrimet e ardhshme të mbajtësit të policës. Grupi është i ekspozuar ndaj rrezikut kreditor për aktivet e tij financiare të mbajtura deri në maturim, depozitat me afat, sigurimet dhe të arkëtueshmet/asetet.

Grupi ka vendosur procedura dhe udhëzime të brendshme ku partnerët e risigurimit duhet të vlerësohen me norma BB- ose më të larta dhe rreziku monitorohet nga personeli i risigurimit. Grupi menaxhon ekspozimin e tij ndaj rrezikut të kredisë në baza të rregullta. Ajo monitoron kushtet financiare të palëve të saj të depozitave me afat dhe me kufijtë rregullatorë të përqendrimit të fondeve të disponueshme me një homolog të vetëm. Përqendrimi i investimeve bazohet në performancën financiare të homologut të publikuar nga rregullatori i tyre. Grupi investon vetëm në banka që operojnë në segmente përkatëse dhe që rregullohen nga bankat qendrore përkatëse.

Për sa i përket të arkëtueshmeve nga sigurimet, Grupi monitoron ditë-vonesat. Pasi të identifikohen ditët e vonuara, kontaktohen klientët për të kuptuar arsyet e vonesës. Në rast të joefektivitetit të kontakteve fillestare, Grupi identifikon të gjitha marrëdhëniet me klientin në mënyrë që të marrë masat e duhura për të zbutur rrezikun kreditor duke përfshirë telefonata dhe takime, identifikimin e detyrimeve ndaj palës tjetër në mënyrë që të mund të lidhen marrëveshje kompensuese etj. Ekspozimi maksimal i Grupit ndaj rrezikut të kreditor sipas kategorive të aktiveve është pasqyruar në vlerat kontabël të aktiveve financiare në pasqyrën e pozicionit financiar si më poshtë:

	Nota	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre (duke përjashtuar mjetet monetare në arkë)	8	356,411	390,761
Depozita me afat me bankat	9	11,226,029	10,351,874
Investime të mbajtura me kosto të amortizuar	10	3,415,996	3,429,514
Investime të mbajtura me vlerë të drejtë (FVTPL)	11	641,349	474,529
Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit	13	1,246,746	1,223,784
Aktive të risigurimit	14	2,265,167	1,600,911
Aktive të tjera	17	558,981	657,600
Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut kreditor		19,710,679	18,066,313

Asnjë tregues për zhvlerësim nuk është identifikuar nga Grupi për aktivet e tjera financiare në datën e raportimit. Aktive të tjera financiare si ekuivalentët e mjeteve monetare, depozitat me afat dhe aktivet e tjera nuk janë as të vonuara dhe as të zhvlerësuar.

Rreziku kreditor nuk zbutet nga kolaterali. Grupi strukturon nivelet e rrezikut të kredisë që ndërmerr duke vlerësuar marrëdhëniet dhe duke vendosur kufizime në shumën e rrezikut të pranuar në lidhje me palët ose grupet e kundërpalëve. Kufijtë në nivelin e rrezikut kreditor miratohen rregullisht nga drejtimi. Rreziqe të tilla monitorohen në baza rrotulluese dhe i nënshtrohen një rishikimi vjetor, ose më të shpeshtë. Grupi rishikon analizën e vjetërsisë së të arkëtueshmeve të papaguara të sigurimit dhe ndjek balancat e vonuara. Prandaj, drejtimi e konsideron të përshtatshme të japë informacione të vjetra dhe informacione të tjera në lidhje me rrezikun e kredisë siç shpjegohet në shënimin 12. Rreziku kreditor për instrumentet financiare jashtë bilancit përkufizohet si mundësia e mbajtjes së një humbjeje për shkak të dështimit të një pale tjetër të një instrumenti financiar në përputhje me kushtet e kontratës. Ekspozime të tilla nuk janë të rëndësishme.

Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Grupi nuk mund të përmbushë detyrimet e tij të lidhura me detyrimet financiare në kohën e duhur. Rreziku i likuiditetit është mesatarisht i natyrshëm për biznesin pasi disa aktive të blera dhe detyrime të shitura mund të kenë karakteristika specifike të likuiditetit. Nëse Grupi do të kërkonte shuma të konsiderueshme me një njoftim të shkurtër që tejkalojnë kërkesat normale për para, ai mund të përballlet me vështirësi për të marrë çmime tërheqëse.

Grupi menaxhon rrezikun e likuiditetit duke monitoruar vazhdimisht flukset e parashikuara dhe aktuale të mjeteve monetare dhe duke përputhur profilet e maturimit të aktiveve dhe detyrimeve financiare. Grupi kërkon të mbajë një bazë të qëndrueshme financimi të përbërë kryesisht nga detyrimet e sigurimit dhe risigurimit.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.
Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare të konsoliduara – 31 dhjetor 2024
(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)
7. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Grupi i investon fondet në portofol të diversifikuar të aktiveve likuide, në mënyrë që të jetë në gjendje t'i përgjigjet shpejt dhe pa probleme kërkesave të paparashikuara të likuiditetit (depozita me afat në banka). Portofoli i likuiditetit të Grupit përbëhet nga paraja dhe ekuivalentët e saj, depozitat me afat në banka dhe letrat me vlerë të investimit. Drejtimi vlerëson se mjetet monetare të portofolit të likuiditetit, depozitat bankare dhe letrat me vlerë të investimit të cilat mund ti përdorë për të zgjidhur problemet afatshkurta të likuiditetit. Aktivitet dhe detyrimet financiare më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 janë të detajuara sipas maturimit kontraktual ndërsa detyrimet e kontratave të sigurimit janë paraqitur në bazë të daljeve të pritura të parasë.

31 dhjetor 2024	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	Më shumë se 1 vit	Total
Detyrimet					
Detyrime të kontratave të sigurimit për dëmet	5,378	1,518,723	3,959,036	9,567,777	15,050,915
Detyrime nga veprimtaria e sigurimit dhe risigurimit	39,348	9,356	-	362,349	411,053
Detyrim të qirasë	742	15,410	48,455	75,618	140,225
Detyrime të tjera financiare	3,357	254,636	168,688	24,067	450,748
Totali i detyrimeve financiare	48,825	1,798,125	4,176,179	10,029,812	16,052,941
31 dhjetor 2023	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	Më shumë se 1 vit	Total
Detyrimet					
Detyrime të kontratave të sigurimit për dëmet	21,658	1,526,790	564,663	7,284,380	9,397,491
Detyrime nga veprimtaria e sigurimit dhe risigurimit	4,270	-	312,322	14,889	331,481
Detyrim të qirasë	8,749	24,213	76,135	93,846	202,943
Detyrime të tjera financiare	32,658	322,778	219,569	5,927	580,932
Totali i detyrimeve financiare	67,335	1,873,781	1,172,688	7,399,042	10,512,847

Dispozitat e kontratave të sigurimit të klasifikuara mbi një vit në tabelat e mësipërme lidhen më së shumti me sigurimin e fondeve të shoqërive të Jetës dhe një sërë sigurimesh afatgjatë të pasurisë që lidhen kryesisht me segmentin shqiptar të jo-jetës.

8. Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Mjete monetare në arkë	1,272	705
Llogari rrjedhëse		
Mjete monetare në bankë në Lekë;	283,026	328,889
Mjete monetare në bankë në monedhë të huaj	73,385	61,872
Totali	357,683	391,466

Depozitat me afat me maturim fillestar më pak se 3 muaj janë klasifikuar si mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre. Të gjithë mjetet monetare në arkë dhe në banka plotësojnë përkufizimin e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të saj.

Vlerësimi kreditor i institucioneve financiare në të cilat Grupi mban mjete monetare dhe ekuivalentët të tyre është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Agjensia e vlerësimit	Vlerësimi kreditor	2024	2023
Fitch	B-	81,589	89,452
Fitch	BB	16,835	18,458
JCR Euroasia Rating	BB	27,149	29,766
Moody's	A2	73,790	80,902
Moody's	B3	9,442	10,352
S&P	BBB	24,360	26,708
Moody's	Baa1	50,848	55,749
S&P	A-1	26,121	28,638
S&P	A-2	13,570	14,877
S&P	A-3	23,220	25,458
Pa vlerësim	-	9,487	10,401
Totali (duke përjashtuar mjetet monetare në arkë)		356,411	390,761

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.
Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare të konsoliduara – 31 dhjetor 2024
(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)
9. Depozita me afat me bankat

	2024	Norma	2023	Norma
Monedha	Shuma	interesit %	Shuma	interesit %
EUR	6,785,050	0.1 – 2.5	7,460,498	0.1 – 1.2
USD	558,019	0.1 – 2.2	519,018	0.1 – 1.0
MKD	3,006,209	3.0– 5.5	239,300	3.0 – 5.0
ALL	599,800	0.5 – 3.2	1,958,900	0.5 – 2.5
Interesi i përlogaritur	276,951		174,158	
Total	11,226,029		10,351,874	

Vlerësimi kreditor i institucioneve financiare në të cilat Grupi mban depozita me afat është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Agjensia e vlerësimit	Vlerësimi kreditor	2024	2023
Fitch	B-	926,261	854,134
Fitch	BB	276,238	254,728
JCR Euroasia Rating	BB	5,230,288	4,823,013
Moody's	A2	39,770	36,673
S&P	BBB	260,526	240,239
Moody's	Baa1	3,418,468	3,152,277
S&P	A-1	692,267	638,361
S&P	A-2	178,649	164,738
S&P	A-3	160,184	147,711
Pa vlerësim	-	43,378	40,000
Totali		11,226,029	10,351,874

Depozitat me afat në banka përfshijnë fondet e garancisë të cilat përbëhen nga depozitat me afat të bllokuara në banka në secilin segment të biznesit. Fondi i garancisë mund të investohet vetëm nëpërmjet sistemit bankar në depozita me afat ose bono thesari dhe nuk është i disponueshëm për aktivitetet ditore.

Institucionet financiare të pavlerësuara përfshijnë bankat lokale që nuk janë të vlerësuara. Këto banka përfaqësojnë banka të qëndrueshme lokale të mesme, që operojnë në tregjet lokale, me aksionerë vendas dhe janë të pozicionuara mirë në treg. Të gjitha tepricat me bankat e mësipërme nuk janë as të vonuara dhe as të zhvlerësuara.

Depozitat që lidhen me fondin e garancise prej 861,118 mijë lekë janë detajuar më poshtë:

Shqipëri

Segmenti i biznesit të jo-jetës në shqipëri ruan minimalisht një të tretën e nivelit të kërkuar të nivelit të aftësisë paguese, por jo më pak se 740 milionë lekë më 31 dhjetor 2024 (31 dhjetor 2023: 740 milionë lekë), në bono thesari dhe depozita me afat me maturim jo më pak se 1 vit. Gjithashtu, segmenti i biznesit të jetës më 31 dhjetor 2024 ruan një minimum prej një të tretës së nivelit të kërkuar të nivelit të aftësisë paguese ose 370 milionë lekë (31 dhjetor 2023: 370 milionë lekë), cilido qoftë më i larti, në bono thesari dhe depozitat me afat me afat maturimi jo më pak se 1 vit.

Kosova

Mjetet monetare të kufizuara në Bankën Qendrore të Kosovës ("BQK") dhe bankat e tjera vendase përfaqësojnë një shumë ekuivalente me kapitalin aksionar të kompanive të kosovës të jetës dhe jo-jetës, e cila është shuma që kërkohet të depozitohet në përputhje me legjislacionin. Më 31 dhjetor 2024, shoqëritë e Kosovës në aktivitetin e sigurimit të jetës dhe jo-jetës kanë si mjete monetare të kufizuara një shumë të kombinuar prej 920 mijë euro ose ekuivalentin prej 90,298 mijë lekë (31 dhjetor 2023: 920 mijë euro ose ekuivalenti i 95,570 mijë lekëve) si kolateral kundrejt kapitalit aksionar përmbushin rregullat e BQK-së për subjektet përkatëse të sigurimit të jetës dhe jo-jetës.

North Macedonia

Depozitat me afat në vlerë prej 30,820 mijë lekë, ekuivalentë me 19,263 mijë denarë (31 dhjetor 2023: 32,540 mijë lekë ose 19,263 mijë denarë) përbëhen nga depozita e anëtarësimit në fondin e garancisë së Byrosë Kombëtare të Sigurimeve të Republika e Maqedonisë së Veriut, siç kërkohet me dispozitat e Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve të Maqedonisë së Veriut. Këto fonde nuk janë të disponueshme për biznesin e përditshëm të filialit.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.
Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare të konsoliduara – 31 dhjetor 2024
(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)
10. Investime të mbajtura me kosto të amortizuar

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Shuma nominale	3,383,731	3,400,023
Interesi i përllogaritur	32,265	29,491
Totali	3,415,996	3,429,514

Investimet në letrat me vlerë të mbajtura me kosto të amortizuar të segmentit shqiptar më 31 dhjetor 2024 përbëhen nga bono thesari në euro dhe lekë të cilat arrijnë vlerën e 2,026,903 mijë lekë me periudha maturimi ndërmjet një dhe shtatë vite (31 dhjetor 2023: 2,007,235 mijë lekë).

Investimet në letrat me vlerë të mbajtura me kosto të amortizuar të Maqedonisë së Veriut më 31 dhjetor 2024 arrijnë vlerën 1,389,093 mijë lekë (ekuivalente me 868,183 mijë denarë) dhe përfaqësojnë letra me vlerë të qeverisë të emetuara nga Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë së Veriut me periudha maturimi ndërmjet dy dhe shtatë vite (31 dhjetor 2023: 1,291,012 mijë lekë (ekuivalente me 764,274 mijë denarë).

Investimet në letrat me vlerë të mbajtura me kosto të amortizuar në segmentin e Kosovës më 31 dhjetor 2023 arrijnë vlerën 101,776 mijë lekë (ekuivalente me 982 mijë euro) dhe përbëhen nga bono thesari dhe obligacione të Qeverisë së Kosovës..

11. Investime të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Investime të mbajtura me vlerë të drejtë (Maqedoni e Veriut)	593,349	429,848
Investime të mbajtura me vlerë të drejtë (Shqipëri)	48,000	44,681
Total	641,349	474,529

Investimet financiare në të cilat i siguruari merr përsipër rrezikun e investimit në shumën prej 592,349 mijë lekë më 31 dhjetor 2024 (31 dhjetor 2023: 429,848 mijë lekë), i referohen plotësisht investimeve në fondet e investimeve të hapura në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ndryshimi në vlerën e drejtë të këtyre investimeve nuk është material për Grupin.

12. Shpenzime të shitjes së kontratave

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Gjëndja më 1 janar	72,658	55,627
Shpenzimi i shitjes së kontratave	21,660	20,855
Amortizimi i shpenzimeve të shitjes së kontratave për vitin të njohura në fitim ose humbje	(4,716)	(3,824)
Gjëndja në fund të vitit	89,602	72,658

13. Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit

Llogaritë e arkëtueshmet nga veprimtaria e sigurimit përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Llogari të arkëtueshme nga policëmbajtësit	1,240,510	1,213,915
Llogari të arkëtueshme nga agjentët	6,236	9,868
Totali	1,246,746	1,223,783

Llogaritë e arkëtueshmet nga policëmbajtësit bruto dhe neto nga zbritja për mosarkëtimet e mundshme janë paraqitur si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit, bruto	1,931,921	1,832,632
Zbritja për humbjet e mundshme nga zhvlerësimi	691,411	618,717
Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit, neto	1,240,510	1,213,915

Lëvizjet për humbjet nga zhvlerësimi janë detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Gjendja më 1 janar	618,717	617,922
Zhvlerësim i njohur në fitim-humbje	298,851	114,837
Fshirje nga llogaritë e arkëtueshme	(205,916)	(112,015)
Efekti i përkthimit	(20,241)	(2,027)
Totali	691,411	618,717

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.
Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare të konsoliduara – 31 dhjetor 2024
(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)
13. Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit (vazhdim)

Cilësia kreditore për llogaritë e arkëtueshme nga policëmbajtësit paraqitet si më poshtë

	2024			2023		
	Gjendja Bruto	Zhvlerësimi	Gjendja Neto	Gjendja Bruto	Zhvlerësimi	Gjendja Neto
Aktuale, as në vonesë as të zhvlerësuara (deri në 3 muaj nga data e faturës)	757,100	(8,110)	748,990	679,313	(16,911)	662,402
Në vonesë por jo të zhvlerësuara (3 deri në 6 muaj)	133,552	(9,874)	123,679	262,434	(5,115)	257,319
Të zhvlersuara (6 deri në 1 vit)	282,281	(86,109)	196,172	516,352	(257,097)	259,255
Të zhvlerësuata (Më shumë se 1 vit)	758,988	(587,318)	171,669	374,534	(339,594)	34,940
Totali	1.931.921	(691.411)	1.240.510	1.832.633	(618.717)	1.213.916

Cilësia kreditore për llogaritë e arkëtueshme nga policëmbajtësit për shoqëritë e jetës paraqitet si më poshtë:

2024				2023		
	Gjendja Bruto	Zhvlërësimi	Gjendja Neto	Gjendja Bruto	Zhvlërësimi	Gjendja Neto
As në vonesë as të zhvlerësuara (deri në 3 muaj nga data e faturës)	214,881	-	214,881	182,428	-	182,428
Në vonesë por jo të zhvlerësuara (3 deri në 6 muaj)	1,118	-	1,118	33,820	(187)	33,633
Të zhvlersuara (6 deri në 1 vit)	35,904	(25,687)	10,218	48,348	(21,643)	26,705
Të zhvlerësuata (Më shumë se 1 vit)	71,301	(27,272)	44,028	12,319	(12,319)	-
Totali	323,204	(52,959)	270,245	276,915	(34,149)	242,766

Cilësia kreditore për llogaritë e arkëtueshme nga policëmbajtësit për shoqëritë e jo-jetës paraqitet si më poshtë:

2024				2023		
	Gjendja Bruto	Zhvlerësimi	Gjendja Neto	Gjendja Bruto	Zhvlerësimi	Gjendja Neto
As në vonesë as të zhvlerësuara (deri në 3 muaj nga data e faturës)	542,219	(8,110)	534,109	496,885	(16,911)	479,974
Në vonesë por jo të zhvlerësuara (3 deri në 6 muaj)	132,435	(9,874)	122,561	221,379	(4,928)	216,451
Të zhvlersuara (6 deri në 1 vit)	246,377	(60,422)	185,955	475,863	(235,455)	240,408
Të zhvlerësuata (Më shumë se 1 vit)	687,687	(560,046)	127,641	361,591	(327,275)	34,316
Totali	1,608,717	(638,452)	970,266	1,555,718	(584,569)	971,149

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.
Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare të konsoliduara – 31 dhjetor 2024
(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)
13. Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit (vazhdim)

Cilësia kreditore për llogaritë e arkëtueshme nga policëmbajtësit sipas vendodhjes paraqitet si më poshtë:

Shqipëri	2024			2023		
	Gjendja Bruto	Zhvlerësimi	Gjendja Neto	Gjendja Bruto	Zhvlerësimi	Gjendja Neto
As në vonesë as të zhvlerësuara (deri në 3 muaj nga data e faturës)	288,974	(4,858)	284,116	250,174	(4,241)	245,933
Në vonesë por jo të zhvlerësuara (3 deri në 6 muaj)	59,456	(2,917)	56,539	74,817	(3,734)	71,083
Të zhvlersuara (6 deri në 1 vit)	118,772	(23,754)	95,018	118,102	(23,620)	94,482
Të zhvlerësuata (Më shumë se 1 vit)	315,131	(271,103)	44,028	286,279	(251,339)	34,940
Totali	782,333	(302,632)	479,701	729,372	(282,934)	446,438

Kosova	2024			2023		
	Gjendja Bruto	Zhvlerësimi	Gjendja Neto	Gjendja Bruto	Zhvlerësimi	Gjendja Neto
As në vonesë as të zhvlerësuara (deri në 3 muaj nga data e faturës)	266,387	-	266,387	275,257	(12,670)	262,587
Në vonesë por jo të zhvlerësuara (3 deri në 6 muaj)	25,020	(5,004)	20,016	27,860	(1,380)	26,480
Të zhvlersuara (6 deri në 1 vit)	63,592	(46,453)	17,139	22,512	(14,340)	8,172
Të zhvlerësuata (Më shumë se 1 vit)	107,452	(107,452)	-	88,255	(88,255)	-
Totali	462,451	(158,909)	303,543	413,884	(116,645)	297,239

Maqedonia e veriut	2024			2023		
	Gjendja Bruto	Zhvlerësimi	Gjendja Neto	Gjendja Bruto	Zhvlerësimi	Gjendja Neto
As në vonesë as të zhvlerësuara (deri në 3 muaj nga data e faturës)	204,336	(3,252)	201,084	153,882	-	153,882
Në vonesë por jo të zhvlerësuara (3 deri në 6 muaj)	49,077	(1,953)	47,124	159,756	-	159,756
Të zhvlersuara (6 deri në 1 vit)	99,917	(15,902)	84,015	375,738	(219,138)	156,600
Të zhvlerësuata (Më shumë se 1 vit)	336,405	(208,763)	127,642	-	-	-
Totali	689,735	(229,870)	459,864	689,376	(219,138)	470,237

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SH.A.
Notat shpjeguese mbi pasqyrat financiare të konsoliduara – 31 dhjetor 2024
(Të gjitha shumat janë në mijë lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)
14. Aktive të risigurimit

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Pjesa e risiguresve në rezervën e primit të pafituar	412,139	314,200
Pjesa e risiguresve në dëmet e raportuara (shënimi 18)	1,727,830	1,286,711
Risigurime për tu paguar nga risiguresi	125,198	-
Totali	2,265,167	1,600,911

Aktivët e risigurimit nuk janë as të vonuara dhe as të zhvlerësuara. Aktivët e risigurimit janë të lidhura me pjesën e risigurimit në provizionet e Grupit për dëmet dhe rezervën e primeve të pafituara. Aktivët e risigurimit nuk e ekspozojnë Grupin ndaj rrezikut të kredisë derisa të ndodhë një ngjarje e siguruar.

Lëvizja e pjesës së risiguresve në primin e pafituar është shpalosur si në tabelën e mëposhtme:

	2024	2023
Gjendja më 1 janar	314,200	281,866
Ndryshimi bruto në pjesën e risiguresit në rezervat teknike të sigurimit	100,963	40,070
Një analizë me të gjitha të dhënat e përmendura më sipër për departamentin e shëndetit, siç edhe kemi përshkruar, na tregon se të ardhurat e realizuara nga primet e sigurimit janë më të mëdha se shpenzimet e bëra, por duhet të konsiderojmë edhe shpenzimet administrative.

Të dhënat e pasqyrës janë si më poshtë:

Analiza Shëndeti (ne Lekë)						
Emertimi	Primet	Dëmet Paguar	Risigurime Paguar	Komisione Agjenti	Shuma Shpenzime	Diferenca
Aksidentet dhe shëndeti	701,032,181	322,892,791	37,796,946	118,373,930	479,063,667	221,968,514
Shuma Dëme Shëndeti	701,032,181	322,892,791	37,796,946	118,373,930	479,063,667	221,968,514

Departamenti Marinës.

Ka një rënie të primeve të sigurimit krahasuar me vitin e kaluar. Për vitin 2024 të ardhurat nga departamenti i marinës janë si më poshtë:

Prime Bruto	Viti 2024 (në Lekë)
Te Ardhura Sigurime Mall ne Transport	102,439,335
Shuma Të Ardhura Marina	102,439,335

Janë paguar dëme për vitin 2024 si më poshtë:

Dëme Marine & Mall në Transport	Viti 2024 (ALL)
Dëme Sigurim Marine & Mall në Transport	16,813,467
Shuma	16,813,467

Komisionet e agjenteve për sigurimet e bëra në departamentin e marinës janë në shumën 16,831,669 Lekë, që janë 3,144,304 Lekë më shumë se viti 2023. Komisionet janë rreth 16.4 % e primeve të sigurimit.

Janë paguar komisione agjentesh për vitin 2024 si më poshtë:

Komisione	Viti 2024 (ALL)
Komisione Agjenti Sigurime Marine & Mall ne Transport	16,831,669
Total Komisione Marine & Mall ne Transport	16,831,669

Risigurimet per departamentin e marinës bëhen rregullisht. Vërejmë se për vitin 2024 risigurimet janë më të uleta në vlerën 20,207,278 se ne vitin 2023.

Janë paguar risigurime për departamentin e marinës si më poshtë:

Risigurime	Viti 2024 (ALL)
Risigurime Marine & Mall ne Transport	39,292,785
Shuma Risigurime Marine & Mall ne Transport	39,292,785

Në analizën e departamentit të marinës lidhur me të ardhurat e realizuara dhe shpenzimet e bëra duhet të theksojmë sa ky departament ka efektivitet në sigurimet që bën.

Pasqyra e përgatitur për departamentin e marinës është si më poshtë:

Analiza Marinë Aviacion						
Emertimi	Primet	Dëmet Paguar	Risigurime Paguar	Komisione Agjenti	Shuma Shpenzime	Diferenca
Shuma Marine Aviacion	102,439,335.73	16,813,467	39,292,785	16,831,669.46	72,937,921	29,501,415

Një analizë për të gjithë departamentet së bashku, ku jepet performanca e Kompanisë, nga të dhënat që paraqitëm më sipër na jep një rezultat të tillë për Kompaninë. Të ardhurat e realizuara nga primet e sigurimit për vitin 2024 janë në shumën 5,729,743,000 Lekë. Në krahasim me vitin 2023, kemi një rritje prej 230,663,000 Lekë.

Si konkluzion përmendim që duhet të shihen rekomandimet e vendosura për çdo departament, në pasqyrë-analizat e përgatitura si dhe del në pah rëndësia e madhe që kanë risigurimet e duhura dhe korrekte të cilat Kompania i zbaton rregullisht.

Departamenti Financës.

Në kontrollet në vazhdimësi gjatë vitit, bërë nga ana jonë, vërejmë se nga ana e departamentit të financës është zbatuar me korrektesë plani unik kontabel i miratuar, dhe po kështu edhe të gjitha standartet ndërkombëtare që aplikohen për financën IFRS. Gjatë vitit 2024 në departamentin e financës ka vazhduar si edhe në vitin 2023 mbajtja e kontabilitetit në programin financiar SAP. Të gjitha llogaritë e prekura me veprime financiare gjatë vitit kanë pozicione të rregullta “debitore” dhe “kreditore” dhe janë të rakorduara me llogaritë analitike korespondente. Ato paraqesin gjendjen reale të Kompanisë me datë 31 dhjetor 2024 në të gjithë treguesit e saj. Bilanci financiar

është mbyllur saktë. Paraqitja sintetike e tij me aktivin e llogarive dhe pasivin e tyre është si më poshtë:

BILANCI SIGAL UNIQA (Vlerat paraqitur ne 000 Leke)		
BSH	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Aktive		
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	105,262	127,496
Depozita me afat me bankat dhe Investime	5,558,507	5,239,158
Investime te tjera financiare	700,117	624,830
Investime në instrumenta kapitali me vlerë të drejtë	37,343	34,654
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi	438,741	410,157
Tatim fitimi i arkëtueshëm	20,538	51,705
Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	426,939	409,725
Llogari të arkëtueshme nga risigurimi	1,028,401	827,706
Investime në filiale	2,223,050	2,223,050
Hua te dhena filialeve	104,317	108,537
Aktive afatgjata materiale	870,305	915,255
Aktive të tjera	217,078	103,820
Totali i aktiveve	11,730,598	11,076,091
Detyrime		
Rezerva për dëme	3,631,909	3,185,199
Rezerva për primet e pafituara	2,945,359	2,663,953
Tatim fitimi i pagueshëm	-	-
Detyrime qiraje	75,258	125,977
Detyrime të tjera	562,144	634,273
Totali i detyrimeve	7,214,670	6,609,402
Kapitali		
Kapitali aksionar	2,232,909	2,232,909
Rezerva të rrezikut të sigurimit	260,496	260,496
Fitimi i mbartur	2,022,522	1,973,284
Totali i kapitalit	4,515,927	4,466,689
Totali i detyrimeve dhe kapitalit	11,730,598	11,076,091

Kompania Sigal Uniqa Group Austria ka arritur të realizojë për këtë vit një fitim bruto prej 447,223,315 Lekë. Për të paraqitur realizimin e këtij fitimi në kemi përgatitur pasqyrën e të

ardhurave e shpenzimeve analitike të kompanisë. Elementet analitikë të të ardhurave e shpenzimeve financiare për Kompaninë për vitin 2024 dhe krahasuar me vitin 2023 janë si më poshtë:

<i>(Vlerat paraqitur ne 000 Leke)</i>	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Prime të shkruara bruto	5,729,743	5,499,081
Ndryshimi në rezervat e primeve të pafituara	(281,406)	(166,264)
Primet bruto te fituara	5,448,337	5,332,816
Prime të ceduara në risigurim	(883,448)	(966,819)
Ndryshimi në risigurim në rezervat e primeve të pafituara	60,737	33,906
Të ardhura neto nga primi i sigurimit	(822,711)	(932,913)
Të ardhura të tjera	67,730	75,514
Të ardhura neto	4,693,356	4,475,417
Ndryshimi në rezervat e dëmeve të sigurimit	(446,711)	(256,005)
Ndryshimi në pjesëmarrjen e risigurimit ne rezervën e dëmeve	139,958	(38,464)
Dëme të paguara	(2,042,279)	(1,384,548)
Dëme të paguara të risiguruara	317,120	113,159
Dëme të sigurimit neto	(2,031,911)	(1,565,859)
Kostot e marrjes në sigurim	(812,032)	(862,901)
Shpenzime administrative	(1,337,792)	(1,168,174)
Shpenzime të tjera sigurimi	(140,777)	(163,149)
Fitimi operativ	370,843	715,334
Të ardhura nga investimet	302,126	162,398
Shpenzim interesi qira	(4,837)	(6,662)
Fitime/Humbje nga kursi i këmbimit	(220,909)	(478,599)
	76,380	(322,863)
Fitimi para tatimit	447,223	392,471
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	(47,985)	(58,760)
Fitimi i vitit	399,238	333,711
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-

Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit	399,238	333,711
---	---------	---------

Kapitali i nënshkruar me lëvizjet e tij për kompaninë është në nivele stabël. Ndryshimet e tij vijnë kryesisht nga fitimet e realizuara në vite apo edhe rastet kur është vendosur shpërndarje fitimi në formën e dividendit. Ndryshimet në kapital për vitin 2024 janë sipas pasqyrës më poshtë:

<i>(Vlerat paraqitur ne 000 Leke)</i>	Kapitali aksionar	Rezerva të rrezikut të sigurimit	Fitimi i mbartur	Totali
Gjendja më 31 dhjetor 2022	2,232,909	260,496	1,939,573	4,432,978
Gjendja më 1 janar 2023	2,232,909	260,496	1,939,573	4,432,978
Fitimi i vitit	-	-	333,711	333,711
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	333,711	333,711
Transaksione me pronarët e Shoqërisë				
Dividendë të paguar	-	-	(300,000)	(300,000)
Totali i transaksioneve me pronarët e Shoqërisë	-	-	(300,000)	(300,000)
Gjendja më 31 dhjetor 2023	2,232,909	260,496	1,973,284	4,466,689
Gjendja më 1 janar 2024	2,232,909	260,496	1,973,284	4,466,689
Fitimi i vitit	-	-	399,238	399,238
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	399,238	399,238
Transaksione me pronarët e Shoqërisë				
Dividendë të paguar	-	-	(350,000)	(350,000)
Totali i transaksioneve me pronarët e Shoqërisë	-	-	(350,000)	(350,000)
Gjendja më 31 dhjetor 2024	2,232,909	260,496	2,022,522	4,515,927

Kompania ka një gjendje monetare të qendrueshme, në rritje nga viti 2024. Mjetet e saj monetare janë në depozita bankare, të shpërndara thujse në të gjitha bankat e nivelit të dytë me të cilat Kompania edhe bashkëpunon. Për të paraqitur gjendjen e mjeteve monetare në llogaritë e saj bankare dhe në depozita në fund të vitit 2024 nga ana e jonë është përgatitur pasqyra më poshtë:

Mjete Monetare ne Arke dhe Banke (Ne 000 Leke)	Viti 2024
Mjete monetare dhe ekuivalentë (përfshirë arkën)	104,698
Depozita me afat me bankat	5,558,507
Total	5,663,205.20

Gjendjet në llogaritë bankare dhe depozita sipas bankave të nivelit të dytë më të cilat Kompania Sigal Uniqa Group Austria punon, për vitin 2024 janë sipas pasqyrës më poshtë:

BANKAT (ne 000 Leke)	31 dhjetor 2024		31 dhjetor 2023	
	Mjete monetare dhe depozita me afat	Nga të cilat mjete monetare	Mjete monetare dhe depozita me afat	Nga të cilat mjete monetare
Banka Kombëtare Tregtare	1,878,604	15,857	1,791,796	25,414
Intesa San Paolo Bank	34,463	9,982	272,585	39,732
Raiffeisen Bank	49,255	17,206	44,569	12,314
Credins Bank	614,567	2,234	764,023	2,394
Banka Amerikane e Investimeve	1,333,227	19,851	413,910	17,858
OTP Bank	468,432	14,265	581,423	14,254
ProCredit Bank	89,517	4,183	169,706	3,361
Tirana Bank	1,089,620	7,516	1,180,906	4,465
United Bank of Albania	6,278	6,278	1,677	1,677
Union Bank	42,503	4,410	96,507	2,880
First Investment Bank	2,916	2,916	1,113	2,467
Totali i ekpozimit me bankat	5,609,381	104,698	5,318,215	126,816

Kompania ka bërë investime gjatë viteve në krijimin e filialeve të saj në Sigal Kosove dhe Sigal Maqedonia e Veriut, po kështu në Sigal Life Shqipëri, Kosovë dhe Maqedonia e Veriut. Këto Shuma nuk kanë ndryshime nga viti 2021 dhe në fund të vitit 2024, paraqiten si më poshtë:

Investime ne Pjesemarrje		
Emertimi	31.12.2024	31.12.2023
Investimi ne SIGAL Non Life - Kosove , NETO	554,408,99	554,408,985
Investimi ne SIGAL Life - Kosove	491,728,000	491,728,000
Investimi ne Unqia Ad - Maqedoni	488,040,000	488,040,000
Investimi ne Unqia Life Ad - Maqedoni	369,999,000	369,999,000
Investimi ne Sigal Life - Albania	318,874,000	318,874,000
Total	2,223,049,99	2,223,049,985

Shtesat dhe paksimet e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara janë regjistruar drejtë e saktë. Edhe llogaritja e amortizimit vjetor të aktiveve është bërë brenda normave të miratuara për secilin lloj të aktivitetit të trupëzuar dhe patrupëzuar dhe gjendja në fund rakordon me listat analitike të tyre. Levizjet e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara me gjëndjet e tyre në fillim të vitit, lëvizjet gjatë vitit dhe gjëndjet në fund të vitit bruto dhe neto, së bashku me amortizimin, janë si pasqyra më poshtë:

Levizjet	Toka	Ndertesa	Mjete Motorrike	Kompjtuera dhe pajisje zyre	Përmirësime të objekteve me qira	Total
Kosto						
Më 31 dhjetor 2022	82,853	1,424,149	168,321.6	449,162	38,052	2,162,539
Shtesa	-	57,539	51,918	11,719	0	121,176
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	(58,706)	(22,227)	(37,806)	0	(118,740)
Më 31 dhjetor 2023	82,853	1,422,982	198,012	423,074	38,052	2,164,975
Shtesa	-	90,770	640	9,061	0	100,471
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	(14,862)	(10,072)	0	0	(24,933)
Më 31 dhjetor 2024	82,853	1,498,891	188,581	432,135	38,052	2,240,513
Amortizimi i akumuluar						
Më 31 dhjetor 2022	-	(674,680)	(127,378)	(348,303)	(33,087)	(1,183,448)
Shpenzimi i vitit	-	(109,180)	(11,800)	(21,915)	(3,805)	(146,699)
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	28,332	17,643	34,451	0	80,426
Më 31 dhjetor 2023	-	(755,528)	(121,535)	(335,767)	(36,892)	(1,249,721)
Shpenzimi i vitit	-	(105,330)	(15,309)	(17,453)	(1,160)	(139,252)
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	9,464	9,301			18,765
Më 31 dhjetor 2024	-	(851,394)	(127,544)	(353,219)	(38,052)	(1,370,208)
Vlera kontabël neto						
Më 31 dhjetor 2022	82,853	749,469	40,944	100,858	4,965	979,091
Më 31 dhjetor 2023	82,853	667,454	76,478	87,308	1,160	915,254
Më 31 dhjetor 2024	82,853	647,496	61,037	78,916	-0	870,305

Gjate vitit 2024 kemi një rritje të debitorëve police mbajtes dhe nga agjentët në krahasim me vitin 2023 për vlerën 28,584,000 Leke. Gjendja analitike e llogarisë “të arkëtueshme nga sigurimi dhe tjera” paraqitet si më poshtë:

Llogari të Arkëtueshme të sigurimit (ne 000 Leke)	Viti 2024	Viti 2023
Të arkëtueshme nga policëmbajtësit	432,505	407,523
Të arkëtueshme nga agjentët	6,236	2,634
Totali	438,741	410,157

Përlllogaritjet për përcaktimin e tatim fitimit të vitit 2024, për llogari të organeve të tatim taksave janë bërë drejtë, duke përjashtuar shpenzimet e panjohura. Pasi është bërë ky veprim më tej është llogaritur tatimi i fitimit në masën 15% konformë ligjit në fuqi.

Përlllogaritjet e bëra janë si më poshtë:

PL (në 000 Lekë)	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Prime të shkruara bruto	5,729,743.16	5,499,080.52
Ndryshimi në rezervat e primeve të pafituara	(281,406.35)	(166,264.42)
Primet bruto të fituara	5,448,336.81	5,332,816.10
Prime të ceduara në risigurim	(883,448.20)	(966,819.19)
Ndryshimi në risigurim në rezervat e primeve të pafituara	60,736.74	33,905.72
Të ardhura neto nga primi i sigurimit	(822,711.46)	(932,913.47)
Të ardhura të tjera	67,730.33	75,514.36
Të ardhura neto	4,693,355.68	4,475,416.99
Ndryshimi në rezervat e dëmeve të sigurimit	(446,710.59)	(256,005.35)
Ndryshimi në pjesëmarrjen e risigurimit në rezervën e dëmeve	139,958.39	(38,464.46)
Dëme të paguara	(2,042,278.82)	(1,384,548.28)
Dëme të paguara të risiguruara	317,119.74	113,159.34
Dëme të sigurimit neto	(2,031,911.28)	(1,565,858.76)
Kostot e marrjes në sigurim	(812,032.06)	(862,901.42)

Shpenzime administrative	(1,337,792.36)	(1,168,173.50)
Shpenzime të tjera sigurimi	(140,776.57)	(163,149.32)
Fitimi operativ	370,843.40	715,333.98
Të ardhura nga investimet	302,126.29	162,398.40
Shpenzim interesi qira	(4,837.27)	(6,662.38)
Fitime/Humbje nga kursi i këmbimit	(220,909.10)	(478,598.89)
	76,379.91	(322,862.87)
Fitimi para tatimit	447,223.32	392,471.11
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	(47,984.84)	(58,760.32)
Fitimi i vitit	399,238.47	333,710.79
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit	399,238.47	333,710.79

Bazuar në të gjithë treguesit financiar të mbyllur në fund të vitit 2024 dhe duke bërë një analizë financiare të tyre, si departament auditi vërejmë se Kompania Sigal Uniqa Group Austria plotëson kriteret dhe ka një marzh të aftësisë paguese. Niveli i Marzhit të aftësisë paguese është 1,853,355.605 Lekë sipas tabelës më poshtë:

MARZHI I AFTESISË PAGUESE (ne 000 Leke)	2024	2023
a) Shkalla e kërkuar e marzhit bazuar në primet	728,487	816,878
b) Shkalla e kërkuar e marzhit bazuar në demet	402,357	359,356
Maksimale midis Shkalles së kërkuar e marzhit të bazuar në primet dhe demet	728,487	816,878
b) Niveli aktual i marzhit të aftësisë paguese:		
Kapitali aksionar i paguar (shënim 20)	2,232,909	2,232,909
Rezerva të rrezikut të sigurimit	260,496	260,496
Fitimet e mbartura	2,022,522	1,973,284
Investimet në filiale	(2,223,050)	(2,223,050)
Aktive të tjera të zbritshme në llogaritjen e kapitalit	(439,523)	(467,486)
Niveli aktual i marzhit të aftësisë paguese	1,853,355	1,776,153

E njëjta gjë mundet të thuhet edhe për nivelin financiar në funksion të mbulimit të aktiveve, ku nga analiza e bërë rezulton në masën 125.86 %, shifër kjo optimale që reflekton gjëndjen financiare të Kompanisë Sigal Uniqa Group Austria. Pasqyra më poshtë na jep këto përlllogaritje:

Rezervat teknike bruto 31 dhjetor 2024 (ne 000 Leke) (A) 6,577,268.43			
	Limiti i investimit si përqindje e provizionit bruto	Shuma e investimit limit sipas rregullores	Aktive për mbulimin e detyrimeve të sigurimit
Tokë dhe ndërtesa	0.3	1,973,180.5	637,039.4
Depozita me afat (duke përjashtuar fondin e garancisë)	Pa limit	-	4,775,724.0
Investime në bono thesari (duke përjashtuar fondin e garancisë)	Pa limit	-	-
Llogari të arkëtueshme nga risigurimi (klasifikimi mbi BBB)	Pa limit	-	1,153,598.8
Tituj të tregtuar në tregje të rregulluara	0.4	2,302,044.0	735,317.8
Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të tjera të arkëtueshme (më pak se 3 muaj)	0.2	589,071.8	244,274.3
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	0.0	197,318.1	105,262.0
Investime në aktive fikse të ndryshme nga toka dhe ndërtesat	0.1	328,863.4	139,955.2
Interes i llogaritur	0.1	328,863.4	55,967.5
Shpenzime të parapaguara	0.2	441,803.8	426,938.8
Totali (B)			8,274,077.9
Niveli i mbulimit të aktiveve në përqindje		B/A	1.26

Aktuaristikë - Statistika.

Në kompani llogaritja e rezervave të domosdoshme të saj ka rëndësi të veçantë. Këto llogaritje nga departamenti aktuaristikë-statistikës janë bërë drejt dhe saktë, konformë të gjitha ligjeve, urdhërësive të Autoritetit Mbikqyres Financiar dhe rekomandimeve të dhëna nga ana e Uniqa Group Austria. Janë bërë miratimet e llogaritjeve të tyre me shumat përkatëse, në autoritetet brenda vendit dhe tek Uniqa Group siç përmendëm më sipër, dhe më tej janë përfshirë në bilancin

financiar të Kompanisë. Për vitin 2024 rezervat e llogaritura sipas llojit të tyre, krahasuar edhe me vitin 2024 si dhe konformë standarteve të kërkuara janë si më poshtë:

Rezervat (ne 000 Leke)	Viti 2024	Viti 2023
Rezerva për dëme	3,631,909	3,185,199
Rezerva për primet e pafituara	2,945,359	2,663,953

Departamente të tjera në Kompani.

- **Departamenti i Regresit** ka ndjekur gjatë gjithë vitit gjyqet në të cilat Kompania jonë kërkon rimbursimin e vlerës së paguar të demit, shkaktuar në shkelje me Ligjin 32/2021 Neni 4, 23 vijues . Këto ndiqen pasi pala që ka shkaktuar dëmin ka qënë në kushtet që nuk ka patur sigurim ose në rrethanat që ka dalë me testin e alkoolit mbi normat e lejuara ose i pa pajisur me lejen e drejtimit të mjetit. Këto raste janë ndjekur me përpikmëri nga ana e departamentit regresit në bashkëpunim edhe me departamentet e dëmeve.

- **Departamenti Ligjor** ka ndjekur me korrektesë procese gjyqësore ku në raste të caktuara klientë të ndryshëm kanë pretendime karshi kompanisë për vlerën e paguar të demit.

Departamenti ka përgatitur urdhëra dhe udhëzime bazuar në legjislacionin në fuqi për departamentet e tjera të kompanisë, sipas funksionit të tyre për të përmirësuar ecurinë e punës në vazhdimësi. Këto urdhëra në shumicën e rasteve përgatiten me kërkesën e Drejtorit të Përgjithshëm lidhur me zbatimin e disa kushteve të kërkesave në funksion të Kompanisë.

Nga Departamenti Ligjor përgatiten të gjitha materialet për mbledhjet e Këshillit Administrativ, për të gjitha çështjet që do të trajtohen në mbledhjet që bëhen gjatë vitit.

Trajtimi i dëmeve në Kompaninë Sigal Uniqa Group Austria bëhet me disa organizime pune të ndryshme. Kështu për dëmet motorrike Tpl Materiale dhe Kasko të cilat janë në një numër edhe më të madh janë departamente të veçanta për trajtimin e secilit produkt. Në këto departamente bëhet trajtimi i të gjitha dosjeve për klientet e dëmtuar me këto lloj sigurimi. Ne kemi bërë kontrollin e dosjeve të dëmeve me zgjedhje gjatë vitit dhe kemi vërejtur se ato përmbajnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar me udhëzime të veçanta për të bërë pagesën e një dëmi. Llogaritjet e vlerave janë bërë sipas manualeve të përcaktuara për këtë qëllim dhe janë paraqitur saktë në sistemin e brendshëm dhe pasqyrat excel.

- Dosjet për dëmet shëndetësore të shkaktuara nga personat me sigurimin Tpl trajtohen në departamentin e organizuar nga Kompania specifikisht për këto dëme. Në përbërje të departamentit ka inxhinier te licensuar, mjekë dhe jurist të cilët përcaktojnë shkallën e demtimit të aksidentuarit. Edhe në këto dosje ndodhet i gjithë dokumentacioni i kërkuar sipas udhëzimeve të dërguara.

- Dëmet e shkaktuara nga të sigurvearit me karton jeshil përgatiten nga departamenti i cili mbulon specifikisht këto dëme. Nga ky departament bëhet e gjithë korrespondenca me të gjitha byrotë e sigurimit, apo në raste të veçanta me kompanitë e sigurimit jashtë territorit të Shqipërisë. Pas plotësimit të dosjes me korrespondencën e kërkuar dhe dokumentacionin që duhet bëhet edhe pagesa e saj. Departamenti veç rasteve të demeve me produktin karton jeshil, ka një sektor që plotëson edhe dëmet e dërguara nga Byroja Shqiptare e Sigurimit për rastet kur shkaktari i dëmit rezultojnë i pasiguar. Të gjitha të dhënat për pagesat e demeve të bëra gjatë vitit 2024 nga ana e jonë janë dhënë në pasqyrat më sipër tek departamentet e marrjes në sigurim. Në të gjithë këto departamente kemi vërejtur që të dhënat hidhen rregullisht në regjistrat përkatës. (Ka një program kompjuterik të quajtur ICMS për këtë qëllim). Të dhënat janë të azhuruara gjatë gjithë kohës, janë hedhur sipas formateve të miratuara si nga Autoriteti Mbikqyres Financiar edhe nga Uniq Group Austria.

- Dëmet në departamentin e shëndetit ndiqen nga një sektor i veçantë në këtë departament i cili merret vetëm me hapjen e plotësimin e dosjeve për klientet e sigurvearit me shëndet privat kryesisht, por edhe kur ka raste të shëndetit në udhëtim dhe aksidenteve. Kompania Sigal Uniq Group Austria ka lidhur kontrata me disa nga spitalet dhe klinikat private që funksionojnë në vendin tonë dhe ku klientet e sigurvearit kryejnë vizitat mjeksore apo kurohen nga sëmundje të ndryshme. Për secilin klient të sigurvearit është hapur një dosje e veçantë, në të cilën gjenden të gjitha faturat e lëshuara nga spitalet apo klinikat mjeksore. Bazuar në llojin e sigurimit ka mjaft klientë të cilët këto vizita apo mjekime i kryejnë në shtete të huaja jashtë Shqipërisë, dhe për këto veprohet njëllëj si rastet që thamë për brenda vendit.

- Dëmet e ndodhura dhe të paguara në rastet e sigurimit të pasurisë trajtohen po brenda departamentit të pasurisë, edhe këtu është krijuar një sektor i veçantë që merret me dëmet e ndodhura në këtë departament. Departamenti i demeve të Pasurisë gjatë vitit 2024 ka pasur volum normal pune.

- **Departamenti Marketingut** në vlerësimin tonë gjatë vitit 2024 ka punuar mirë dhe duke dhënë një ndihmesë për departamentet e marrjes në sigurim. Kjo gjë është bërë e mundur me anë të reklamave të dhëna në televizionet më të ndjekura në vend, në gazetatat dhe revistat e njohura, rrjetet sociale, si dhe në eventet kulturore e sportive të zhvilluara gjatë vitit. Janë përgatitur fletë palosje për reklamimin e punës në fushën e sigurimeve të Kompanisë, në mënyrë që klientët ta kenë më të lehtë perceptimin dhe rëndësinë që ka sigurimi i vetvetes, familjes tij si dhe i aseteve. Është shtrirë veprimtaria reklamave dhe marketingut edhe në rrjetet e ndryshme sociale. Është punuar edhe në pajisjen e të gjitha zyrave ku operon Kompania Sigal Uniq Group Austria me vendosjen e reklamave të duhura, uniformë në të gjithë rrjetin e shitjes në Kompani. Bëhen trajnime të vazhdueshme me stafin e Kompanisë.

- **Departamenti IT**, si për pjesën e mirëmbajtjes së rrjetit, kompjuterave etj., edhe në krijimin e programeve të reja për përmirësimin e cilësisë së punës në Kompani ka punuar mirë. Janë bërë dhe funksionojnë programet për blerjen e shumë produkteve të sigurimit që Kompania shet në formën on-line për ta lehtësuar sa më shumë klientin. Në të njëjtën gjë është punuar edhe për shitjet on-line nga të gjitha zyrat e Kompanisë në të gjithë territorin e vendit tonë. Një punë e mirë e me vlera është edhe vënia në funksion dhe perfeksionimi në departamentin e financës të programit të ri SAP.

Vazhdimisht në këtë departament punohet për përsosjen më tej me të gjitha të rejat që dalin në fushën e programimit të të gjitha programeve ekzistuese në Departamentet e Kompanisë, apo vendosjen e programeve të rinj pune ku në departamente nuk ka të tilla. Të gjitha programet e reja shoqërohen me trajnime të vazhdueshme të stafit për një punë të saktë e rigorozë.

Të tjera.

- Ligji nr.9917, datë 19.05.2008 “Per Parandalimin e Pastrimit te Parave dhe Financimit te Terrorizmit”, i ndryshuar me ligjin 10391, datë 03.03.2011 dhe ligjin 66/2012, datë 07.06.2012 si dhe udhëzimi nr.28, datë 31.12.2012 “Për Metodën dhe Proçedurat e Raportimit dhe Marrjes së Masave Parandaluese në zbatim të ligjeve më sipër, rregullorja nr.58, datë 30.06.2015 e Autoritetit Mbikqyres Financiar “Mbi masat e Vigjilencës së Duhur dhe të Zgjeruar” nga ana e Kompanisë Sigal Uniq Group Austria kanë gjetur zbatim përgjatë gjithë vitit 2024.

Është bërë përgatitja periodike e materialeve, te rrisk profilit të Kompanisë, të klienteve, si dhe monitorimi i klienteve me rrisk të lartë, mbi baza mujore. Ka bashkëpunim me departamentet e marrjes në sigurim, të financës dhe atij ligjor për realizimin e këtyre të dhënave. Bëhen rregullisht raportimet CRS me bazë vjetore konformë ligjit 4/2020 “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare” pranë Drejtorisë Përgjithshme të Tatimeve. Bëhen rregullisht raportimet vjetore për Autoritetin Mbikqyrës Financiar konformë anekseve nr 4 dhe 5 te rregullores nr 58/2015 që përmendëm më sipër.

Ndiqet rregullisht, kur ka raste, procesi identifikimit të klienteve me rrisk të lartë. Në bashkëpunim me departamentin ligjor në Kompani janë hartuar rregullore, udhëzime dhe urdhëra të brendshëm “Për parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”. Janë bërë raporte në periudha të caktuara për mbledhjet e Këshillit Administrativ të Kompanisë për informim ndaj këtyre problemeve. Plotësohen rregullisht materiale të kërkuara si nga ana e Drejtorisë Parandalimit Pastrimit të Parave dhe Uniqa Group Austria. Shënimet e mbajtura për klientët (në rastet kur ka dhe evidentohen) me rrisk të lartë raportohen pranë organeve të autorizuar për këtë qëllim.

Ka një koordinim të punës për të gjitha çështjet e pastrimit të parave midis Sigal Uniqa Group Austria, Sigal Life Uniqa Group Austria dhe Fondit të Pensioneve Sigal Life Uniqa Group Austria, për raportet dhe raportimet që do të bëhen rregullisht gjatë vitit. Rregullisht bëhet kontrolli i listave të publikuara nga Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave. Hartohet një plan pune trajnimi dhe zbatimi i tij gjatë vitit për të gjithë punonjësit të cilët janë të përfshirë në punën e tyre me çështje të parandalimit të pastrimit të parave.

- **Administrimi i rrezikut** në Kompani ka qënë në qendër të vëmendjes gjatë gjithë vitit 2024. Këtë e tregon edhe fakti i krijimit të një Këshilli Vlerësues për të ndjekur e raportuar në vazhdimësi problemet që dalin gjatë aktivitetit të sigurimit në Kompani. Janë analizuar të gjitha kontratat e lidhura të sigurimit me vlera të larta të rrezikut, si në drejtim të rrezikut të primit të sigurimit (si do të vendoset ky prim) edhe të rezervës së llogaritur për këto kontrata në rast rreziku.

Po kështu janë bërë rekomandimet e duhura për lidhjen e kontratave të risigurimit me firma risiguruese të njohura, si edhe me vetë Uniqa Reinsurance Group, për një mbrojtje sa më të sigurtë nga çdo rrezik i mundshëm për Kompaninë në zhvillimin e aktivitetit të saj. Në punën e bërë

Këshilli i miratuar për ndjekjen e rrezikut ka patur në qendër të vëmendjes edhe administrimin e rrezikut financiar të mundshëm që mund të ketë Kompania.

Është vlerësuar rreziku i kursit të këmbimit (ndryshimet e kursit të saj) pasi dihet që Kompania Sigal Uniqa Group Austria punon me të tre monedhat si Lekë, Euro dhe Usd. Po kështu është vlerësuar rreziku i normës së interesave bankare (luhatja e tyre) duke operuar në depozitat e saj me banka .Për të gjitha këto probleme Kompania Sigal Uniqa Group ka marrë vazhdimisht udhëzime, informacion të thelluar dhe mbështetje nga Departamenti që punon në këtë veprimtari në Uniqa Group ne Austri, ku edhe Kompania raporton punën e saj në vazhdimësi.

Për të qënë sa më efektive janë përgatitur materiale që i shërbejnë Kompanisë në këtë drejtim: - Hartimi e njohja me materialet mbi politikat e menaxhimit të rriskut ku perfshihen, cilat janë fushat me rrisk të lartë, reagimi pozitiv që do të bejë Kompania ndaj ndryshimeve që mund të ndodhin, në raste rreziku si do të veprohet për minimizimin e rriskut, investimet apo lidhja e kontratave vetëm pasi rrisqet të kuptohen plotësisht.

- Janë bërë të njohura e zbatohen parimet e menaxhimit të rriskut. Ky menaxhim të lehtësojë arritjen e objektivave, të përdoren koncepte sa më të thjeshta dhe të drejtperdrejta, të koordinohen punët sa më mirë midis njësive përgjegjëse, ky menaxhim të jetë sa më transparent e me pjesmarrjen e të gjithë vendim marrësve, të jetë një menaxhim në vazhdimësi të vitit.

- Përcaktohen drejtë kategoritë e rriskut, të cilat Ne i përmendëm edhe më sipër.

- Ndiqen proceset në menaxhimin e rriskut. Analiza që bëhet si ka qënë ky proces në vitet e kaluara dhe çfarë masash duhet të merren për të mos ndodhur në të ardhmen. Bëhen analiza herë pas here se në çfarë niveli të rriskut ndodhet departamenti, apo Kompania në një fazë të caktuar.

- Raportimet periodike bëhen në Këshillin Administrativ. Në raporte theksohet apo vihen në dukje problemet e diskutuara, rreziqet e lartë, etj.

- **Risku i përputhshmërisë** përfaqëson probabilitetin e krijimit të efekteve negative mbi pozicionin e shoqërisë për shkak të mos-zbatimit të rregulloreve, kryesisht të atyre që rregullojnë nivelin e saj të kapitalit dhe parandalimin e pastrimit të parave. Departamenti i Auditit të Brendshëm kontrollon përputhshmërinë me detyrimet e akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse. Shoqëria operon në bazë të ligjit Shqiptar si dhe ne baze te rregulloreve dhe udhëzimeve në nivel

grupi dhe raportimi lidhur me përputhshmërinë kryhet në UNIQA Group. Pranë shoqërisë është ngritur dhe funksionon (Departamenti) i Përputhshmërisë (Compliance) sipas politikës së përputhshmërisë dhe udhëzimeve të UNIQA, përbërë nga personi përgjegjës (Compliance Officer) dhe zëvendësi (Compliance Deputy), kanë planin e tyre të zbatimit të detyrave, dhe raportojnë periodikisht dy herë në vit pranë funksionit të përputhshmërisë së UNIQA.

Gjatë këtij viti nuk janë evidentuar rreziqe apo mospermbushje domethënëse në kuadër të auditimit të përputhshmërisë. Struktura e compliance është e shtrirë dhe në shoqëritë bija të grupit me një sistem raportin në compliance departament në SIGAL UNIQA Group Asutria sh.a . Çdo shoqëri në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni të Veriut ka një Zv. compliance officer i cili raporton tek Compliance department në SIGAL UNIQA dhe në Uniqa Group Compliance. Compliance funksion si strukture përbërëse e sistemit të administrimit të rrezikut të ngritur nga shoqëria si Komitet.

Ne, si Auditues të Brendshëm, kryejmë angazhimet tona duke ndjekur parimet e Pavarësisë së Auditit të Brendshëm. Drejtori i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm dhe stafi i kësaj Drejtorie kanë eksperiencën e duhur dhe në çdo kohë i referohen Ligjit “Për Auditimin e Brendshëm”, Kodit të Etikës dhe standarteve ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm.

Këto ishin problemet dhe puna e bërë në Kompaninë Sigal Uniqa Group Austria për vitin 2024. Periudhën në vazhdim do të vijojmë punën tonë sipas planit të punës të miratuar për vitin 2025, dhe çdo problem do ta shohim e trajtojmë me përgjegjësi. Në rastet që do të mund të konstatojmë parregullsi apo veprime jo konformë ligjeve, udhëzimeve apo urdhërave të dhëna, Ne do të bëjme njoftimet e duhura si për Këshillin Administrativ, Autoritetin Mbikqyrës Financiar si edhe për Uniqa Group Audit.

RAPORT PËR VLERËSIMIN E RREZIQEVE

RAPORT PËR VLERËSIMIN E RREZIQEVE PËR VITIN 2025

Përmbledhje

Përshkrim i provës së rreziqeve të sigurimit dhe rreziqeve të shpenzimeve në sigurimet e jo-jetës.

1 KUADRI I ADMINISTRIMIT TË RREZIKUT

Kompania ka ngritur strukturat përkatëse përgjegjëse, të krijuara për të ushtruar funksionin e administrimit të rrezikut me qëllim vlerësimin, pranimin dhe administrimin e rrezikut. Këto struktura janë:

- **Bordi i Drejtorëve, që përbëhet nga Drejtori i Përgjithshëm, Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm, Drejtori i Departamentit të Marrjes në Sigurim**
- **Risk Manager Responsable person**
- **Compliance**

2 KATEGORITE E RREZIQEVE

2.1 Rreziqet e sigurimit

- Rritje e UPR.
- Rritje e RBNS
- Rritje e dëmeve të paguara.

2.2 Rreziqet financiare

- Rritje e shpenzimeve operative të kompanisë për arsye të ndryshme.

3 KUADRI I RAPORTIMIT

Metodologjia e miratuar për vlerësimin dhe klasifikimin e rreziqeve dhe kryerjen e provave të rezistencës është:

Llogaritja e nevojave për kapital shtesë në rast se, gjatë vitit të ardhshëm, ndodhin të gjithë skenarët e menduar të situatave katastrofike, epidemike dhe të krizave financiare.

Llogaritjet janë bërë mbi bazë skenari.

Më poshtë tregohet si janë zgjedhur skenarët e mundshëm të rrezikut.

4 RREZIQET DHE ADMINISTRIMI I KAPITALIT

4.1 Rreziqet e sigurimeve

Skenari 1: Është supozuar që gjatë vitit të ardhshëm do të ketë një rritje të ndjeshme të frekuencës së dëmeve dhe inflacionit të dëmeve. Të dy këta faktorë do të prekin të gjithë portofolin (të gjitha LoB-et). Mendohet që një situatë e tillë mund të ndodhë 1 herë në 50 vjet (probabilitet 2%). Ndikimi do të jetë:

- Rritje e UPR.
- Rritje e RBNS

Skenari 2: Një katastrofë natyrore që dëmton masivisht pronat e siguruar. LoB i prekur do të jetë portofoli i Zjarrit. Mendohet që do të kemi 3-fishim të numrit të dëmeve të paguara dhe 1.5-fishim të dëmit mesatar. Një situatë e tillë mund të ndodhë 1 herë në 100 vjet (probabilitet 1%). Ndikimi do të jetë:

- Rritje e dëmeve të paguara për portofolin e Zjarrit.

Skenari 3: Nje krizë financiare që sjell mosplotësimin masiv të kontratave. Portofoli i prekur do të jetë portofoli i garancive (ofertë + kontratë). Mendohet që do të paguhen dëme për 18% të të gjitha kontratave në fuqi, me rritje 80% të dëmit mesatar. Një situatë e tillë mund të ndodhë 1 herë në 100 vjet (probabilitet 1%). Ndikimi do të jetë:

- Rritje e dëmeve të paguara për portofolin e Garancive.

Skenari 4: Epidemike masive, që sjell sëmundshmëri në nivele të larta. Portofoli i prekur do të jetë Shëndeti. Mendohet që do të paguhen dëme për 22% të të gjitha kontratave në fuqi, me rritje 570% të dëmit mesatar. Një situatë e tillë mund të ndodhë 1 herë në 100 vjet (probabilitet 1%). Ndikimi do të jetë:

- Rritje e dëmeve të paguara për portofolin e Shëndetit.

Skenari 5: Një krizë financiare, që sjell mosplotësimin masiv të kontratave. Portofoli i prekur do të jetë portofoli i Mallit në Transport. Mendohet që do të paguhen dëme për 10% të të gjitha kontratave në fuqi, me 40% rritje të dëmit mesatar. Një situatë e tillë mund të ndodhë 1 herë në 100 vjet (probabilitet 1%). Ndikimi do të jetë:

- Rritje e dëmeve të paguara për portofolin e Mallit në Transport.

4.2 Rreziqet financiare

Skenari 6: Rritje me 10% e shpenzimeve operative të Kompanisë për arsye të ndryshme. Kjo nuk përfshihet në Rreziqet e Sigurimit.

4.3 Kërkesat për kapital për një rritje të rezervave për primin e pafituar (KKupr) (Skenari 1)

Në këtë rezervë ka 2 rreziqe: Rreziku Parametrik (Parameter) dhe Rreziku i Luhatjes (volatility).

4.3.1 Rreziku parametrik

Periudha mesatare e rrezikut të mbetur është marrë 6 muaj. Frekuenca e dëmeve është menduar se do të rritet me 8% në vit dhe inflacioni i dëmeve do të rritet me 1.5% në vit.

Kërkesa për kapital për efekt të rrezikut parametrik llogaritet:

$$KKpar = (f + i) \times \frac{6}{12} \times UPR \quad (1)$$

f = frekuenca

i = inflacioni

4.3.2 Rreziku i Luhatjes (volatility)

Rreziku i luhatjes paraqet pasigurinë mbi ecurinë e biznesit për periudhën për të cilën është mbajtur rezerva UPR.

Kërkesat për kapital për rrezikun e luhatshmerisë llogariten:

$$KKvol = 2.58 \times \sqrt{\frac{n}{2}} \times m \times \sqrt{1 + v^2} \quad (2)$$

n = numri i pritshëm i dëmeve për vitin e ardhshëm

m = dëmi mesatar i pritshëm për vitin e ardhshëm

v = koeficienti i variacionit të shpërndarjes së dëmeve për vitin e ardhshëm

Kërkesa për kapital për rritje të UPR si pasojë e 2 rreziqeve të mësipërme është:

$$KKupr = \sqrt{KKpar^2 + KKvol^2} \quad (3)$$

4.3.3 Kërkesat për kapital për rritje të rezervave (KKrez)

Për rezervat, faktorët e rrezikut janë dëmi mesatar, inflacioni i dëmeve dhe historiku i pagesave.

Nëpërmjet llogaritjes së devijimit standard (S) synohet të matet UNCERTAINTY.

Për një LoB, devijimi standard llogaritet si më poshtë:

$$Slob = \max [1 - 2 \times c; 0.7 \times (1 - c)] \times \min \left(u \times \frac{\sigma}{\sqrt{a}}; 0.5 \times f \right) \quad (4)$$

c = pjesa e ceduar në risigurim (llogaritet si raporti ndërmjet shpenzimeve të risigurimit me primet e shkruara.

u = dëmet e paguara

σ = devijimi standard

a = pjesa e LoB brenda kompanisë. Llogaritet si raporti i primeve të LoB me primet e kompanisë

f = rezervat për dëmet pezull

p_{kom} = primet e kompanisë

P_{lob} = primet e LoB

Totali për Kompaninë:

$$S = \sqrt{\sum Slob^2} \quad (5)$$

Kërkesat për kapital llogariten:

$$KKrez = 2.58 \times S \quad (6)$$

4.3.4 Kërkesat për kapital për rrezikun e katastrofave (KKkat) (Skenari 2 – 5)

Kërkesat për kapital llogariten:

$$KKkat = \sqrt{\sum_{i=1}^4 kat_i^2} \quad (7)$$

Nevojat e përgjithshme për kapital për rrezikun e sigurimit janë:

$$KKins = \sqrt{KKrez^2 + KKupr^2 + 2 \times 0.5 \times KKrez \times KKupr + KKkat^2} \quad (8)$$

4.3.5 Kërkesat për kapital për rrezikun e shpenzimeve (KKexp) (Skenari 6)

Qëllimi është që të provohet rreziku i rritjes së shpenzimeve, për arsye të ndryshme me 9%. Mendohet që një situatë e tillë mund të ndodhë 1 herë në 50 vjet (probabilitet 2%).

$$KKexp = 0.08 \times SHP \quad (9)$$

5 PLANET E VIJUESHMËRISË SË VEPRIMTARISË DHE PËRBALLIMIT TË SITUATAVE TË PAPARASHIKUARA.

Për të siguruar vijueshmërinë e veprimtarisë, për të përballuar situatat e parashikuara më sipër, për të rifilluar veprimtarinë pasi rreziqet e mësipërme të jenë materializuar apo ngjarjet me efekt të dëmshëm të kenë ndodhur, Kompania ka marrë masat për sigurimin e kapitalit shtesë që do të nevojitet për këtë qëllim.

Rezultatet e testimeve janë si më poshtë:

Kërkesa për Kapital shtesë është:

		EURO
KKupr		1,501,968
	KKpar	1,425,416
	KKvol	473,391
KKrez		9,598,388
KKkat		4,002,110
	KKkat1	3,292,591
	KKkat2	1,254,567
	KKkat3	229,917
	KKkat4	1,883,861
KKins		11,172,212
KKexp		2,100,398
KKtotal		13,272,610

6 REKOMANDIMET DHE MASAT

Strukturat përkatëse përgjegjëse, të krijuara për të ushtruar funksionin e administrimit të rrezikut me qëllim vlerësimin, pranimin dhe administrimin e rrezikut, raportojnë periodikisht për rreziqe me vlerë të madhe, që mund të ndikojnë në aktivitetin e ardhshëm të Kompanisë.

7 PËRFUNDIMI

I marrë veçmas, secili skenar mund të ndodhë 1 herë në 50 vjet (probabilitet 2%) ose 1 herë në 100 vjet (probabilitet 1%). Në përgjithësi, probabiliteti që të ndodhin të gjithë skenarët brenda vitit të ardhshëm,


është shumë i vogel (I papërfillshëm). Kompania ka marrë masat për sigurimin e kapitalit shtesë që do të nevojitet për këtë qëllim.

DISA TREGUES PËR SIGAL JO-JETË, VITI 2024

Treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit	169.7%
Treguesin e likuiditetit	3.1
Treguesit në mbulimin e provigjioneve teknike	125.8%

Objektivat e Grupit 2025

1 EUR =	98	ALL
GRUPI		
BUXHETI PER VITIN 2025 në 000 EURO		
Janar	13,191	13,191
Shkurt	26,382	13,191
Mars	39,573	13,191
Prill	52,765	13,191
Maj	65,956	13,191
Qershor	79,147	13,191
Korrik	92,338	13,191
Gusht	105,529	13,191
Shtator	118,720	13,191
Tetor	131,911	13,191
Nentor	145,102	13,191
Dhjetor	158,294	13,191
Viti	158,294	



Pjesëmarrje të Shoqërisë në kapitalin e shoqërive të tjera

Shoqëria SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a është aksioneri kontrollues i Grupit SIGAL

ku zotëron:

- 99,99 % të aksioneve të shoqërisë SIGAL LIFE UNIQA Group Sh. A.
- 100 % të aksioneve të shoqërisë SIGAL UNIQA Group ASUTRIA Sh.A. Kosovë
- 100 % të aksioneve SIGAL LIFE UNIQA Group AUSTRIA Sh.A. Kosovë
- 99.99 % të aksioneve të UNIQA AD Skopje në Maqedoninë e Veriut
- 100 % të aksioneve të UNIQA Life AD Skopje në Maqedoninë e Veriut.

Sistemi qeverisës i Shoqërisë Parimi

Sistemi qeverisës bazohet në parimin e administrimit të sigurtë dhe të kujdesshëm të veprimtarisë, në përputhje me natyrën, vëllimin dhe nivelin e kompleksitetit të veprimtarisë së biznesit, nepermjet nje ndarje të përshtatshme dhe caktim të qartë të përgjegjësiave ndermjet strukturave te brendshme te kompanise.

Baza ligjore

Shoqëria e ka organizuar sistemin qeverisës duke u bazuar në legjislacionin vendor, Statutin e Shoqërisë si edhe standardet e udhëzimet e aksionarit Austriak UNIQA Osterreich Versicherungen.

Struktura qeverisëse

Në përputhje me parashikimet ligjore, struktura qeverisëse e Shoqërisë është e organizuar sipas sistemit me dy nivele.

Organet e Shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve
- Këshilli Mbikqyrës
- Bordi Drejtues
- Komiteti i auditimit
- Njësia e Auditit të Brendshëm
- Komiteti i Administrimit të Rrezikut
- Përputhshmëria dhe Ligjori
- Aktuaristika
- Strukturat e tjera operationale

Organigrama (bashkanigjitur në faqen e mëposhtme)

Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve

Aksionerët ushtrojnë të drejtat e tyre në Asamblenë e Përgjithshme në përputhje me parashikimet ligjore përkatëse.

Asambleja e Përgjithshme mbledhet një herë në vit për mbledhje të zakonshme të asamblesë.

Asambleja mbledhet në mbledhje të jashtëzakonshme të asamblesë nëse kërkohet.

Përgjegjësitë kryesore të Asamblesë janë:

- Ndryshimi i Statutit të Shoqërisë
- Zgjedhja / shkarkimi i Anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës dhe anëtareve të Bordit Drejtues (Administratorit të Përgjithshëm)
- Zgjedhja e auditorit të jashtëm
- Vendime të lidhura me kapitalin
- Miratim bilanci
- Vendimi për shpërndarjen e fitimit.

Aksionerët e Shoqërisë janë:

- UNIQA Osterreich Versicherungen 86,9 % të aksioneve
- Avni Ponari 10 % të aksioneve
- Edvin Hoxhaj 3,07% të aksioneve

Këshilli Mbikqyrës

Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës janë:

- Andreas Brandstetter, Kryetar
- Wolfgang Kindl, Anëtar
- Vinzenz Benedikt, Anëtar
- Georgios Bartzis, Anëtar
- Gerald Müller, Anëtar

Këshilli mbikëqyr Bordin Drejtues të Shoqërisë dhe mblidhet rregullisht çdo tre muaj.

Përgjegjësitë kryesore të Këshillit Mbikqyrës janë:

- mbikqyrja e veprimtarisë së Shoqërisë
- miratim i Njesise se Auditit te Brendshem dhe Komitetit te Auditimit
- miratim i raporteve te Njesise se Auditit te Brendshem dhe te Komitetit te Auditimit
- miratimi i rregulloreve të brendshme dhe procedurave të shoqërisë
- miratimi i rezolutave të Asamblesë së Përgjithshme

Bordi Drejtues

Përgjegjësitë kryesore të Bordit Drejtues janë:

- përfaqësimi i Shoqërisë në marrëdhënie me palë të treta
- administrimi i veprimtarisë së Shoqërisë
- raportimi në Këshillin Mbikqyrës
- çdo çështje tjetër sipas Statutit të Shoqërisë.


Bordi Drejtues i Shoqërisë përbëhet nga:


- Avni Ponari, Administrator i Përgjithshëm

Drejtuesit kryesorë të Shoqërisë janë:

- Alma Totokoçi, Zv.Drejtor i Përgjithshëm
- Ilir Halilaj, Zv.Drejtor i Përgjithshëm, Trajtimi i dëmeve
- Ditika Kruja, Drejtor Departamenti Kartonit Jeshil/ FK
- Klement Mersini, Drejtor Departamenti i Financës
- Abdyl Sarja, Sekretar i Përgjithshëm, Dr. Dept. Ligjor, Pajtuësmerise dhe HR
- Arben Çavolli, Drejtor Departamenti i Aktuaristikës
- Rugova Çokaj, Drejtor Njesia e Auditit të Brendshëm
- Mustafa Sallaku, Drejtor Departamenti IT
- Besnik Çobaj, Drejtor Departamenti i Marrjes ne Sigurim Motorrike
- Ogert Shkrepa, Drejtor Departamenti i Pasurisë dhe Garancive
- Milena Merjemaj, Drejtor Departamenti i Shëndetit Privat
- Gentjan Trenova, Drejtor Departamenti i Dëmeve Shëndetësore MTPL
- Ermal Ponari, Drejtor Departamenti i Dëmeve Materiale MTPL
- Florant Lumani, Drejtor Departamenti Kasko
- Kristjan Prella, Menaxher Departamenti i Regresit

STRUKTURA E GRUPIT SIGAL UNIQA







Fier 1
L. "1 Maji", Rr. Jani Bakalli, tek Kupola Center
Tel. (+355) 69 209 3814

Fier 2
L. "Apollonia", blv. "Jakov Xoxa", pll. 1, shk. 4
Tel. (+355) 342 23035

Fushë Krujë
Pallati hark, qendër Tel. (+355) 563 22869

Gjirokastrë 1
L. "Punëtore", R r."Nacionale", Tel. (+355) 842 67080

Kavajë
L. nr. 1, Sallbeg. Tel. (+355) 552 42562
Korçë
Blv. "Republika", pranë Kinema Milenium
Tel. (+355) 822 50433

Kukës
L. nr. 5, Te. (+355) 242 24532

Laç
Qendër ,Tel. (+355) 536 4578

Lezhë
L. Besëlidhja, Sheshi Besëlidhja, Tel. 0215 24656

Lushnjë
L. "Loni Dhamo", Tel. (+355) 352 21532

Mamurras
Qendër, Tel. (+355) 69 20 25 829

Mat
L. "Partizani", Burrel Tel. (+355) 217 22746

Përmet
Shëtitorja "Odhise Paskali", Tel. (+355) 813 23293

Pogradec
L. Nr 2 Rr, "Rinia", pallati 80, Tel. (+355) 832 26792

Pukë
Rr. "Imer Puka", blloku nr. 1, Tel. (+355) 212 22880

Rrëshen
Sheshi "Abat Doçi", Mirditë Tel. (+355) 69 20 74 581

Sarandë
L. nr. 1, rr. "Flamurit", nr. 19, Tel. (+355) 852 25045

Shkodër 1
L. "Vojo Kushi", Rr. "Çlirimi", pranë teatrit "Migjeni", Kati II
Tel (+355) 222 44429

Shkodër 2
L. "V.Shanto", Rr."Çajupi" , pll. Fishta 2 Tel. (+355) 222 49680

Tropojë
Qendër, Bajram Curri, Tel. (+355) 213 23101

Vlorë
L. Pavarësia, Qendra Tregtare Riviera, Tel. (+355) 332 23121

Drejtoria e përgjithshme / Head Office
Blv. "Zogu I", Nr. 1, Tirana - Albania, Tel. (+355) 4 2233 308,
e-mail: info @sigal.com.al

Tiranë 1
Blv. "Zogu I", pll. Diplomateve, nr. 57, Tel. (+355) 2233 308

Tiranë 2
Rr. "Ukraina e Lirë", pas Kullave Binjake
Tel. (+355) 44 511 666

Tiranë 3
Blv. "Gjergj Fishta", Komplekti Delijorgji
Tel. (+355) 44 330 171

Tiranë 4
Blv. Dëshmorët e Kombit, Piramida, Njësia BE4
Tel. (355) 68 40 81979

Tiranë 6
Rr. "Sotir Caci", pranë Freskut, Tel. (355) 67 201 2309

Tiranë 7
Rr. "Teodor Keko", pranë Astir. Tel. (355) 69 409 6371

Berat
L. "28 nëntori" , Tel. (+355) 32 234605

Dibër
L. " Nazmi Rushiti ", Peshkopi, Tel. (+355) 218 25155

Durrës 1
L. nr. 3, rr. "Skënderbej", qendra e Biznesit
Monun Tel. (+355) 522 31047

Durrës 2
Rr. "Tregtare", Nr.42, Blv. Kryesor, Tel. (+355) 69 365 7105

Elbasan 1
L. "28 Nëntori", Rr. "11 Nëntori", pll.109/1, Kati 2
Tel. (+355) 54 244446

Elbasan 2
L. " Kongresi Elbasanit", Rr. "Baki Kongoli", shatërvani krye-
sor, Tel: (+355) 69 40 96 303



Drejtoria/Head office
Rr. "Ukshin Hoti" Nr 19 – Pejton, Kat. 4 Prishtine – Kosovë
Tel. (+383) 38 240 241, E-mail: info @sigal-ks.com



Drejtoria / Head office
Bul. Ilinden nr. 1, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut
Tel: +389 2 3288 800, email: info@uniqa.mk

Shkup
Xhon Kenedi, nr. 27,
Tel. (+389) 2 2621 211

Berovë
Marshal Tito nr. 115,
Tel. (+389) 75 811 801

Delcevo
Nikola J. Vapcarov,
Tel. (+389) 75 309 005

Dibër
Bratstvo Edinstvo,
Tel. (+389) 46 835 145

D. Hisar
Goce Delcev Nr.9A,
Tel. (+389) 47 275 000

Gostivar
Dimitar Vlaho,
Tel. (+389) 42 221 046

Prishtinë
Rr. "Dëshmorët e Kombit", nr. 72/a, Lagja Ulpian
Tel. (+381) 38 550 576

Ferizaj
Rr. "Wiliam Wolker" p.n, Tel. (+381) 290 320 536

Gjakovë
Rr. "E Tiranës" p.n, Tel. (+381) 44 188 354

Gjilan
Rr. "Adem Jashari", Tel. (+381) 280 320 810

Mitrovicë
Rr. "Adem Jashari" p.n, Tel. (+381) 44 263 742

Pejë
Rr. "Mbretresha Teutë" p.n, Tel. (+381) 39 420 092

Prizren
Rr. "William Woker" p.n, Tel. (+381) 29 244 024

Gjevgjeli
7 Noemvri,
Tel. (+389) 34 218 568

Kavadar
Ilidenska nr. 115,
Tel. (+389) 34 400 288

Kërcovë
Kuzman Jusfovski Pitu,
Tel. (+389) 45 224 290

Koçan
Marshal Tito 86 A,
Tel. (+389) 33 272 150

Kriva Palanka
Marsal Tito nr.230a,
Tel. (+389) 31 372 182

Kumanovë
Potok Serava nr. 2,
Tel. (+389) 31 437 187

Manastir
Stalarska,
Tel. (+389) 47 203 646

Negotivë
Marshal Tito nr. 43,
Tel. (+389) 43 370 590

Ohër
Bul. Turisticka bb zgr. Remis
Kifl a,
Tel. (+389) 46 231 616

Prespë
Leninova,
Tel. (+389) 47 453 000

Prilep
11 Oktomvri Lam.A 8,
Tel. (+389) 48 427 657

Probishtip
Hristjan T. Karposh,
Tel. (+389) 32 480 860

Radovish
Marsal Tito nr.23,
Tel. (+389) 32 630 309

Strugë
JNA,
Tel. (+389) 46 783 201

Strumicë
Mladinska Nr. 45,
Tel. (+389) 34 430 083

Shën Nikollë
Ilined,
Tel. (+389) 32 444 045

Shtip
Tosho Arsov nr. 38,
Tel. (+389) 32 389 710

Tetovë
Ilindenska, nr. 51,
Tel. (+389) 44 351 630

Veles
Strasho Pinxhur nr. 6,
Tel. (+389) 32 43 211 806

Vinica
Ilidenska.
Tel. (+389) 33 364 559

